



LA CHILD 
Enhancing legal aid for children in conflict with the law

NDIHMMA LIGJORE PËR FËMIJËT E PËRFSHIRË NË NJË PROCES PENAL

RAPORT MBI SISTEME LIGJORE TË NDRYSHME NË EUROPË



Projekti finançohet nga programi Drejtësi i
Bashkimit Evropian (2014-2020).



Ky raport hulumtimi u shkrua brenda kornizës së projektit "Ndihma juridike për fëmijët në procedurat penale: zhvillimi dhe ndarja e praktikave më të mira (LA CHILD)", financuar nga programi i Drejtësisë i Komisionit Evropian. Përmbajtja e këtij raporti nuk pasqyron domosdoshmërisht pozicionin e Komisionit Evropian dhe në asnjë mënyrë nuk nënkupton miratimin e tij të opinionëve të shprehura në këtë raport. Nëse gjenden ndonjë pasaktësi ose gabim në këtë dokument, ato mund t'u atribuohen vetëm autorëve të këtij raporti.

AUTORËT DHE FALENDERIMET

Ky raport u hartua nga Dr Agne Limante (Drejtore e projektit, ILL), Dr, Simona Nikartas (ILL), Dr Ruta Vaiciuniene (ILL), Znj Eva Gangnex (DCI – Belgjikë), Znj, Blandine Lens (DCI – Belgjikë), Z. Klodian Gega (QSHPLI), Znj, Holta Zacaj (QSHPLI), Znj, Rezarta Abdiu (QSHPLI)

Ekipi që punoi për projektin i shpreh mirënjohjen të gjithë profesjonistëve të drejtësisë të cilët morën pjesë në interveistat e zhvilluara në Lituani, Belgjikë dhe Shqipëri.

Ekipi falenderon gjithashtu dhe firmen ligjore DLA Piper që dha një kontribut domethënës për studimin duke kryer *pro bono* komponentin e shqyrtimit të dokumentave në 11 shtete të Europës.

Përmbajta

PERKUFIZIME DHE AKRONIME	4
HYRJE.....	6
1.1 ZBATUESIT E PROJEKTIT DHE ORGANIZATAT/INSTITUCIONET MBËSHTETËSE	6
1.2 AKTIVITETET E PROJEKTIT	7
METODOLOGJIA.....	9
.....	9
1.1 ANALIZA E INSTRUMENTAVE RELEVANT TË BË DHE KE	9
1.2 SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	10
1.3 INTERVISTAT GJYSMË TË STRUKTURUARA.....	10
SISTEMET E NDIHMËS JURIDIKE NË JURIDIKSIONET EVROPIANE	13
2.1 E DREJTA E PËRGJITHSHME PËR NDIHMË JURIDIKE	13
2.2 NDIHMJA JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE	16
2.3 ORGANIZIMI I NDIHMËS JURIDIKE: KORNIZA INSTITUCIONALE DHE FINANCIMI	18
<i>Korniza institucionale.....</i>	<i>18</i>
<i>Modeli i "Institucionit të Ndihmës Juridike".....</i>	<i>19</i>
<i>Modeli gjyqësor</i>	<i>21</i>
<i>Institucionet që punojnë veçanërisht me ndihmën juridike për fëmijët.....</i>	<i>23</i>
<i>Financimi i Ndihmësi Juridike.....</i>	<i>24</i>
<i>Dallimet midis tarifave të paguara për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët krahasuar me ndihmën juridike për të rriturit.....</i>	<i>24</i>
2.4 STATISTIKAT	25
NDIHMJA JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE NË EVROPË	28
3.1 AKTET KRYESORE JURIDIKE QË RREGULLOJNË TË DREJTËN PËR NDIHMË JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE 28	
<i>Ndihma juridike në aktet kushtetuese</i>	<i>28</i>
<i>E drejta për ndihmë juridike në Kodet e Procedurës Penale dhe Kodet Gjyqësore.....</i>	<i>30</i>
<i>Aktet ligjore që adresojnë në mënyrë specifike ndihmën juridike</i>	<i>30</i>
<i>Rezolutat Qeveritare dhe Aktet Ministrore</i>	<i>31</i>
3.2 RREGULLORET SPECIFIKE PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN	32
<i>Instrumente të krijuara specifikisht për drejtësinë për fëmijë.....</i>	<i>33</i>
<i>Instrumentet e përgjithshme që adresojnë ndihmën juridike në parashikimet e tyre.....</i>	<i>34</i>
3.3 KRITERET PËR MARRJEN E NDIHMËS JURIDIKE, BURIMET DHE MERITAT.....	35
3.4 NDIHMJA JURIDIKE PËR FËMIJËT VIKTIMA TË KRIMIT	37
KRITERET PËR OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE	38
4.1 PROFESIONISTËT E AUTORIZUAR PËR TË OFRUAR NDIHMË JURIDIKE PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN	39
4.2 DETYRIMET PËR OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE	41

<i>Kërkesa të përgjithshme për ofruesit e ndihmës juridike</i>	41
<i>Kërkesa specifike për ofruesit e ndihmës juridike që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët</i>	42
4.3 TRAJNIMI I OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE	44
<i>Trajnimi fillestar i ofruesve të ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin</i>	45
<i>Trajnim i vazhdueshëm i avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike fëmijëve në konflikt me ligjin</i>	46
4.4 FUNKSIONI DHE ROLI I NJË AVOKATI QË OFRON NDIHMË JURIDIKE PËR FËMIJËT	48
4.5 MANUALE PËR ROLIN DHE MISIONIN E AVOKATËVE QË PËRFAQËSOJNË FËMIJËT NË PROCEDIMET PENALE	50
E DREJTA E FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN PËR TË MARRË NDIHMËN JURIDIKE	52
5.1 RRETHANAT KUR NJË FËMIJË NË KONFLIKT ME LIGJIN KA TË DREJTËN E NDIHMËS JURIDIKE.....	52
5.2 AKSESI NË INFORMACION NË LIDHJE ME NDIHMËN JURIDIKE.....	57
<i>Informimi i gjerë i fëmijëve dhe popullatës për ndihmën juridike</i>	57
<i>Institucionet dhe organizatat që ofrojnë informacion mbi ndihmën juridike</i>	58
<i>Detyrimi për të informuar një fëmijë që është i dyshuar, i akuzuar ose i dënuar</i>	59
<i>Prezantimi i informacionin në një mënyrë miqësore për fëmijët</i>	61
5.3 ZGJEDHJA DHE NDRYSHIMI I AVOKATIT	63
<i>Parimi i zgjedhjes së lirisë së avokatit për fëmijët në konflikt me ligjin që përfitojnë nga ndihma ligjore</i>	63
<i>Roli i prindërve ose kujdestarëve kur zgjedhim një avokat</i>	64
<i>Mundësia e ndryshimit të avokatit</i>	66
5.4 PËRKTHIMI NË NDËRVEPRIMIN FËMIJË-AVOKAT	67
MBROJTJA E INTERESAVE TË FËMIJËS NË KONFLIKT ME LIGJIN.....	69
6.1 MBROJTJA E INTERESAVE TË FËMIJËS NË RASTET E KONFLIKTIT TË INTERESIT	70
6.2 OFRIMI I ASISTENCËS PSIKOLOGJIKE DHE PËRFSHIRJA E INSTITUCIONEVE TË MBROJTJES SË FËMIJËS NË PROCEDIMIN PENAL.....	72
6.3 TË TJERA ENTITETE QË OFROJNË MBËSHTETJE (JURIDIKE) PËR FËMIJËT E PËRFSHIRË NË PROCEDIME PENALE	75
VLERËSIMI I NDIHMËS LIGJORE.....	78
KONKLUZIONE: CFARË ËSHTË NDIHMA LIGJORE MIQËSORE PËR FËMIJËT?	82
<i>Ndihma ligjore e aksesueshme</i>	82
<i>Ndihma ligjore e ofruar nga avokatë të specializuar në fushën e drejtësisë për të mitur</i> ..	83
<i>Ndihmë ligjore e përshtatshme me moshën</i>	84
<i>Qasja multidiciplinore</i>	84
<i>Ndihma ligjore për fëmijët me nevoja të vecanta</i>	84
<i>Vlerësimi i cilësisë së ndihmës ligjore</i>	85

PERKUFIZIME DHE AKRONIME

Fëmijë	Qënie njerëzore nën moshën 18 vjec
Fëmijë në konflikt me ligjin	Një person i cili ka arritur moshën e përgjegjësisë penale, por jo moshën e pjekurisë (nën 18 vjec), i/e cili/a dyshohet apo akuzohet se ka kryer një veprë penale sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. (KDF/C/GC/10, Hyrje, §1). Moshë e cila merret në konsideratë për të përcaktuar nëse një fëmijë është apo jo në konflikt me ligjin, është mosha kur është kryer vepra penale
Sistemi i Drejtësisë për të Mitur	Legjislacioni, normat dhe standardet, procedura, mekanizmat dhe masat të cilat aplikohen tek të miturit në konflikt me ligjin si dhe institucionet e përfshira në këtë proces. (KDF/C/GC24, III. Terminologji, §8)
GjDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian
Këshilli i Europës	KE
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KDNJ	Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (e njohur gjërësisht si Konventa e të Drejtave të Njeriut)
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
AEDTH	Agjensia Europiane për të Drejtat Themelore
KNKBDPCP	Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Civile dhe Politike
Ndihmë Ligjore	Dhënia a këshillimit, asistencës apo përfaqësimit ligjor mbi shpenzimet e shtetit, bazuar mbi kushtet dhe procedurat e vendosura sipas ligjit në

	fuqi për personat në paraburgim, të arrestuar apo të burgosur; për personat e dyshuar apo akuzuar, apo të dënuar për një vepër penale; dhe për viktime apo dëshmitarë në një proces penal. Ndihma ligjore përfshin edukimin ligjor dhe aksesin mbi informacion ligjor dhe shërbime të tjera të ofruara nëpërmjet mekanizmave alternative të zgjidhjes së konfliktit apo proceseve të drejtësisë restauruese . ¹
Autoriteti i ndihmës ligjore	Autoriteti i përcaktuar me ligj për menaxhimin, koordinimin dhe ofrimin e ndihmës ligjore. ²
Ofrues i ndihmës ligjore	Cdo person i cili ofron ndihmë ligjore
UNICEF	United Nations Children' s Fund/ Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
ZKBDK	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin

¹ Model Laë on Legal Aid in Criminal Justice Systems. United Nations. Vienna, 2017.: [ëëë.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/LegalAid/Model_Laë_on_Legal_Aid.pdf](http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/LegalAid/Model_Laë_on_Legal_Aid.pdf)

² *Ibid.*

HYRJE

Projekti i bashkëfinancuar nga BE i cili titullohet *Ndihmë Ligjore për Fëmijët në Konflikt me Ligjin: perzantimi i praktikave më të mira* (LA CHILD), po zbatohet nga një konsorsium i përbërë nga Instituti i Ligjit pranë Qendrës Lituanëze për Studime Sociale (ILL, drejtuesi i projektit), Mbrojtje për Fëmijët, (Defence for Children International, DCI) Belgjikë dhe Qendra për Shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara (QSHPLI) Shqipëri. Projekti filloi në Shkurt 2020 dhe do të përfundojë në Dhjetor 2021.

Projekti mori shkas nga parimi se vulnerabiliteti i fëmijëve në konflikt me ligjin për shkak të moshës së tyre dhe mosjekurisë fizike, mendore dhe sociale, përcakton nevojën për të ushtruar një kujdes të vecant për ta. Kjo con në një angazhim të vashtueshëm për të mbrojtur të drejtat dhe interesin më të lartë të fëmijës në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe standardeve të tjera ndërkombëtare. Cdo fëmijë që përballlet me sistemin e drejtësisë në cilësinë e të dyshuarit apo të akuzuarit duhet të marrë ndihmën e duhur ligjore. Respektimi i të drejtave të fëmijës do të varet ngushtë nga niveli i ndihmës ligjore që do të ofrohet.

Qëllimi primar i projektit është të kontribojë në përmirësimin e zbatimit të të drejtave procedurale të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe të nxisë aplikimin e duhur të Direktivës 2016/800 mbi procedurat e sigurisë për fëmijët e dyshuar apo akuzuar për një vepër penale³ në vendet e BE. Për këtë qëllim, projekti do prezantojë praktika pozitive dhe qasje inovatore të cilat mund të aplikohen në vendet e BE si dhe do të oranzojë aktivitete për rritjen e kapaciteteve të profesjonistëve të ligjit.

1.1 Zbatuesit e projektit dhe organizatat/institucionet mbështetëse

Pak fjalë për organizatat zbatuese të projektit, studjuesit e përfshirë dhe organizatat/institucionet që e kanë mbështetur atë.

Instituti i **Ligjit pranë Qendrës Lituanëze për Shkenca Sociale** (ILL), e cila është organizata që udhëheq projektin Ajo ka një eksperiencë të gjatë në ofrimin e konsulencave ligjore dhe kryerjen e kërkime shkencore në fushën e të drejtave të fëmijëve, ndihmës ligjore, legjislacionit penal dhe si dhe legjislacionin e BE mbi këtë çështje. ILL është përfshirë së fundmi në një projekt të bashkëfinancuar nga BE që titullohet: Përmirësimi i Cilësisë së Ndihmës Ligjore; Standarde të Përgjithshme për Vënde të Ndryshme (QUAL-AID)⁴.

³ Directive (EU) 2016/800 of the European Parliament and of the Council of 11 May 2016 on procedural safeguards for children who are suspects or accused persons in criminal proceedings. OJ L 132, 21.5.2016, p. 1–20.

⁴ See: <http://teise.org/en/lti-veikla/projektines-veiklos/teisines-pagalbos-kokybes-didinimas-bendrieji-standartai-skirtingoms-salims/>

Defence for Children, (DCI), Belgjikë, është degë e lëvizjes botërore Defence for Children International (DCI). Qëllimi i kësaj organizate është të promovojë dhe mbrojë të drejtat e fëmijëve në nivel lokal, rajonal dhe global. DCI-Belgjikë, ka punuar në fushën e drejtësisë për të mitur për shumë vite duke u përpjekur të mbrojë të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë. DCI ka qënë organizata udhëheqëse e projektit të bashkëfinancuar nga BE, My Lawyer, My Rights⁵, i cili synoi të rrisë nivelin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin.

Qendra për Shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara (QSHPLI) është një organizatë shqiptare jo-fitimprurëse me një eksperiencë të gjatë në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe drejtësisë për të miturit. Aktiviteti i saj fokusohet në dhënien e ndihmës ligjore dhe psikologjike ndaj fëmijëve në konflikt dhe në kontakt me ligjin. Për më shumë se një dekadë, QSHPLI ka asistuar një numër të lartë fëmijësh në të gjitha hapat e procedurës ligjore. Ajo ka kryer gjithashtu një sërë studimesh të rëndësishme mbi legjislacionin shqiptar dhe të drejtat e fëmijëve.

Studjuesit që kanë hartuar këtë raport janë Dr Agne Limante (Drejtore e projektit, ILL), Dr, Simona Nikartas (ILL), Dr Ruta Vaiciuniene (ILL), Znj Eva Gangnex (DCI – Belgjikë), Znj, Blandine Lens (DCI – Belgjikë), Z. Klodian Gega (QSHPLI), Znj, Holta Zacaj (QSHPLI), Znj, Rezarta Abdiu (QSHPLI)

Projekti mbështetet nga disa institucione relevante në vendet e partnerëve zbatues të tij sic janë: Ministria e Drejtësisë se Republikës së Lituanisë, Shërbimi Ligjor Shtetëror në Lituani, Dhoma Lituanëze e Avokatisë, Dhoma e Avokatisë në Belgjike, dhe Dhoma Shqiptare e Avokatisë.

Një ndihmë të rëndësishme në projekt ka dhënë dhe firma ligjore DLI PIPER, e cila ka dege në më shumë se 30 shtete. Ajo ka kryer *pro bono* komponentin e shqyrtimit të dokumentave ligjorë në 11 shtete të Europës.

1.2 Aktivitetet e Projektit

Ky projekt përbëhet nga aktivitet e mëposhtme:

- Analizë e kuadrit ligjor Europian mbi ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin. Aktivitet e projektit filluan me analizën e rregulloreve dhe praktikave të ndihmës ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin në vëndet Europiane. Për këtë qëllim, u krye një analizë e dokumentave relevantë në 14 shtete, si dhe u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar me profesjonistë të ligjit në Lituani, Belgjikë dhe Shqipëri. Gjithashtu, u analizuan dhe rregulloret e BE dhe rregulloret e tjerat ndërkombëtare.
- Hartimi i një manuali mbi ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin dhe i një versioni të tij të përshtatur për fëmijët. Manualet do bazohen në praktikat pozitive të

⁵ For more information and the materials please refer to: ëëë.mylaëyermyrights.eu

prezantuara në këtë raport si dhe në konsultime me ekspertë të fushës nga disa shtete Europiane.

- Zhvillimi i një konference ndërkombëtare ku ekspertë nga shtete të ndryshme mund të ndajnë njohuritë dhe mendimet e tyre mbi ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin. Konferenca do të jetë një nga burimet që do të gjenerojë ide për hartimin e manualeve.
- Trajnime për gjyqtarë, avokatë dhe punonjës social. Trajnimet do të kryhen në Lituani, Belgjikë dhe Shqipëri.
- Zhvillimi i një tryeze të rrumbullakët mbi politikat e ndërmarra në fushën e drejtësisë për të mitur. Në tryezë do të diskutohen dhe gjetjet kryesore dhe praktikat më të mira të evidentuara në shtetet europiane.
- Promovimi dhe shpërndarja e produkteve të projektit

Më tepër informacion në lidhje me projektin mund të gjeni tek:

<https://lachild.eu/>

<https://www.facebook.com/LAChildEU>

Regjistrimi i konferencës ndërkombëtare mund të gjehet tek liku më poshtë

<https://childhub.org/en/child-protection-multimedia-resources/legal-aid-children-criminal-proceedings-child-friendly-legal>

METODOLOGJIA

Countries where the research was conducted

- Desk research and interviews
- Desk research



Raporti prezanton një panoramë të rregulloreve dhe praktikave në vendet e Europiane në lidhje me ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin. Ai përmban një analizë të instrumentave ligjor të BE dhe KE, legjislacionit dhe dokumentave relevante në 14 shtete si dhe gjetjet e intervistave gjysmë të strukturuar me profesionistë të ligjit. Secili nga këta komponentë do të shpjegohet në vijim.

1.1 Analiza e instrumentave relevant të BE dhe KE

Studimi i zhvilluar në kuadër të projektit filloi me analizën e rregulloreve ndërkombëtare relevante të BE dhe KE. Studjuesit shqyrtuan në mënyrë shterruese instrumentat kryesor ndërkombëtar që lidhen me ndihmën ligjore ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin.

Raporti i titulluar " ***Ndihma Ligjore për Fëmijët në Konflikt me Ligjin dhe Instrumentat European***" gjëndet te faqia e projektit:

<https://lachild.eu/ep-content/uploads/2020/12/INTERNA-AND-EU-INSTRUMENT-FINAL.pdf>

1.2 Shqyrtimi i literaturës

Ky komponent i studimit synoi të analizoje praktikat dhe procedurat ligjore mbi ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin në 14 shtete Europiane. Për këtë qëllim, ekipi i studjuesve hartoi një pyetësor që do lejonte një njohje më të mirë të modeleve të ndryshme të ndihmës ligjore, sfidave kryesore që hasen në juridiksione të ndryshme si dhe identifikimin e praktikave më të mira të ndihmës ligjore për fëmijët.

Pyetësori u shpërnda në 14 shtete të cilat u përzgjedhën mbi bazën e pozicionit gjeografik dhe qasjeve të ndryshme mbi ndihmën ligjore. Vendet të cilat u përfshinë në studim janë si më poshtë:

1. Austri
2. Belgjike
3. Gjermani
4. Hungari
5. Irland
6. Itali
7. Finland
8. Francë
9. Lituani
10. Republika Çeke
11. Poloni
12. Spanjë
13. Shqipëri
14. Suedi

Në vendet ku ndodhen organizatat të cilat po zbatojnë projektin (Lituani, Belgjike, Shqipëri) administrimi i pyetësorit u krye nga ato. Në shtetet e tjera pyetësori u administrua nga DLA Piper. DLA Piper mbështeti projektin duke kryer hulumtime dokumentare ligjore ligjore pro bono në 11 vende evropiane.

Raportet për secilin shtet mund të gjehen në faqen e projektit

<https://lchild.eu/the-projects/la-child/national-reports/>

1.3 Intervistat gjysmë të strukturuar

Përveç hulumtimit të literaturës, **intervista gjysmë të strukturuar me profesionistë të ligjit** u zhvilluan në vendet ku zbatohet Projekti (Shqipëri, Belgjikë, Lituani). Intervistat gjysmë të strukturuar u organizuan në bazë të udhëzuesit për intervista të hartuar nga ekipi i Projektit. Partnerët e projektit adaptuan udhëzuesin për intervistë në kontekstin kombëtar të vendit të tyre. Në secilin nga tre vendet, 10-15 profesionistë (avokatë, gjyqtarë, përfaqësues të bordeve të ndihmës juridike, OJF) u intervistuan si për të kuptuar se si kërkesat juridike ndiqen në praktikë, ashtu edhe për të vlerësuar mundësinë e funksionimit të sistemit të ndihmës juridike.

Në **Belgjikë**, procesi i intervistimit përfshiu 15 profesionistë të drejtësisë për të rinjtë, 14 të anketuar u intervistuan dhe një person iu përgjigj pyetësorit me shkrim. 11 të anketuar ishin avokatë të rinj, 4 administronin një zyrë të ndihmës juridike ose kishin një rol në zyrën e tyre të ndihmës juridike dhe 2 ishin punonjës socialë që trajtonin fëmijë në konflikt me ligjin. Intervistat u kryen në periudhën korrik-shtator të vitit 2020. Me qëllim përshtatjen me masat e sigurisë për shkak të pandemisë së koronavirusit, 11 profesionistë u intervistuan përmes telekonferencës dhe 3 u intervistuan fizikisht.

Duke marrë parasysh faktin se ndihma juridike për fëmijët në konflikt me ligjin dhe ligjin për të rinjtë ndryshon në të gjithë Belgjikën, dhe për të arritur një mbulim gjeografik përfaqësues, profesionistë nga 11 Shoqata të Dhomës së Avokatisë prej 20 ekzistueseve në Belgjikë morën pjesë në intervista. Për më tepër, në mënyrë që të sigurohej përfaqësimi gjuhësor, anëtarët e të tre komuniteteve gjuhësore (gjuhës flamenge, gjuhës frënge dhe gjuhës gjermane) u përfshinë në këtë kërkim.

Me qëllim marrjen pjesë në kërkim, secili i intervistuar nënshkroi një formular, ku ishte dakortë që të përfshinte informacionin vijues:

- Qëllimi i projektit dhe përdorimi i informacionit të mbledhur gjatë intervistës;
- Garancitë e anonimitetit;
- Natyra vullnetare e pjesëmarrjes në kërkim.

Në **Lituani**, u zhvilluan 10 intervista, 8 prej të cilave ishin me juristë (avokatë) duke siguruar ndihmë juridike të garantuar nga shteti për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar, dhe 2 me prokurorë të specializuar në fushën e drejtësisë penale për të rinjtë. Kur u krye ky kërkim, u vendos kontakti me Shërbimin e Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti, i cili siguroi një listë të avokatëve që zakonisht përfaqësonin fëmijët e dyshuar ose të akuzuar për një vepër penale.

Kërkimi nuk u kufizua vetëm në qytetet e mëdha, por përfshiu edhe juristë që punojnë në rajone më të vogla. Në çështjet penale kur jepet një mbrojtje e detyrueshme për fëmijët e dyshuar dhe të akuzuar, ndihma juridike dytësore sigurohet ose nga avokatë të përhershëm (*të cilët punojnë ekskluzivisht për Shërbimin e Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti dhe ofrojnë shërbime juridike private*) ose nga avokatë që thirren (të cilët janë në praktikë private dhe mund të kontaktohen nga Shërbimi i Ndihmës Juridike i Garantuar nga Shteti në rast nevojë). Si rrjedhojë, i njëjti numër i avokatëve të përhershëm dhe i atyre që funksionojnë në bazë thirjesh, u zgjodhën për kërkimin.

Para kryerjes së intervistave gjysmë të strukturuar, pjesëmarrësit u njohën me qëllimin dhe procedurën e kërkimit, duke siguruar anonimitetin e tyre. Intervistat u kryen midis muajit gusht 2020 dhe tetor 2020.

Në **Shqipëri**, u kryen 15 intervista gjysmë të strukturuar me profesionistë ligjorë. Intervistat u zhvilluan me 12 avokatë, 2 gjyqtarë dhe 1 prokuror. Çdo intervistë zgjati nga 60 deri në 80 minuta. Në fillim të bisedës, secili i intervistuar u informua mbi qëllimin e projektit dhe qëllimin e intervistës, dhe gjithashtu u informua se si do të përdoren informacionet e marra nga intervista, si dhe për zbatimin e standardit të konfidencialitetit. Meqenëse Tirana është qyteti me popullsinë më të madhe, 9 nga avokatët e zgjedhur kanë punuar në Tiranë në kohën e intervistës, dhe 3 të tjerë kanë punuar në qytete më pak të populluara.

Vlen të përmendet që gjatë karrierës së tyre profesionale të gjithë pjesëmarrësit e përzgjedhur kanë punuar si me të rritur edhe fëmijë, në çështje penale ose civile. Ata kanë siguruar lloje të ndryshme të shërbimeve juridike duke përfshirë këshillimin ligjor për fëmijët ose anëtarët e familjes së tyre, pjesëmarrjen në seancën e marrjes në pyetje në rajonin e policisë, zyrën e prokurorisë ose sallën e gjyqit, si dhe përfaqësimin e çështjeve në të gjitha hapat e procedurave juridike. Intervistat u kryen gjatë muajve gusht dhe shtator 2020.

Ky raport përmbledh dhe analizon rezultatet e këtij kërkimi të detajuar.

SISTEMET E NDIHMËS JURIDIKE NË JURIDIKSIONET EVROPIANE

2.1 E drejta e përgjithshme për ndihmë juridike

Komuniteti ndërkombëtar pranon gjerësisht se ndihma juridike është një element thelbësor për një sistem funksional të drejtësisë penale bazuar në shtetin e së drejtës. Kjo u pohua, së fundmi në Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara 2012 mbi Qasjen në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale (Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara 2012).

Ndihma Juridike është një element thelbësor i një sistemi të drejtësisë penale humane dhe eficiente që bazohet në shtetin e së drejtës. Ndihma juridike është një bazë për gëzimin e të drejtave të tjera, përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë, siç përcaktohet në nenin 11, paragrafi 1, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, një parakusht për ushtrimin e këtyre të drejtave dhe një mbrojtje e rëndësishme që siguron drejtësi themelore dhe besim të publikut në procesin e drejtësisë penale.

Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Aksesin në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale

Ndihma juridike gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në aspekte të tjera. Siç thuhet në Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara 2012, ndihma juridike është thelbësore për lehtësimin e shmangies dhe përdorimit të sanksioneve dhe masave të bazuara në komunitet, duke përfshirë masa jo me burgim, duke promovuar përfshirje më të madhe të komunitetit në sistemin e drejtësisë penale, duke reduktuar përdorimin e panevojshëm të paraburgimit dhe burgimit, duke racionalizuar politikën e drejtësisë penale dhe sigurimin e përdorimit efikas të burimeve Shtetërore.

Në nivel ndërkombëtar, e drejta për ndihmë juridike falas për të gjithë personat e akuzuar për një vepër penale u krijua për herë të parë në 1966 në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Veçanërisht, neni 14 i Paktit thotë se *çdokush i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të gjykohet në praninë e tij/saj dhe të mbrohet personalisht ose përmes ndihmes juridike të zgjedhur prej tij/saj ose të caktuar atij/ asaj aty ku e kërkojnë interesat e drejtësisë, në një seancë dëgjimore të drejtë dhe publike nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.* Që prej asaj kohe, shumë dokumente juridike ndërkombëtarë dhe rajonalë janë miratuar për të krijuar dhe forcuar sisteme të ndihmës juridike në të gjithë botën.

Në Europë, tani mund të themi me siguri se e drejta për ndihmë juridike falas, në rastet kur një person nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për të (provë financiare) dhe kur e kërkojnë interesat e drejtësisë (testi i meritave), është rrënjësor plotësisht. Ajo mbrohet gjithashtu nga

neni 6 (3) (c) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Sistemet e Ndhmës Juridike ekzistojnë në të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (BE) si për procedurat civile, ashtu edhe penale. Për më tepër, e drejta për të patur një avokat në procedurat penale në shtetet e BE-së zbatohet gjatë gjithë procedurës, nga marrja në pyetje e policisë (*ose marrja në pyetje nga një autoritet tjetër i zbatimit të ligjit ose nga një autoritet gjyqësor*) e deri tek apelimi.

Ligji i BE-së parashikon të drejtën për ndihmë juridike në Nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Direktiva e BE 2016/1919 mbi ndihmën juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurat evropiane të urdhër arrestit rregullon të drejtën për ndihmë juridike dhe përcakton standardet e saj të cilësisë. Ai parashikon që Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të dyshuarit dhe personat e akuzuar që nuk kanë burime të mjaftueshme për të paguar për shërbimin e një avokati, kanë të drejtën e ndihmës juridike kur e kërkojnë interesat e drejtësisë.⁶

Sidoqoftë, instrumentet e BE-së nuk rregullojnë procesin e sigurimit të ndihmës juridike në detaje. Kjo është lënë në kompetencën e shteteve dhe të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së kanë legjislacionin e tyre që rregullon mënyrat dhe rastet në të cilat ndihma juridike do të sigurohet në procedurat penale brenda juridiksionit të tyre.

Në përgjithësi, e drejta për ndihmë juridike në procedurat penale në vendet evropiane i nënshtrohet mjeteve financiare dhe/ ose testeve të meritës. Kjo është në përputhje me direktivën e BE 2016/1919 e cila thotë se Shtetet Anëtare mund të zbatojnë një kontroll të nevojës, një provë meritash ose të dyja, për të përcaktuar nëse ndihma juridike duhet të jepet.

Direktiva (BE) 2016/1919 mbi ndihmën juridike për personat e dyshuar dhe personat e akuzuar në procedurat penale

Neni 4. Ndhimja juridike në procedurat penale

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar që nuk kanë burime të mjaftueshme për të paguar për ndihmën e një avokati, kanë të drejtën e ndihmës juridike kur e kërkojnë interesat e drejtësisë.
2. Shtetet Anëtare mund të aplikojnë një kontroll të nevojës, një test meritash ose të dyja për të përcaktuar nëse ndihma juridike do të jepet në përputhje me paragrafin 1.
3. Kur një Shtet Anëtar aplikon një kontroll të nevojës, ai do të marrë parasysh të gjithë faktorët e rëndësishëm dhe objektivë, siç janë të ardhurat, kapitali dhe situata familjare e personit në fjalë, si dhe kostot e ndihmës së një avokati dhe standardin për të jetuar në atë Shtet Anëtar, në mënyrë që të përcaktohet nëse, në përputhje me kriteret e zbatueshme në atë Shtet Anëtar, një

⁶ Për analizë të qëndrueshme të instrumenteve ndërkombëtare dhe evropiane, ju lutemi referojuni "Raportit" Ndhimja Juridike për Fëmijët në Konflikt me Ligjin në Instrumentet Ndërkombëtare dhe Evropiane" i cili është në dispozicion në faqen e internetit të projektit: <https://lchild.eu/wp-content/uploads/2020/12/INTERNA-AND-EU-INSTRUMENT-FINAL.pdf>.

person i dyshuar ose i akuzuar nuk kanë burime të mjaftueshme për të paguar për shërbimin e një avokati.

4. Kur një Shtet Anëtar aplikon një test meritash, ai do të marrë parasysh seriozitetin e veprës penale, kompleksitetin e çështjes dhe ashpërsinë e sanksionit në fjalë, në mënyrë që të përcaktojë nëse interesat e drejtësisë kërkojnë dhënien e ndihmës juridike. Në çdo rast, testi i meritave do të konsiderohet se është përmbushur në situatat e mëposhtme:

(a) Kur një person i dyshuar ose i akuzuar sillet para një gjykate ose gjykatësi kompetent për të vendosur mbi paraburgimin në çdo fazë të procedurës brenda fushës së veprimit të kësaj Direktive; dhe

(b) Gjatë kohës së ndalimit.

Kontrolli i nevojës përdoret për të vlerësuar aftësinë financiare të një personi për të mbuluar tarifat e ndihmës juridike⁷. Nëse një person nuk ka mjete të mjaftueshme financiare, ai ose ajo mund të kualifikohet për ndihmë juridike. Sipas direktivës së BE-së 2016/1919, kur një shtet i BE-së aplikon një kontroll të nevojës, ai do të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës dhe objektivë, siç janë të ardhurat, kapitali dhe gjendja familjare e personit në fjalë, si dhe kostot e ndihmës së një avokati dhe standardi i jetesës në atë Shtet Anëtar, në mënyrë që të përcaktohet nëse, në përputhje me kriteret e zbatueshme në atë Shtet Anëtar, një person i dyshuar ose i akuzuar nuk ka burime të mjaftueshme për të paguar për shërbimin e një avokati. Për të qartësuar kontrollin e nevojës, të ardhurat vjetore bruto dhe nivelet e pronës përcaktohen zakonisht nga shtetet.

Sidoqoftë, nuk është gjithmonë kështu. Për shembull, në Irlandë aplikantët për ndihmë juridike duhet të përmbushin kërkesën e gjykatës se mjetet e tyre janë të pamjaftueshme për t'i lejuar ata të paguajnë vetë për ndihmën juridike. Kjo është thjesht një çështje e lirisë së veprimit për secilën gjykatë dhe nuk rregullohet nga ndonjë udhëzues i përshtatshmërisë financiare.⁸

Testi i Meritave shpesh përdoret së bashku me kontrollin e nevojës; megjithatë, në raste të caktuara do të zbatohen vetëm kontrollet e meritave. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, përcaktimi nëse 'interesat e drejtësisë' (meritat) kërkojnë sigurimin e ndihmës juridike përfshin marrjen në konsideratë të tre faktorëve, përkatësisht: (i) seriozitetin e veprës penale dhe ashpërsinë e dënimit të mundshëm; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) situatën shoqërore dhe personale e të pandehurit⁹. Të tre faktorët duhet të merren në konsideratë, dhe secili prej

⁷ Sipas testit kontrollues, shikoni mëposhte rastet ECtHR: ECtHR, Croissant v. Germany, No. 13611/88, 25 Shtator 1992, ECtHR, Pakelli v. Germany, Nr. 8398/78, 25 Prill 1983; ECtHR, R.D. v. Poland, Nos 29692/96 dhe 34612/97, 18 Dhjetor 2001; ECtHR Tsonyo Tsonev v. Bulgaria (Nr.2), Nr. 2376/03, 14 Janar 2010.

⁸ (Ireland) Shih Seksionet 2 - 6 të Aktit të Drejtësisë Penale (Ndhima Juridike) 1962.

⁹ ECtHR, Quaranta v. Switzerland, Nr.12744/87, 24 Maj 1991. Shikoni gjithashtu ECtHR, Artico v. Italy, Nr. 6694/74, 13 Maj 1980; ECtHR, Pham Hoang v. France, Nr. 13191/87, 25 Shtator, 1992; ECtHR, Zdravko Stanev v. Bulgaria Nr. 32238/04, 6 Nentor 2012; ECtHR, Benham v. Mbreteria e Bashkuar, Nr. 19380/92, 10 Qershor 1996.

të treve mund të justifikojë dhënien e ndihmës juridike¹⁰. Në rastet kur një person akuzohet për një vepër që mund të dënohet me një afat burgimi (ose me paraburgim¹¹), interesat e drejtësisë në parim kërkojnë përfaqësim ligjor.

Ky arsyetim reflektohet edhe në aktet juridike të BE-së. Sipas Direktivës së BE 2016/1919, kur një Shtet Anëtar aplikon një kontroll meritash, ai do të marrë parasysh seriozitetin e veprës penale, kompleksitetin e çështjes dhe ashpërsinë e sanksionit në fjalë, për të përcaktuar nëse interesat dhe drejtësia kërkon dhënien e ndihmës juridike. Në çdo rast, kontrolli i meritave do të konsiderohet se është përmbushur në situatat e mëposhtme: (i) kur një person i dyshuar ose i akuzuar sillet para një gjykate ose gjykatësi kompetent për të vendosur mbi paraburgimin në çdo fazë të procedurës brenda fushëveprimit të kësaj Direktive; dhe (ii) gjatë kohës së ndalimit.

2.2 Ndhima Juridike parësore dhe dytësore

Në shumë vende evropiane, ndihma juridike është e organizuar në disa nivele. Dy nivelet kryesore janë ndihma juridike kryesore dhe ajo dytësore. Ndhima juridike parësore (linja e parë) përfshin konsultime dhe këshilla juridike për çështje ligjore, ndërsa ndihma juridike dytësore (linja e dytë) ka për qëllim të sigurojë ndihmë në çështje gjyqësore.

Në disa vende, *ndihma juridike paraprake* është gjithashtu e disponueshme - kjo zakonisht përbëhet nga një platformë online që ndihmon në gjetjen e informacionit përkatës. Një shembull i një sistemi të tillë është **Hollanda**. Sistemi holandez i ndihmës juridike është në thelb një model i trefishtë në atë që përfshin tre 'linja' të ofrimit të ndihmës juridike: (i) një dispozitë paraprake publike, (ii) ndihmë juridike e linjës së parë publike - Sportele të Shërbimeve Juridike dhe (iii) ndihmë private e linjës së dytë - një avokat privat ose një ndërmjetës. Niveli paraprak i ndihmës juridike në sistemin Holandez ofrohet nga *Rechtëijzer* (Udhërrëfyesi për Drejtësi) i cili është një portal në internet me informacion ligjor për vetë-ndihmë që ofron udhëzime për zgjidhjet e mundshme për problemet më të zakonshme juridike, siç është divorci.¹²

Sistemi i ndihmës juridike **Lituaneze** siguron ndihmë juridike në dy nivele - ndihmë juridike parësore dhe dytësore. Ndhima juridike parësore (ndihmë juridike e linjës së parë) përfshin këshillat ligjorë dhe hartimin e dokumenteve që do të paraqiten në institucionet shtetërore dhe komunale, përveç dokumenteve procedurale. Kjo ndihmë ofrohet falas në institucionet lokale (ka 60 komuna në Lituani) nga punonjësit komunalë dhe jepet pavarësisht nga gjendja financiare e dikujt. Aplikantët këshillohen personalisht me të mbërritur në komunë. Megjithatë, në raste të caktuara, komunat preferojnë të lidhin marrëveshje për sigurimin e ndihmës juridike

¹⁰ ECtHR, *Zdravko Stanev v. Bulgaria*, Nr. 32238/04, 6 Nentor 2012.

¹¹ ECtHR, *Quaranta v. Switzerland*, No. 12744/87, 24 May 1991, para. 33; ECtHR, *Perks and others v. the United Kingdom*, Nos. 25277/94, 25279/94, 25280/94, 25282/94, 25285/94, 28048/95, 28192/95 and 28456/95, 12 October 1999.

¹² Report of Workstream 1. EU co-funded project "*Enhancing the Quality of Legal Aid: General Standards for Different Countries*" (QUAL-AID) (JUST/2015/JACC/AG/PROC/8632). Available at: <http://qualaid.vgtpt.lt/sites/default/files/0916902001555398891.pdf>

parësore me avokatët (*në vitin 2019, ky opsion u zgjodh prej 2 nga 60 komuna*). Për më tepër, institucionet publike të cilat kanë lidhur marrëveshje për sigurimin e ndihmës juridike parësore me një institucion komunal ose Shërbimin e Ndhmës Juridike të Garantuar nga Shteti (*Valstybės garantuojamos teisinės pagalbos tarnyba*) kanë të drejtë të ofrojnë ndihmë juridike parësore (*vetëm Klinikat e Ndhmës Juridike të Universitetit Vilnius, të cilat lidhën një marrëveshje me Komunën e Qytetit Vilnius, e kanë këtë status*).

Ndihma juridike dytësore sigurohet nga juristët (avokatët, në raste të caktuara nga bashkëpunëtorët) dhe financohet nga shteti. Ajo përfshin shërbimet juridike në lidhje me përfaqësimin në gjykata (*përfshirë hartimin e dokumenteve, mbrojtjen dhe përfaqësimin në procedura*), përfshirë procedurat e përmbarimit. Ndhma juridike dytësore bazohet në kontrolle të nevojës dhe të meritave. Në raste të caktuara, aplikohet vetëm një kontroll i meritave, në të tjerat duhet të plotësohen të dyja. Ndhma juridike dytësore mund të jetë falas ose pjesërisht falas.

Në **Belgjikë**, termi ndihmë juridike i referohet edhe ndihmës juridike të linjës së parë dhe të linjës së dytë. Ndhma juridike e linjës së parë përcaktohet nga ligji si "ndihmë juridike e dhënë në formën e informacionit praktik, informacionit ligjor, një mendimi të parë juridik ose referimit në një organ ose organizatë të specializuar".¹³

Në **Belgjikë**, termi ndihme juridike i referohet edhe ndihmës juridike të linjës së parë dhe të linjës së dytë. Ndhma juridike e linjës së parë përkufizohet nga ligji si "*ndihmë juridike e dhënë në formën e informacionit praktik, informacionit ligjor, një mendimi të parë juridik ose referimit në një organ ose organizatë të specializuar*". Kjo është në kompetencën e komuniteteve. Konkretisht, konsiston në një konsultë ballë për ballë në një zyrë përkatëse ose me takim ose konsultë telefonike. Kjo konsultë është me kohëzgjatje të shkurtër (*dekretet në lidhje me ndihmën juridike të linjës së parë përcaktojnë që tre konsulta duhet të kryhen çdo orë*) dhe ofrohet nga juristë ose organizata të ndihmës juridike. Organizimi i ndihmës juridike të linjës së parë të siguruar nga juristët kryhet nga komisionet për ndihmë juridike (*CAJ, Commission d' aide juridique*); ekziston një komision i tillë në secilin rreth gjyqësor dhe dy në Bruksel. Juristët e përfshirë në ndihmën juridike të linjës së parë vendosen në një listë vjetore nga Shoqatat e Avokatëve. Ndhma juridike e linjës së parë është falas.

Ndhma juridike e linjës së dytë i referohet "*ndihmes juridike të dhënë një personi në formën e një mendimi të detajuar juridik ose ndihmë juridike brenda ose jashtë kornizës së një procedure ose ndihme në një proces gjyqësor, përfshirë përfaqësimin*".¹⁴ Kjo është në kompetencën e Shtetit Federal. Ajo kryhet nga juristë dhe organizohet nga zyrat e ndihmës juridike (*BAJ, Bureau d' aide juridique / BJB, Bureau juridische bijstand*). Avokatët e caktuar nga zyrat e ndihmës juridike për të ndërhyrë në kuadrin e ndihmës juridike të linjës së dytë janë ata që regjistrohen

¹³ (Belgjikë) Neni 508/1, §1 i Kodit Gjyqësor.

¹⁴ (Belgjikë) Neni 508/1, §2 i Kodit Gjyqësor.

në listën e hartuar çdo vit nga Shoqatat e Avokatisë. Ndhima juridike e linjës së dytë mund të jetë falas ose pjesërisht falas.

Në **Shqipëri**, ligji i miratuar kohët e fundit parashikon dy lloje të shërbimeve të ndihmës juridike, ndihmën juridike parësore dhe dytësore, të cilat përcaktohen nga lloji i shërbimeve të kërkuara nga përfituesit dhe nga organi që ofron shërbimin¹⁵. Ndhima juridike parësore është secili nga shërbimet e mëposhtme: (i) dhënia e informacionit në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat e zbatimit dhe ushtrimit të këtyre të drejtave si në procedurat gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore; (ii) dhënia e këshillimit; (iii) dhënia e këshillave për procedurat e ndërmjetësimit dhe mjeteve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; (iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe krijimin e dokumentacionit për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për kërkimin e ndihmës juridike dytësore; (v) përfaqësimi para organeve të administratës dhe (vi) ofrimi i të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbën ndihmë juridike dytësore. Ndhima juridike dytësore në Shqipëri kuptohet si një shërbim ligjor i ofruar për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme juridike për vënien në lëvizje të gjykatës, ofrimin e këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative dhe civile, si dhe në çështjet penale për të cilat mbrojtja e detyrueshme në përputhje me legjislacionin procedural penal nuk zbatohet.

Ndhima juridike parësore organizohet, koordinohet dhe sigurohet nga institucionet e krijuara dhe të akredituara bazuar në Ligjin për Ndhimën Juridike. Kjo përfshin oficerë të trajnuar që i përkasin skemës së ndihmës juridike falas të paguar nga Shteti, ose OJF-të e akredituara, të sponsorizuara dhe të monitoruara nga i njëjti sistem dhe Klinikat Juridike të organizuara në nivel Universitar. Ndhima juridike dytësore ofrohet ekskluzivisht nga avokatët e përfshirë në listën specifike të përgatitur nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve, prandaj ndhima juridike dytësore lidhet natyrshëm me shërbimet e ofruara nga avokatët e licencuar siç janë përgatitja e mocioneve në procedurat gjyqësore dhe përfaqësimi në Gjykatë.

Për qëllimin e këtij kërkimi, termi 'ndihmë juridike', përveç nëse thuhet ndryshe, përdoret për t' iu referuar ndihmës juridike dytësore.

2.3 Organizimi i ndihmës juridike: korniza institucionale dhe financimi

Korniza institucionale

Ekzistojnë modele të ndryshme të ndihmës juridike të organizuar. Në Evropë, shtetet zakonisht krijojnë institucione përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike (ato quhen "bordi i ndihmës juridike" , "shërbimi i ndihmës juridike, 'zyra e ndihmes juridike) ose administrimin e ndihmës juridike përmes gjykatave. Të dy modelet kanë përparësitë e tyre dhe të dy konsiderohen efektivë në sigurimin e së drejtës për ndihmën juridike.

¹⁵ (Shqipëria) Neni 5 (a) dhe (b) i Ligjit 111/2017 për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti.

Modeli i "Institucionit të Ndhmës Juridike"

Disa vende në Evropë kanë zgjedhur të krijojnë një institucion të ndihmës juridike për të administruar dhe menaxhuar sistemin e ndihmës juridike. Mund të jepen disa shembuj.

Në **Lituani**, sistemi i ndihmës juridike është i organizuar në të gjithë vendin. Rregullat kryesore përcaktohen në Ligjin për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti i Republikës së Lituanisë. Në përputhje me këtë ligj, institucionet që administrojnë ndihmën juridike të garantuar nga shteti janë: (i) Qeveria e Republikës së Lituanisë; (ii) Ministria e Drejtësisë e Republikës së Lituanisë; (iii) Institucionet komunale; (iv) Shërbimi i Ndhmës Juridike i Garantuar nga Shteti (SGLAS); (v) Dhoma e Avokatëve Lituanëz.

Qeveria përcakton nivelin e pronës dhe të ardhurave që nuk duhet të tejkalojnë për tu kualifikuar për ndihmë juridike dytësore. Ajo gjithashtu përcakton tarifën që duhet të paguhet për ndihmën juridike dytësore dhe ndërmjetësimin, si dhe rregullat për pagesën e saj. Qeveria gjithashtu kryen funksione të tjera të përcaktuara me akte juridike.

Ministria e Drejtësisë merr pjesë në përgatitjen e legjislacionit përkatës - i paraqet Qeverisë draftet e akteve juridike në lidhje me ndihmën juridike të garantuar nga Shteti. Funksionet e Ministrisë përfshijnë kontrollin e zbatimit të akteve juridike; organizimin dhe kryerjen e monitorimit të sigurimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Ministria gjithashtu ofron rekomandime për të siguruar zbatim të barabartë të ligjit; njofton banorët për mundësinë e marrjes së ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe për konditat dhe kushtet e sigurimit të ndihmës së tillë; dhe kryen funksione të tjera të përcaktuara me akte juridike.

Dhoma e Avokatisë së Lituanisë është një person juridik publik dhe mund të karakterizohet ligjërisht si një shoqatë tek e cila bëjnë pjesë të gjithë avokatët lituanëzë (anëtarësimi i detyrueshëm). Dhoma e Avokatisë kryen disa funksione në lidhje me koordinimin dhe mbikqyrjen e avokatëve dhe aktivitetet e tyre.

Ndërsa Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë kryejnë funksione të përgjithshme rregullatore, mbikqyrëse dhe koordinuese, institucioni kryesor që menaxhon sistemin e ndihmës juridike është Shërbimi i Ndhmës Juridike i garantuar nga Shteti (*Valstybės garantuojamos teisinės pagalbos tarnyba*, SGLAS), një institucion buxhetor i themeluar dhe financuar nga Ministria e Drejtësisë dhe vepron nën koordinimin e saj. SGLAS-it i janë besuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me administrimin, mbikqyrjen dhe shpenzimet, si dhe zbatimin aktual të Sistemit të Ndhmës Juridike në Lituani. Ai ka 5 ndarje territoriale dhe bashkërendon ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Ky institucion, ndër të tjera, kontrollon ofrimin e ndihmës juridike dytësore në bazë të marrëveshjeve të lidhura me avokatët. SGLAS emëron një avokat nga listat e avokatëve me të cilët ka marrëveshje për sigurimin e ndihmës juridike dytësore,

paguan tarifat për avokatët e ndihmës juridike, merr ankesa në lidhje me shërbimet e ndihmës juridike, etj. Institucioni raporton në Ministrinë e Drejtësisë.

Në **Shqipëri**, Ministria e Drejtësisë, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë (DHKA; *Dhoma Kombëtare e Avokatisë*) dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF; *Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas*) janë tre organet kryesore të përfshira në organizimin e ofrimit të ndihmës juridike. Ministria e Drejtësisë mbikqyr funksionimin e përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike ose drejtpërdrejt ose përmes Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, i cili është institucioni i dedikuar për ndihmë juridike falas nën autoritetin e Ministrit. Ministri i Drejtësisë zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike; i propozon Ministrisë së Financave projekt-buxhetin vjetor për ndihmën juridike, në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor; miraton aktet juridike brenda kompetencës së tij dhe kryen funksione të lidhura me to. Ndërkohë, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë luan një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe monitorimin e shërbimeve juridike të ofruara nga avokatët e angazhuar në sistemin e ndihmës juridike.

Në thelb të sistemit shqiptar të ndihmës juridike është DNJF, e cila është krijuar si një njësi e veçantë në varësi të Ministrit të Drejtësisë. DNJF është një organ administrativ i krijuar për të qenë mekanizmi thelbësor i sistemit të ndihmës juridike, jetik për ndihmën juridike parësore dhe dytësore. Avokatët e angazhuar në ndihmë juridike dytësore duhet të kontraktohen dhe monitorohen nga DNJF, megjithëse ndërsa ofrojnë shërbime ata mund të paguhen nga gjykata, zyra e prokurorisë apo edhe departamenti i policisë.

Në **Belgjikë**, organizimi i ndihmës juridike të linjës së dytë mbetet një kompetencë federale. Ndhma juridike e linjës së dytë organizohet nga Zyrat e Ndhmës Juridike (*BAJ, Bureau d' aide juridique / BJB, Bureau juridique bijstand*). Zyra e ndihmës juridike themelohet në çdo shoqatë avokatie nga Këshilli i Shoqatave të Avokatisë.¹⁶

"Misioni i tyre i përgjithshëm është t'i mundësojë palës ndërgjyqëse të përfitojë, kur mundet, nga një avokat i ndihmës juridike"¹⁷. Në veçanti, zyrat e ndihmës juridike organizojnë seanca javore gjatë të cilave njerëzit mund, me ose pa një takim, të shkojnë në zyrë dhe të kërkojnë që tu caktohet një avokat i ndihmës juridike (*disa nga zyrat e atashuara me Komisionet për Ndhmën Juridike gjithashtu organizojnë konsultime të ndihmës juridike të linjës së parë*). Nëse një palë ndërgjyqëse nuk flet në gjuhën e procedurave, Zyra e Ndhmës Juridike duhet të vënë në dispozicion një avokat që flet të njëjtën gjuhë me të, ose nëse nuk e mundur, të vendosë në dispozicion një përkthyes.

Ata gjithashtu ndjekin dhe kontrollojnë raportet përmbyllëse: raportet vjetore që avokatët shkruajnë në mënyrë që të paguhen për ndërhyrjet e tyre brenda kuadrit të ndihmës juridike.

¹⁶ (Belgjikë) Neni 508/7 i Kodit Gjyqësor

¹⁷ Ekstrakt i një interviste të zhvilluar në Belgjikë.

Në të vërtetë, zyrat e ndihmës juridike janë përgjegjëse për dhënien e pikëve për avokatët dhe transmetimin e numrit të përgjithshëm të pikëve të alokuara çdo vit për të krijuar një llogari globale dhe kombëtare.

Në varësi të përmasave të anëtarësisë së Dhomës së Avokatisë të cilës i përkasin, zyrat e ndihmës juridike kanë një strukturë dhe madhësi të ndryshme. Disa mbështeten ekskluzivisht te avokatët të cilët vazhdojnë të praktikojnë paralelisht me angazhime të tjera profesionale, të tjerët gjithashtu kanë punonjës që mund të jenë avokatë, juristë ose të kenë një formim tjetër. Për më tepër, Urdhri i Dhomave të Avokatisë krijon dhe përditëson listën e avokatëve që praktikojnë brenda kuadrit të sigurimit të ndihmës juridike dhe vë në dukje specializimin e tyre.

Në **Hollandë**, sigurimi i ndihmës juridike është i organizuar në mënyrë qendrore. Bordi i Ndihmës Juridike (*Raad voor Rechtsbijstand*, LAB) është një organ i pavarur menaxhues dhe i janë besuar të gjitha çështjet në lidhje me administrimin, mbikqyrjen dhe shpenzimet, si dhe me zbatimin aktual të Sistemit të Ndihmës Juridike. Ai është vendosur në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë dhe Sigurisë. Funkcionet e LAB përfshijnë përputhjen e disponueshmërisë së ekspertëve ligjorë me kërkesën për ndihmë juridike, po ashtu dhe mbikqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së shërbimeve aktuale të ofruara.

Sistemi i ndihmës juridike në **Suedi** organizohet në nivel kombëtar përmes Autoritetit Suedez të Ndihmës Juridike. Autoriteti bashkë-menaxhohet nga Gjykata e Rrethit në Sundsvall dhe Tribunali i Qirasë dhe Qiradhënies në Sundsvall. Kryetari i Gjykatës së Rrethit në Sundsvall është gjithashtu shefi i Autoritetit për Autoritetin Suedez të Ndihmës Juridike. Autoriteti është nën mbikqyrjen e Qeverisë dhe punon kryesisht me procedurat që lidhen me pagesat.

Modeli gjyqësor

Në disa nga vendet pjesëmarrëse në këtë studim kërkimor, u zgjodh një model krejtësisht i ndryshëm i ndihmës juridike nga ato që u diskutuan më lart, dhe roli kryesor në sigurimin e ndihmës juridike u jepet gjykatave.

Sistemi i ndihmës juridike **të Gjermanisë** është, nga një këndvështrim krahasues, unik për një numër arsyesh. Administrimi i drejtësisë është në parim brenda kompetencës së 16 shteteve federale dhe jo të qeverisë federale. Administrimi i ndihmës juridike u besohet sistemeve të gjykatave shtetërore. Si rezultat, nuk ekziston asnjë sistem i centralizuar i ndihmës juridike, si dhe një model i pastër gjyqësor pa ndonjë strukturë të centralizuar mbikqyr funksionimin e tij. Shërbimet ofrohen pothuajse ekskluzivisht nga avokatët në praktikën private, ku qeveria ka kufizuar kufizon rolin e saj në atë të financuesit. Ndihmës juridike në Gjermani i mungon një skemë e vërtetë, e bazuar në mjete, e ndihmës juridike penale. Në vend të kësaj, Gjermania operon një sistem përfaqësimi të urdhëruar nga gjykata në disa procedura penale.

Një përjashtim nga modeli i gjyqësorit ekziston në dy shtetet më të vogla federale, Hamburg dhe Bremen. Është argumentuar se nevojat e popullatës në këto qytet-shtete mund të shërbehen gjithashtu duke krijuar Qendra të Këshillimit Juridik në vendet qendrore në të cilat avokatët japin këshilla juridike. Në të gjitha shtetet e tjera federale, ky model i ofrimit u konsiderua jopraktik për shkak të kostove të krijimit të një rrjeti të qendrave të këshillimit.¹⁸

Një qasje e ngjashme duket se përdoret edhe në Austri, Republikën Çeke, Poloni dhe Irlandë. Në **Austri**, pasi është dhënë nga gjykata, ndihma juridike organizohet në mënyrë rajonale nga Dhoma e Avokatëve të Austrisë. Nuk ka asnjë institucion zyrtar të ndihmës juridike. Në **Poloni**, ndihma juridike në procedurat penale jepet nga një gjykatë dhe më pas një avokat caktohet nga gjykata nga një listë përfaqësuesish ligjorë/ avokatësh. Në mënyrë të ngjashme, në **Irlandë**, gjykatat, përmes gjyqësorit, janë përgjegjëse për dhënien e ndihmës juridike.

Në **Republikën Çeke**, është gjithashtu përgjegjësi e gjyqtarit përkatës (ose senatit gjyqësor) të vendosë nëse i akuzuari ka të drejtë të rimbursohet për shpenzimet e mbrojtjes. Ekzistojnë dy lloje të situatave - ose një këshilltar ligjor (avokat) zgjidhet nga i akuzuari drejtpërdrejt, ose i akuzuari kërkon nga gjykata që të caktojë një avokat nga lista e mbajtur nga Dhoma Çeke e Avokatisë. Në rastin e fundit, zgjedhja bëhet nga dhoma sipas listës së pritjes (*secila gjykatë ka listën e vet të pritjes*), por emërimi zyrtar bëhet më pas nga gjykata. Rimbursimi i shpenzimeve është i mundur në të dy situatat.

Në **Francë**, sistemi i ndihmës juridike është i decentralizuar dhe i organizuar përmes gjykatave. Në nivel lokal, komitetet e ndihmës juridike (*les bureaux d' aide juridictionnelle*) brenda 164 gjykatave civile të shkallës së parë (*Tribunaux judiciaires*) përcaktojnë të drejtën për ndihmë juridike. Ato përfshijnë një gjyqtar, një anëtar nga publiku, një anëtar të dhomës lokale të avokatisë dhe përfaqësues shtesë të tjerë. Pasi një person i kualifikuar miratohet për ndihmë juridike, presidenti i shoqatës lokale të avokatëve emëron një avokat. Dikush mund të kërkojë gjithashtu një avokat specifik dhe Dhoma e avokatisë do të përpiqet të sigurojë avokatin në varësi të disponueshmërisë. Në praktikë, para emërimit të një avokati, dhomat e avokatëve marrin në konsideratë edhe formimin e tij profesional. Për shembull, vetëm avokatët me përvojë në të drejtën penale duhet të caktohen si mbrojtës për një individ të akuzuar. Në mënyrë të ngjashme, avokatët me përvojë në punën me fëmijët duhet të caktohen në çështjet e fëmijëve.

Këshilli Kombëtar i Ndhmës Juridike (*Conseil National de l'Aide Juridique*) është një organ këshillues që është kryesisht përgjegjës për mbledhjen e të gjithë informacionit sasior dhe cilësor mbi funksionimin e ndihmës juridike, duke u propozuar autoriteteve publike të gjitha masat që mund ta përmirësojnë atë dhe hartimin e një raporti vjetor mbi veprimtarinë e ndihmës juridike. Ai drejtohet nga një këshilltar i Këshillit të Shtetit ose i Gjykatës së Kasacionit dhe të paktën gjysma e anëtarëve të tij duhet të jenë përfaqësues të profesioneve gjyqësore dhe

¹⁸Matthias Kilian "Ndihma Juridike në Gjermani" , f. 8.

juridike. Megjithatë, funksione të tilla mbulojnë vetëm një pjesë të funksioneve të institucioneve të ndihmës juridike të diskutuara në seksionin e mëparshëm.

Institucionet që punojnë veçanërisht me ndihmën juridike për fëmijët

Vetëm disa nga autoritetet pjesëmarrëse në këtë kërkim kishin institucione që punojnë posaçërisht me ndihmë juridike për fëmijët. Në shumicën e vendeve, sistemi i përgjithshëm është përdorur për të siguruar të drejtën e fëmijëve për ndihmë juridike.

Belgjika është një nga vendet që në një farë mase reflekton specifikat e ndihmës juridike për fëmijët në një perspektivë institucionale. Në komunitetin frëngjishtfolës, Shërbimet për të Drejtat e të Rinjve (*Services Droit des Jeunes*) janë shoqata të specializuara në ofrimin e ndihmës juridike të linjës së parë për fëmijët. Ata kryejnë dy lloje të veprimit:

- Veprimet brenda kuadrit të ndihmës individuale. Brenda kësaj kornize, Shërbimet për të Drejtat e të Miturve ofrojnë konsulta sociale-juridike dhe gjithashtu mund, me kërkesë të fëmijës, të ofrojnë mbështetje individuale afatgjatë;
- Veprimet me një dimension më kolektiv; këto synojnë të ofrojnë informacione shoqërore dhe juridike në një shkallë më të gjerë dhe mund të marrin formën e interpelancave, animacioneve, veprimeve kolektive, etj.

Lidhur me ndihmën juridike të linjës së parë të organizuar nga CAJs (dhe si rrjedhojë të siguruar nga avokatët), në disa rrethe juridike, oraret specifike kohore të dedikuara për ndihmën juridike të vijës së parë për fëmijët organizohen një herë ose disa herë në muaj. Disa nga këto shërbime organizohen edhe në qendrat e paraburgimit për të rinjtë.

Për sa i përket ndihmës juridike të linjës së dytë, avokatët e emëruar për fëmijët nga zyrat e ndihmës juridike duhet të jenë avokatë të specializuar, të cilët janë të regjistruar në listën e avokatëve të të rinjve të Dhomës së tyre të Avokatëve.

Në **Francë**, brenda kuadrit të ndihmës juridike të linjës së parë, e cila vlen për konsultimin dhe ndihmën juridike gjatë procedurave jo-gjyqësore (*l' aide à l' accès au droit*), ekzistojnë iniciativa lokale në lidhje me fëmijët. Për shembull, *l' Antenne des Mineurs* (Dega për fëmijë) e Dhomës së Avokatisë së Parisit, krijuar më 1991, mbulon shqetësimet e të rinjve, nëse ata janë viktimë apo të akuzuar, ose kur ka një konflikt prindëror dhe fëmija dëshiron të dëgjohet nga një gjykatës. Avokatët gjithashtu ndihmojnë të rinjtë që janë subjekt i një mase edukuese. Konsultime të tilla falas ofrohen nga avokatë të specializuar në çështjet juridike që lidhen me fëmijët. Sidoqoftë, më shpesh i njëjti sistem i ndihmës juridike përdoret për fëmijë dhe të rritur.

Në **Lituani**, nuk ka asnjë institucion që mbulon ekskluzivisht ndihmën juridike për fëmijët dhe nuk ka asnjë departament (sektor) brenda institucionit kryesor të ndihmës juridike që është i specializuar në ndihmën juridike për fëmijët. Sidoqoftë, sektori territorial i Shërbimit të Ndihmës

Juridike të garantuar nga Shteti në Kaunas ka një specialist i cili punon veçanërisht me ndihmën juridike në rastet ndërkufitare të kujdesit për fëmijët dhe rrëmbimit të fëmijëve (Konventa e Hagës 1980). Nuk ka asnjë specialist që punon plotësisht me ndihmën juridike për fëmijët në konflikt me ligjin.

Në mënyrë të ngjashme, nuk ka një sistem të veçantë të ndihmës juridike për fëmijët të parashikuar nga ligji në **Shqipëri**. Sidoqoftë, duke krijuar detyrimin e Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë për të siguruar specializim dhe trajnim¹⁹, ligji krijon hapësira për të patur avokatë të specializuar për fëmijët në konflikt me ligjin dhe fëmijët viktime të krimeve.

Financimi i Ndhmësi Juridike

Në të gjitha vendet evropiane pjesëmarrëse në projekt, ndihma juridike financohet nga buxheti i shtetit. Në shtetet federale, kjo zakonisht mbulohet nga buxheti federal.

Për shembull, ndihma juridike e linjës së dytë në **Belgjikë** financohet nga buxheti i Shtetit Federal. Çdo vit, departamenti federal i drejtësisë paguan një ndihmë juridike të linjës së dytë për Dhomat e Avokatisë frëngjisht-folëse dhe gjerman-folëse në Belgjikë dhe Dhomës së Avokatisë së Flamandës, të cilat nga ana tjetër shpërndajnë ndihmën²⁰. Kjo përfshin një ndihmë për avokatët, si dhe kostot që lidhen me organizimin e zyrave të ndihmës juridike. Në vitin 2017, u krijua një fond buxhetor për ndihmën juridike të linjës së dytë që synon të financojë ndihmën juridike të linjës së dytë dhe mbështetet nga kontributet e palëve ndërgjyqëse.

Ndihma juridike financohet gjithashtu nga buxheti i shtetit në vendet që zgjedhën një sistem të ndihmës juridike të administruar nga gjykata. Për shembull, në **Austri**, kryesisht, Shteti Federal i Austrisë mbulon koston e ndihmës juridike. Shteti Federal i Austrisë i paguan Dhomës së Avokatisë së Austrisë një shpërblim të përshtatshëm me tarifë të sheshtë për shërbimet e ndihmës juridike të ofruara nga avokatët.

Dallimet midis tarifave të paguara për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët krahasuar me ndihmën juridike për të rriturit

Lidhur me tarifën e paguara nga shteti për avokatët e ndihmës juridike për shërbimet e tyre, gjatë kohës së kryerjes së këtij kërkimi, në Lituani, Belgjikë, Austri, Finlandë, Francë, Gjermani, Hungari, Irlandë, Itali dhe Spanjë nuk kishte dallime midis tarifave të ofruara për ndihmën juridike për fëmijët krahasuar me ndihmën juridike për të rriturit.

Të njëjtat tarifa zbatohen gjithashtu kur avokati thirret për të siguruar ndihmë juridike në gjykatat e specializuara të të rinjve. Për shembull, në Francë, si pjesë e ndihmës juridike, avokatët

¹⁹(Shqipëri) Neni 9 (d) – Ligji Nr. 111/2017 për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti.

²⁰ (Belgjikë) Kodi Gjyqësor, Neni 508/19 i 508/19.

marrin të njëjtat tarifa për ndihmën e një të akuzuari përpara Gjykatës Penale, Gjykatës së Fëmijëve ose Gjykatës për të Mitur në procedurat penale.

2.4 Statistikat

Statistikat e mbledhura nga vendet pjesëmarrëse në sondazh janë paraqitur në Tabelën Nr. 1.²¹ Gjatë kërkimit, statistikat për vitin 2019 janë mbledhur (përveç Finlandës dhe Spanjës, statistikat e të cilave janë për vitin 2018 dhe Irlanda, statistikat e të cilës janë për vitin 2017).

Siç mund të shihet në tabelë, për shumë vende, shumica e statistikave për ndihmën juridike për fëmijët nuk ishin në dispozicion. Në disa vende, ekipet kërkimore hasën vështirësi në aksesimin e të dhënave dhe në të tjera statistikat nuk u konsideruan mjaft të sakta për të përmbushur kërkesat e këtij kërkimi. Mungesa e statistikave e bën të vështirë sigurimin e të dhënave përmbledhëse dhe përfaqësuese mbi situatën e ndihmës juridike për fëmijët në vende të ndryshme. Sidoqoftë, meqenëse të dhënat statistikore janë një instrument i rëndësishëm për të patur një pasqyrë të përgjithshme mbi ndihmën juridike për fëmijët në një periudhë të caktuar kohe, të dhënat e vlefshme të marra janë përfshirë në këtë raport.

Statistikat janë gjithashtu të vështira për tu përmbledhur për shkak të përkufizimeve dhe praktikave të ndryshme. Për shembull, në disa vende, ofruesit e ndihmës juridike mund të jenë vetëm avokatë në listën e ofruesve të ndihmës juridike. Në vendet e tjera, lista të tilla nuk ekzistojnë, kështu që të gjithë avokatët praktikantë janë zyrtarisht ofrues të ndihmës juridike. Edhe disa statistika të mbledhura janë paraqitur në Tabelën 1.

Shumica e të dhënave kanë të bëjnë me numrin e përgjithshëm të përfituesve dhe ofruesve të ndihmës juridike. Siç mund të shihet, numri i përfituesve dhe ofruesve të ndihmës juridike ndryshon, por ato gjithashtu varen nga numri i popullsisë në shtete të veçanta. Shumë pak statistika janë në dispozicion për ndihmën juridike për fëmijët. Pyetësorët nga vetëm 4 vende ofruan numra për përfituesit e ndihmës juridike për fëmijë (Shqipëri, Lituani, Francë dhe Spanjë). Sidoqoftë, ne gjithashtu mund të shohim ndryshime të konsiderueshme midis këtyre vendeve. Në Francë dhe Shqipëri, përkatësisht 20% dhe 16% e të gjithë përfituesve të ndihmës juridike ishin fëmijë, ndërsa në Lituani dhe Francë numrat janë shumë më të ulët respektivisht 6% dhe 2%. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se këto shifra duhet të trajtohen me kujdes, pasi metodat e mbledhjes së të dhënave, përkufizimet e përfituesve të ndihmës juridike, etj mund të ndryshojnë.

²¹ Vetëm ato vende për të cilat janë siguruar statistika gjatë studimit janë përfshirë në tabelë.

Tabela nr. 1. Statistikat e vendeve për ndihmën juridike

	Shqipëria	Austria	Republika Çeke	Finlanda	Franca	Hungaria	Irlanda	Italia	Lituania	Spanja	Suedia
Përfituesit e ndihmës juridike	3460	Jo e apliku eshme	Jo e aplik uesh me	50 000**	990 436	Jo e apliku eshme	64 181***	Jo e apliku eshme	49694	686340	6 845
Përfituesit e ndihmës juridike në çështjet penale		Jo e apliku eshme	Jo e aplik uesh me	Jo e apliku eshme	396 822	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	171314	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	684**
Përfituesit e ndihmës juridike për fëmijë	553	Jo e apliku eshme	Jo e aplik uesh me	Jo e apliku eshme	196472	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	2799	13862	Jo e apliku eshme
Fëmijë përfitues në çështjet penale		Jo e apliku eshme	Jo e aplik uesh me	Jo e apliku eshme	124,732	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme
Ofruesit e ndihmës juridike	110	20 556	Jo e aplik uesh me	220**	26 808	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	554*** *	46130	Jo e apliku eshme
Ofruesit e ndihmës juridike		14 420	Jo e aplik uesh me	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	1778	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme

në çështjet penale											
Ofruesit e ndihmës juridike që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët		Jo e apliku eshme	Jo e aplik uesh me	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme
Ankesat (në përgjithësi)		Jo e apliku eshme	Jo e aplik uesh me	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	395	5733	Jo e apliku eshme
Ankesat ku përfituesi është fëmija		Jo e apliku eshme	Jo e aplik uesh me	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme	Jo e apliku eshme

* Të dhënat për vitin 2018

** Numra të përafërt.

*** Të dhëna për vitin 2017

**** 53 avokatë punonin rregullisht për të siguruar ndihmë juridike dytësore, 501 avokatë punuan nën kontrata me shërbimin e garantuar juridik të shtetit lituanëz, duke siguruar ndihmë juridike dytësore kur ishte e nevojshme.

NDIHMJA JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE NË EVROPË

3.1 Aktet kryesore juridike që rregullojnë të drejtën për ndihmë juridike në çështjet penale

Në përputhje me Parimin 1 (E drejta për ndihmë juridike) të Parimeve dhe Udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara 2012 mbi aksesin në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale, shtetet duhet të garantojnë të drejtën për ndihmë juridike në sistemet e tyre juridike në nivelin më të lartë të mundshëm, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, në kushtetutë. Ky parim zbatohet në të gjitha juridiksionet evropiane të analizuara.

Në shumë vende evropiane, e drejta për ndihmë juridike përcaktohet në dokumentet e nivelit kushtetues dhe më pas përpunohet në kodet e procedurave civile dhe penale ose kodet gjyqësore. Shpesh, shtetet gjithashtu kanë një ligj të veçantë plotësisht dedikuar ndihmës juridike dhe disa akte të nivelit më të ulët (ministror) që rregullojnë aspekte të veçanta të sigurimit të ndihmës juridike.

Lituania është një nga shembujt tipikë. Kushtetuta e Republikës së Lituanisë përcakton që çdo person i dyshuar ose i akuzuar për kryerjen e një krimi do të garantohet, që nga momenti i arrestimit ose marrjes në pyetje për herë të parë, të drejtën për një mbrojtje dhe të drejtën për një avokat.²² E drejta për ndihmë juridike rregullohet në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Lituanisë, Ligjin mbi Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti të Republikës së Lituanisë (ligji i dedikuar tërësisht për ndihmën juridike), si dhe në ligje të tjera, ashtu edhe në akte qeveritare dhe ministrore.

Situata të ngjashme ekzistojnë në disa vende të tjera. Për shembull, korniza juridike **italiane** që rregullon sistemin e ndihmës juridike kryesisht përbëhet nga dispozitat e mëposhtme: Neni 24 i Kushtetutës Italiane; disa nene në Kodin e Procedurës Penale Italiane; dhe dekretet përkatëse të Presidentit (në veçanti, Dekreti i Presidentit nr. 115/2002 dhe Dekreti i Presidentit nr. 448/1988). Në **Gjermani** gjithashtu, disa ligje rregullojnë ndihmën juridike, përkatësisht, Kodi Gjerman i Procedurës Penale, Akti i Gjykatave Rinore Gjermane, Akti i Ndhimës Këshilluese dhe Akti i Shërbimit Juridik.

Ndihma juridike në aktet kushtetuese

²² (Lituanian) Neni 31(6) i Kushtetutës së Republikës së Lituanisë. I disponueshëm në: <https://www.lrkt.lt/en/about-the-court/legal-information/the-constitution/192>

Në shumë vende, e drejta për ndihmë juridike garantohet në nivelin kushtetues. Për shembull, neni 23 i Kushtetutës belge shpall:

Neni 23

*Të gjithë kanë të drejtë të bëjnë një jetë në përputhje me dinjitetin njerëzor. Për këtë qëllim, ligjet, ligjet federale dhe rregullat e përmendura në nenin 134 garantojnë të drejtat ekonomike, sociale e kulturore, duke marrë parasysh detyrimet përkatëse dhe përcaktojnë kushtet për ushtrimin e tyre. Këto të drejta përfshijnë ndër të tjera: (...) të drejtën për sigurime shoqërore, për kujdes shëndetësor dhe për **ndihmë sociale**, mjekësore dhe **juridike**.*

Mbrojtja efektive gjyqësore dhe ndihma juridike janë ndër të drejtat e mbrojtura nga Kushtetuta **Spanjolle** dhe për këtë arsye konsiderohen të drejta kushtetuese. Neni 24 i Kushtetutës Spanjolle parashikon që, ndër të tjera, të gjithë individët kanë të drejtë për mbrojtje efektive nga gjyqtarët dhe për mbrojtjen dhe ndihmën e avokatit:

"Neni 24.

- 1. Të gjithë individët kanë të drejtë të marrin mbrojtje efektive nga gjykatësit dhe gjykatat gjatë ushtrimit të të drejtave dhe interesave të tyre legjitime, pa ndonjë mundësi të mosmbrojtjes.*
- 2. Për më tepër, të gjithë kanë të drejtë për një gjyqtar të zakonshëm të paracaktuar me ligj, të drejtën për një mbrojtje dhe ndihmën e avokatit, të drejtën për t'u informuar për akuzat kundër tyre, të drejtën për një gjykim publik pa vonesa të panevojshme dhe me garanci të plota, të drejtën për të përdorur provat në lidhje me mbrojtjen e tyre, të drejtën për të mos dëshmuar kundër vetvetes, të drejtën për të mos rrëfyer fajin dhe të drejtën për tu konsideruar të pafajshëm.*

Ligji duhet të rregullojë rastet në të cilat, për arsye të lidhjeve familjare ose sekretit profesional, nuk ka asnjë detyrim për të dëshmuar në lidhje me vepra penale të pretenduara."

Po kështu, neni 119 i Kushtetutës Spanjolle përcakton se drejtësia do të jetë e lirë kur ligji parashikon kështu dhe, në çdo rast, për ata që provojnë burime të pamjaftueshme për çështje gjyqësore.

Ligji Themelor i **Hungarisë** në nenin XXVIII paragrafi (3) parashikon që "*Kushdo që akuzohet në procedurë penale do të ketë të drejtë për mbrojtje në të gjitha fazat e procedurave të tilla.*"

Vendosja e së drejtës për ndihmë juridike në nivelin kushtetues i jep vizibilitet kësaj të drejte dhe nënvizon rëndësinë e saj.

E drejta për ndihmë juridike në Kodet e Procedurës Penale dhe Kodet Gjyqësore

Në shumicën e vendeve evropiane pjesëmarrëse në Projekt, e drejta për ndihmë juridike dhe aspektet specifike të saj paraqitet në kodet e procedurës penale dhe instrumente të ngjajshëm. Vetëm dy shembuj do të përmenden këtu, pasi rregullat në kod janë shpesh të ngjajshme në vende të ndryshme.

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së **Lituanisë** përcakton parimet kryesore të ndihmës juridike në çështjet penale. Ai garanton që secili i dyshuar ose i akuzuar për një vepër penale do të ketë të drejtën të mbrojtë vetveten personalisht ose përmes një avokati. Një person pa mjete të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e avokatit ka të drejtë të marrë ndihmë juridike falas në përputhje me ligjin që rregullon procedurat e ndihmës juridike të garantuar nga shteti (Neni 44).

Kodi përcakton të drejtat dhe detyrat e avokatit (neni 48). Ai parashikon që të dyshuarit të ndaluar do t'i jepet mundësia të takohet me një avokat nga koha e arrestimit ose para marrjes në pyetje për herë të parë (neni 50). Kodi rendit rastet kur kërkohet përfshirja e detyrueshme e një avokati (neni 51). Ai gjithashtu detyron autoritetet e përfshira për të siguruar që avokati është i pranishëm në rastet kur parashikohet pjesëmarrja e detyrueshme e avokatit ose të informojnë për mundësinë e ndihmës juridike falas në rastet kur situata nuk kërkon pjesëmarrjen e detyrueshme të një avokati (neni 50).

Në **Poloni**, çështje të rëndësishme në lidhje me ndihmën juridike mbulohej gjithashtu nga Kodi i Procedurës Penale. Sipas nenit 78 (1) të Kodit të Procedurës Penale, personat e akuzuar që nuk kanë mbrojtës të zgjedhur prej tyre, mund të kërkojnë që tu caktohet një avokat mbrojtës publik, me kusht që të akuzuarit të provojnë siç duhet se nuk janë në gjendje të përballojnë shpenzimet e mbrojtjes pa ndikuar në aftësinë e tyre për të mbajtur veten dhe familjen e tyre. Kodi i Procedurës Penale rregullon kur përfaqësimi ligjor i të akuzuarit është i detyrueshëm. Për më tepër, Kodi parashikon që një person i akuzuar pa zotërimin e mjaftueshëm të Polonishtes ka të drejtën e ndihmës falas nga një përkthyes.

Aktet ligjore që adresojnë në mënyrë specifike ndihmën juridike

Shumë prej vendeve pjesëmarrëse në këtë kërkim kanë miratuar një ligj të veçantë për rregullimin e ndihmës juridike. Këto ligje organizojnë/përcaktojnë normat e përshtatshme dhe vendosin rregullat kryesore për administrimin dhe ofrimin e ndihmës juridike.

Ligji mbi Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti i Republikës së **Lituanisë**²³ i dedikohet specifikisht ndihmës juridike. Ai përcakton parimet e ndihmës juridike dhe detyrimet e

²³ Një version më i hershëm i ligjit (pa modifikimet më të fundit) gjendet në <https://vgtp.lrv.lt/en/legal-information/legislation>

zbatuesve të tij, rregullon menaxhimin e ndihmës juridike (institucionet dhe detyrimet e tyre), specifikon kushtet për ofrimin e ndihmës juridike (personat që kualifikohen, dokumentat e duhura, shpenzimet e mbuluara), dhe ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Lidhur me ndihmën juridike dytësore, ligji përcakton procedurat për përzgjedhjen e një avokati dhe tarifata e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike, procedurat për ofrimin e ndihmës juridike, veçantitë e ofrimit të ndihmës juridike në çështjet penale dhe përcakton kushtet për ndihmë juridike në çështje që lidhen me elementë ndërshtetërore.

Në **Shqipëri**, një ligj specifik i ngjashëm është Ligji Nr. 111/2017. Ai ka për qëllim të krijojë një sistem për organizimin dhe dhënies së ndihmës juridike pa pagesë në një mënyrë të barabartë dhe efektive për të gjithë individët në nevojë, duke u mundësuar atyre akses në drejtësi përmes sigurimit të organizimit, administrimit dhe funksionimit të duhur të institucioneve shtetërore të përfshira, po ashtu edhe duke siguruar shërbime të ndihmës juridike që janë profesionale, cilësore, produktive dhe të suksesshme.

Në **Spanjë**, ligji kryesor për rregullimin e ndihmës juridike është Akti i Ndhmës Juridike, por Dekreti Mbretëror 996/2003 i datës 25 korrik 2003 miraton gjithashtu rregullimin e ndihmës juridike falas. I pari përcakton përmbajtjen e këtij ligji, kufinj të e përdorimit të tij, procedurat që duhen ndjekur për njohjen dhe aplikimin e tij, si dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tij, ndërkohë që i dyti zhvillon më tej disa nga konceptet e përmendura në Aktin e Ndhmës Juridike.

Në Hungari, Akti LXXX i vitit 2003 mbi Ndhmën Juridike siguron aksesin në drejtësi për individët në disavantazh social në mënyrë që ata të kenë mundësinë për të marrë këshillim ligjor profesional dhe për tu përfaqësuar në gjyq përgjatë ecures së zbatimit të të drejtave të tyre dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ligjore.

Rezolutat Qeveritare dhe Aktet Ministrore

Në shumë shtete, e drejta për ndihmë juridike dhe zbatimi i saj në praktikë është zhvilluar përmes përshtatjes së akteve të ndryshme të qeverive dhe ministrive ose nga vendimet e organeve specifike.

Në **Lituani** ekzistojnë disa rezoluta qeveritare që rregullojnë ofrimin e ndihmës juridike, për shembull, për caktimin e rregullit sipas të cilit pagesa e avokatëve të ndihmës juridike përlllogarit dhe paguhet; ose për caktimin e nivelit të të ardhurave dhe asetëve për të vlerësuar kualifikimin për ndihmë juridike garantuar nga shteti. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë ka miratuar një numër urdhërash në fushën e ndihmës juridike. Për shembull, këto urdhra përcaktojnë rregullat për tu bërë avokat i ndihmës juridike, janë krijuar disa formate të gatshme të kontratave me avokatët e ndihmës juridike dhe format e zbatimit të ndihmës juridike, janë organizuar procedurat e rekomandueshme për zgjedhjen e një avokati që ofron ndihmë juridike dytësore në rastet kur përfaqësimi i detyrueshëm nga një avokat është parashikuar, etj.

Në **Shqipëri**, ka disa akte ligjore të miratuara në nivel ministror mbi rregullat dhe procedurat e pagesave të shpenzimeve gjyqësore (Udhëzuesi Nr.6, datë 20.08.2019), mbi miratimin e udhëzuesve për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyruar dhe përcaktimin e avokatit bazuar në parimin e rotacionit, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset penale (Vendimi Nr.231, datë 12.11.2019 mbi Këshillin e Lartë të Prokurorisë), mbi miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e monitorimit nga Drejtoria e Shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas (Urdhri Nr.531, datë 25.11.2019).

Në **Hungari**, Dekreti Qeveritar 421/2017. (XII. 19.) mbi miratimin, ofrimin dhe shpërbimin e shërbimeve të mundësuar nën kuadrin e ndihmës juridike, parashikon rregullat e detajuara për zbatimin e shërbimeve të Aktit të Ndihmës Juridike.

3.2 Rregulloret specifike për ofrimin e ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin

Parimet dhe Udhëzimet e KB 2012

Parimi 11. Ndihmë juridike në interesin më të lartë të fëmijës

58. Shtetet duhet të marrim masat e duhura për të organizuar sisteme të ndihmës juridike që janë miqësore dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve, duke marrë parasysh aftësitë zhvillimore të tyre dhe nevojën për të gjetur balancën e duhur mes interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës së fëmijës për tu dëgjuar në procedurat gjyqësore duke përfshirë:

(b) *Miratimin e legjislacionit, politikave dhe rregulloreve të ndihmës juridike që qartazi marrin në konsideratë të drejtat dhe nevojat zhvillimore të veçanta të fëmijës, duke përfshirë të drejtën për të patur ndihmesë juridike ose mbështetje të tjera të nevojshme në përgatitjen dhe prezantimin e mbrojtjes së tij/saj; të drejtën për tu dëgjuar në të gjitha procedurat gjyqësore që e prekin atë; procedurat standarte për të përcaktuar interesin më të lartë; privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale; si dhe të drejtën për tu konsideruar për shmangie.*

Ndihma juridike për fëmijët në konflikt me ligjin zakonisht kërkon vëmendje të veçantë në ligjet kombëtare mbi procedimet penale dhe instrumentat që lidhen me to. Për shembull, shpesh, për shkak të vulnerabilitetit të fëmijëve në konflikt me ligjin, shtetet vendosin mbrojtje të detyruar për fëmijët dhe nuk përdorin vlerësimin e burimeve financiare.

Disa nga juridiksionet e marra në analizë kanë një ligj special mbi drejtësinë për fëmijët, shumë të tjera përfshijnë në ligjin e përgjithshëm parashikime në lidhje me fëmijët në konflikt me ligjin. Sidoqoftë, në asnjë prej shteteve të vlerësuar nuk u gjend një ligj ose një instrument specifik që rregullon ndihmën juridike specifike për fëmijët.

Instrumente të krijuara specifikisht për drejtësinë për fëmijë

Disa prej shteteve europiane që u analizuan kanë miratuar ligje mbi drejtësinë për fëmijë.

Në **Republikën Çeke**, Akti mbi Drejtësinë për të Mitur zbaton Direktivën 2016/800 dhe rregullon përgjegjësinë penale të fëmijës, masat e detyrueshme si pasojë e veprës penale si dhe procedurat dhe vendimmarrjen në çështjet përkatëse. Akti mbi Drejtësinë për të Mitur mund të konsiderohet si një rregullim gjithpërfshirës i ndihmës juridike për fëmijë, si gjatë ashtu edhe pas procedimeve penale.

Në mënyrë të ngjashme, Akti i Gjykatës së të Rinjve në **Gjermani** (*Jugendgerichtsgesetz*) rregullon pjesën më të madhe të ligjit penal zyrtar për fëmijët në Gjermani. Ai zbatohet në të gjitha procedimet penale ndaj fëmijëve dhe mund të përdoret nga gjykatat ndaj personave deri 21 vjeç, në varësi të pjekurisë mendore të të riut. Në lidhje me ndihmën juridike në procedimet penale, ky akt rregullon rastet e mbrojtjes së detyruar.

Në **Poloni**, Akti i Procedimeve të Çështjeve për të Mitur rregullon procedimet në çështje të veprave të ndëshkueshme në lidhje me fëmijët. Ai mundëson garanci procedurale për fëmijë nën akuzë. Ndër të tjera, akti parashikon se fëmija ka të drejtën për mbrojtje, duke përfshirë të drejtën për shërbimin e një avokati dhe të drejtën për të refuzuar për t'iu përgjigjur pyetjeve individuale. Ai/ajo duhet të informohet në lidhje me këto të drejta përpara seancës dëgjimore.

Në **Suedi** ekziston një ligj me rregullore speciale në lidhje me fëmijët dhe të rinjtë (deri në moshën 21 vjeçare) në konflikt me ligjin. Ai quhet *Ligji me Përmbajtje Kushtesh të Veçanta lidhur me Shkelës të Mitur*. Ky ligj parashikon se një avokat publik duhet të caktohet për një të dyshuar, i cili nuk e ka arritur moshën 18 vjeçare, përveç rasteve kur është e dukshme se ai/ajo nuk ka nevojë për një të tillë. Ligji thekson, si parim kyç të tijin, që një avokat i shtetit t' i mundësohet fëmijës që në fazat e hershme kur dyshohet për kryerjen e një krimi. Një avokat publik paguhet nga shteti dhe shërbimet e tij/saj janë rrjedhimisht pjesë e sistemit të ndihmës juridike. Vetëm në rastet kur është e qartë që fëmija nuk ka nevojë për një avokat publik, atëherë ai/ajo nuk i caktohet fëmijës. Në këtë rast, fëmija mund të aplikojë për ndihmë juridike bazuar në ligjin e përgjithshëm, Akti i Ndihmës Juridike.

Në **Shqipëri**, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur është miratuar në 2017. Ky instrument ka si qëllim të përshtasë sistemin e drejtësisë penale me nevojat e fëmijës. Ai mbulon aksesin për drejtësi dhe mjetet juridike, si dhe mbrojtjen, edukimin dhe rehabilitimin e fëmijëve në kontakt me ligjin. Ndihma ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin nuk është e kushtëzuar nga statusi ekonomik e financiar, pra mbrojtja e detyrueshme është e përcaktuar. Të gjitha shërbimet e përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë apo dëshmitarë, duke përfshirë shërbimet ligjore, ndihmën psikologjike dhe tarifat e shërbimit të përkthyesit janë të garantuara dhe të paguara plotësisht nga shteti. Kodi njih gjithashtu të drejtën e përfaqësuesit ligjor (prind/kujdestar ligjor) të fëmijës në konflikt me ligjin

për të zgjedhur dhe caktuar një avokat të pavarur duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

Instrumentet e përgjithshme që adresojnë ndihmën juridike në parashikimet e tyre

Në disa nga vendet pjesëmarrëse, ndihma juridike për fëmijët rregullohet nga i njëjti instrument i ndihmës juridike për të rriturit. Sidoqoftë, shpesh në këto instrumente ekzistojnë kushte që adresojnë veçantitë e ndihmës juridike për fëmijë.

Në **Lituani** nuk ka ligje apo politika që i drejtohen specifikisht ndihmës juridike për fëmijë. Megjithatë, instrumentet e përgjithshme i referohen deri në njëfarë mase ndihmës juridike për fëmijë.

Kodi i Procedurës Penale siguron përfshirjen e detyrueshme të një avokati në analizimin e çështjeve ku i dyshuari apo akuzuari është fëmijë. Refuzimi nga avokati është i kufizuar për fëmijët: oficeri hetues para-gjyqësor, prokurori dhe gjykata nuk janë të detyruar të pranojnë dorëheqjen e avokatit nga fëmija. Nëse personi i dyshuar, akuzuar, dënuar ose viktimë është fëmijë, përfaqësuesi i tij/saj ligjor mund të marrë pjesë në procedime dhe të mbrojë interesat e fëmijës, përjashtuar rastet kur kjo gjë mund të mos jetë në interesin më të lartë të fëmijës. Kodi liston gjithashtu të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor të fëmijës. Ligji mbi Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti i Republikës së Lituanisë iu mundëson fëmijëve në konflikt me ligjin për të marrë ndihmë juridike dytësore pavarësisht të ardhurave.

Në **Belgjikë**, disa dokumente i referohen specifikisht ndihmës juridike për fëmijë. Dekreti Mbretëror i cili përcakton kushtet për aksesin e plotë ose të pjesshëm të ndihmës juridike dytësore dhe asistencën gjyqësore thekson se një fëmijë ka të drejtën e ndihmës së plotë juridike falas. Kodi i Etikës së Dhomës së Avokatisë frengjishtfolëse dhe gjermanishtfolëse të Belgjikës përmban referenca të ndihmës juridike për fëmijët në nenet që kanë të bëjnë me çështjet në vijim: roli dhe pozicioni i avokatit të të miturit, zgjedhja ose ndryshimi i avokatit dhe pavarësia e avokatit nga përfaqësuesit ligjorë, konfliktet e interesit dhe përfaqësimi i fëmijës po ashtu i përfaqësuesve të tij/saj ligjor, sekretit profesional. Ai përcakton gjithashtu rregullat në lidhje me avokatët në detyrë për seanca dëgjimore në polici. Për më tepër, Kodi i Etikës prek specifikisht organizimin e ndihmës ligjore për fëmijë duke iu referuar seksioneve për të rinj brenda dhomave të avokatisë, trajnimit dhe kriteret që një avokat të bëhet pjesë e seksionit për të rinj dhe përcakton se avokati i caktuar për fëmijën, me prioritet, duhet të jetë pjesë e seksionit për të rinj. Aspekte specifike të ndihmës juridike për fëmijë janë gjithashtu të cekura në Manualin e ndihmës juridike dytësore.

Një situatë e ngjashme mund të shikohet dhe në Francë ku nuk ekzistojnë instrumente të veçanta, por fëmijët trajtohen si një grup specifik që shpesh kërkon kushte më të favorshme. Ndhima juridike ndaj fëmijëve për shembull është e garantuar pa kritere që lidhen me vendbanimin apo burimet familjare.

3.3 Kriteret për marrjen e ndihmës juridike, burimet dhe meritat

E drejta për ndihmë juridike është një e drejtë kushtetuese dhe është rrjedhojë e veprimit të ligjit. Çdo shtet europian e ka detyrim ligjor të sigurojë ndihmë juridike dytësore për një individ i cili plotëson kushtet e paravendosura nga ligji vendas.

Në Lituani, të gjithë shtetasit vendas dhe ata të vendeve të tjera pjesë anëtare të BE, po ashtu edhe shtetas të tjerë me leje qëndrimi në Lituani dhe në shtete të BE-së sipas specifikimit të nenit 12 të Ligjit mbi Ndhmën juridike të Garantuar nga Shteti, janë përfitues të ndihmës juridike bazuar në mjetet dhe kriteret. Në disa raste mund të përdoret vetëm merita për tu përzgjedhur, ndërkohë që në të tjera është e nevojshme që të dyja të merren parasysh. Neni 12 liston personat ndaj të cilëve ndihma juridike dytësore ofrohet pa një vlerësim të situatës së tyre financiare, për shembull: fëmijë të dyshuar apo akuzuar, persona të cilët marrin përfitime sociale, persona që janë pjesë e institucioneve të kujdesit social, persona të diagnostikuar me një nivel të rëndë të invaliditetit etj. Në të gjitha rrethanat e tjera do të vlerësohen burimet. Në 2020, përfaqësimi falas iu garantua qytetarëve Lituanëzë të ardhurat e të cilëve nuk i kalonin 4710,32 euro (ose 392,53 euro në muaj). Nëse të ardhurat vjetore do të ishin nga 4710,32 euro në 7065,48 euro, atëherë personi do të duhej të mbulonte 50 % të shpenzimeve të ndihmës juridike.

Në disa nga vendet europiane pjesëmarrëse në studim (p.sh. Austria, Finlanda, Belgjika, Spanja) modeli i ndjekur është i ngjashëm, megjithëse përdorimi i vlerësimit të burimeve varion, pasi edhe standartet financiare janë të ndryshme. Lista e personave të kualifikuar në bazë të meritës është po ashtu e krahasueshme. Mundësia për ndihmë juridike nuk kushtëzohet nga shtetësia apo statusi i vendbanimit. Kjo do të thotë se ndihma juridike në përgjithësi i garantohet qytetarëve; shtetasve të huaj apo atyre pa shtetësi, të cilët banojnë përkohësisht në një vend të caktuar; persona banorë të përhershëm ose përkohëshëm të një vendi tjetër anëtar të BE; persona të kualifikuar për ndihmë juridike prej marrëveshjeve ndërkombëtare.

Sipas vlerësimit të burimeve, në vendet europiane pjesëmarrëse në studim, ndihma juridike mbulohej nga shteti ndaj personave të cilët kanë nevojë për ndihmë profesionale në çështje ligjore dhe që e kanë të pamundur të mbulojnë koston e procedimeve si pasojë e situatës së tyre ekonomike. Ligjet kombëtare përcaktojnë zakonisht rregulla specifike për vlerësimin e situatës ekonomike dhe pragun e tij.

Në **Belgjikë** për shembull, një person duhet të vërtetojë se të ardhurat mujore neto të tij/saj janë më pak se 1226 euro. Personat nën varësi apo që jetojnë në një shtëpi duhet të vërtetojnë se të ardhurat mujore neto të shtëpisë janë më pak se 1517 euro.

Në **Finlandë**, merren në konsideratë të ardhurat e aplikantit, shpenzimet dhe detyrimet për suportin e fëmijës të cilat përbëjnë burimet e tij/saj në muaj. (psh. fondet disponibël që ai/ajo

ka për një muaj). Kur analizohen burimet, një ulje prej 300 eurosh aplikohet për çdo fëmijë nën moshë që jeton në shtëpinë e aplikantit. Të ardhurat e bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ses apo një partneri/reje të regjistruar të aplikantit janë po ashtu të marra në konsideratë në përlogaritje, edhe pse kjo nuk aplikohet në rastet kur bashkëshortët janë palë kundërshtare apo janë ndarë përgjithmonë. Për një person beqar me burime deri në 600 euro, ndihma juridike ofrohet plotësisht falas. Për një person beqar me burime mbi 1300 euro, ndihma juridike nuk do të mund të ofrohet.

Në **Hungari**, shteti paguan ndihmën juridike në rast se të ardhurat mujore neto të personit nuk kalojnë shumën aktuale të pensionit që përfiton një i moshuar (28,500 forinta hungareze ose afërsisht 81 euro) dhe kur personi nuk ka asnjë pronë.

Në **Francë**, në vlerësimin e burimeve merret parasysh gjithashtu burimet e bashkëshortit/es së aplikuesit për ndihmë juridike dhe të personave që banojnë në shtëpinë e tij/saj, përveç rasteve kur procedimi është mes bashkëshortëve dhe banorit tjetër të shtëpisë. Kufinj të të ardhurave rishikohen çdo vit në përputhje me indeksin e çmimit të konsumatorit, përjashtuar duhanin. Për 2020, një person beqar pa fëmijë do duhej të kishte të ardhura mujore më pak se 1043 euro për ndihmë juridike të plotë dhe më pak se 1564 euro për ndihmë juridike të pjesshme.

Duhet përmendur që disa shtete vendosin rregulla për rikthimin e tarifave të ndihmës juridike nëse situata financiare e marrësit ndryshon ose nëse ky i fundit dënohet më vonë. Për shembull, në **Austri**, nëse brenda një periudhe 3 vjeçare nga përfundimi i çështjes situata financiare ndryshon në favor të aplikantit, atëherë ndihma juridike mund të duhet të rikthehet.

Për sa i përket kriterit të meritës (kur interesat e drejtësisë e kërkojnë kështu), në rastet kur përdoret, aksesin në ndihmë juridike lidhet me statusin dhe karakteristikat e personit që e kërkon ndihmën juridike ose të nivelit sa e rëndë është vepra penale. Nëse ligji liston personat të cilët e plotësojnë automatikisht kushtin e meritës për ndihmë juridike, fëmijët në konflikt në ligjin janë po ashtu shpesh pjesë e listës.

Në **Shqipëri** për shembull ligji iu mundëson ndihmë juridike grupeve të ndryshme që përbëjnë kategori të veçanta, që kualifikohen për ndihmë juridike bazuar në statusin e tyre si moshë apo kushte të tjera përfshirë këtu të qenit viktimë të krimeve, të paturit sëmundje mendore, invaliditet apo aftësi të kufizuara etj. Në **Belgjikë**, fëmijët përfitojnë ndihmë juridike falas në rast se paraqesin një dokument identiteti apo të një lloji tjetër që përcakton statusin e tyre; ata përfitojnë nga prezumimi i pakundërshtueshëm i varfërisë. Për më tepër, nëse një person në konflikt me ligjin arrin moshën 18 vjeçare, por ka qenë fëmijë në kohën e veprës, ai/ajo do të përfitojë nga ndihma juridike falas me të njëjtat kushte si çdo fëmijë tjetër.

Në **Gjermani**, rastet për mbrojtje të detyruar janë të listuara në Kodin Gjerman të Procedurës Kriminale (*Strafprozessordnung*). Kodi përcakton se prania e mbrojtësit është e detyrueshme

nëse për shembull, personi është akuzuar për një vepër të rëndë kriminale, kur përcaktohen masat e sigurisë, kur mbahet dëgjesa e parë në gjykatën e rrethit apo në atë të më të lartën rajonale, etj.

Në **Hungari**, Akti i Ndhmës Juridike i konsideron automatikisht disa persona si të varfër (p.sh. fëmijët, të pastrehët, refugjatët) dhe ata nuk kanë nevojë të vërtetojnë se situata e tyre financiare është poshtë kufirit të vendosur nga Akti i Ndhmës Juridike. Në mënyrë të ngjashme, në Poloni fëmijët janë zakonisht përfitues të ndihmës juridike, pasi mbrojtja e tyre nga një avokat në procedime kriminale është e detyrueshme.

3.4 Ndhimja juridike për fëmijët viktimë të krimit

Duke qënë se ndihma juridike për fëmijët në konflikt me ligjin do të analizohet në kapitujt pasardhës, në vijim do të mbulojmë tërthorazi të drejtën për ndihmë juridike për fëmijët që janë viktimë të krimeve.

Në përputhje me Direktivën për Viktimat e krimit, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që viktimat kanë akses në ndihmën juridike kur ata kanë statusin e palës në procedime penale. Kushtet apo rregullat procedurale sipas të cilave, viktimat përfitojnë aksesin në ndihmën juridike duhet të përcaktohen nga ligji vendas (Neni 13).²⁴ Në të gjitha juridiksionet e e marra në analizë, fëmijëve viktimë të krimeve iu garantohet ndihma juridike.

Në **Lituani**, viktimat e krimeve kanë të drejtën e ndihmës juridike, e cila në disa raste bëhet përfaqësim i detyrueshëm. Fëmijët përfaqësohen në mënyrë të detyrueshme nga një avokat dhe janë përfitues të ndihmës juridike dytësore, pavarësisht nga burimet apo të ardhurat e tyre nëse ata kanë qënë viktimë të veprave penale ndaj shëndetit njerëzor, lirive, lirive seksuale, sulmeve kriminale ndaj fëmijës dhe familjes apo moralit dhe gjithashtu në çështje të tjera penale ku një officer i policisë gjyqësore, prokuror (me një vendim të arsyetuar) apo gjykatë (me urdhër) ka pranuar se përfaqësimi ligjor është i detyrueshëm.

Në **Belgjikë**, fëmijët viktimë të krimit përfitojnë gjithashtu nga rregulli që lidhet me prezumimin e pakundërshtueshëm si shtresë në nevojë. Ky rregull u mundëson atyre ndihmë juridike dytësore plotësisht falas dhe asistencë juridike pasi nuk bën dallime bazuar në statusin e fëmijës në procedim.

²⁴ Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 përcakton standartet minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe zëvendëson Vendimin e Këshillit 2001/220/JHA. OJ L 315, 14.11.2012, fq. 57–73.

Në Gjykatën për të mitur, përfaqësimi i të gjithë fëmijëve është i detyrueshëm, pavarësisht nëse ata janë të akuzuar për një vepër penale apo janë fëmijë në rrezik. Për rrjedhojë, fëmijët që janë viktimë të krimit duhet të mbrohen nga një avokat.

Në **Shqipëri**, një fëmijë viktimë ka të drejtën të mbrohet përgjatë gjithë procesit nga një avokat i përzgjedhur nga lista respektive e hartuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Fëmijëve viktimë iu mundësohen gjithashtu shërbime të tjera pa pagesë si ndihma psiko-sociale, mbështetje shëndetësore dhe shërbime përkthimi.

Sidoqoftë, duhet përmendur se në disa raste ndiqet një model disi ndryshe dhe se ka variacione lidhur me rastet kur përfaqësimi i detyruar parashikohet. Në **Irlandë**, për shembull, viktimat nuk përfaqësohen në procedime ligjore dhe çështja dërgohet e ndiqet kryesisht nga Zyra e Prokurorisë së Shtetit më shpesh sesa nga viktimat. Në **Itali**, fëmijët viktimë të krimeve të caktuara (p.sh. viktimat të dhunës në familje ose prostitucioni i fëmijëve) përfitojnë akses në sistemin e ndihmës juridike edhe në rastet kur ata nuk i plotësojnë kushtet e të ardhurave.

Duke qenë se fëmijët viktimë të krimit janë të përfaqësuar nga Prokuroria, pjesëmarrja e një avokati nuk është e detyrueshme. Nëse viktimat vendos të kërkojnë dëmshpërblim për dëmet e pësuar si rezultat i veprës penale, atëherë do t' i vihet në dispozicion një avokat (por nuk është e detyrueshme).

KRITERET PËR OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE

Shtetet aplikojnë modele të ndryshme për ofrimin e ndihmës juridike. Ato mund të përfshijnë avokatët e shtetit, avokatë privatë, avokatë të kontraktuar, skemat pro bono, dhomat e avokatisë, paraligjorët e të tjerë.

Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve i KB ka adresuar të drejtat e fëmijëve gjatë procedimeve juridike për fëmijë në **Komentin e Përgjithshëm Nr.24**. Është interesante për tu përmendur se ky koment, nën Konventën e të Drejtave të Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara, nuk e limiton termin "*ndihmë e përshtatshme*" vetëm tek profesionistët ligjorë. Ndihma juridike mund të jepet gjithashtu nga punonjësit socialë, paraligjorët ose të tjerë, por ata "*duhet të kenë njohuri të mjaftueshme dhe të kuptojnë aspektet e ndryshme ligjore të procesit të drejtësisë për të mitur dhe duhet të jenë të trajnuar të punojnë me fëmijë në konflikt me ligjin*".

4.1 Profesionistët e autorizuar për të ofruar ndihmë juridike për fëmijët në konflikt me ligjin

Sipas këtij kërkimi, rezultoi se në çështje penale, ndihma juridike dytësore në vendet europiane mund të ofrohej vetëm nga avokatët (përveç rasteve kur ndiqet modeli i mbrojtësit publik). Në 14 vendet pjesëmarrëse, një avokat është një person i cili ka ndjekur edukimin e duhur ligjor, me një diplomë masteri në juridik nga një universitet i akredituar. Përmbushja me sukses e një periudhe internshipi të detyrueshme dhe marrja e provimit të shtetit se bashku me regjistrimin në Dhomën e Avokatisë janë po ashtu kritere për tu bërë avokat.

Në Europë, ndihma juridike mundësohet kryesisht përmes skemave të avokatëve privatë. Në disa nga shtetet e BE, ndihma juridike ofrohet nga avokatë të licensuar të cilët marrin pjesë në ofrimin e ndihmës juridike financuar nga shteti. Ky është rasti për shtete si Belgjika, Lituania, Holanda, Gjermania, Italia dhe Hungaria. Në varësi të rregulloreve kombëtare, avokatët mundësojnë ndihmë juridike rast pas rasti ose mund të kenë kontrata më të gjata lidhur me ofrimin e ndihmës juridike.

Në shtete ku ekziston një autoritet i cili administron ofrimin e ndihmës juridike, avokatët zakonisht i nënshkruajnë kontratat e ofrimit të ndihmës juridike me këtë institucion. Në raste të tjera, nëse janë gjykatat ato që e administrojnë ofrimin e ndihmës juridike, avokati do të vihet në dispozicion nga gjykata ose prokuroria (p.sh. Gjermania, Polonia).

Në disa vende, ndihma juridike ofrohet nga avokatë publikë. Në të tilla raste, këshillimi ligjor, ndihma dhe përfaqësimi juridik mundësohen nga avokatë të cilët janë punonjës që marrin rrogë mujore ose tarifë mujore fikse dhe që punojnë në zyra specialistësh, financuar drejtpërdrejt ose jo nga qeveria. Në raste të rralla, financimi mund të ofrohet edhe nga organizata të shoqërisë civile apo OJF.²⁵ Modeli i avokatit publik është shumë i përhapur në kontinentin Amerikan (p.sh. në Argjentinë dhe Brazil) dhe mund të gjendet në vende të tjera po ashtu (si p.sh. Libi, Israel), por deri në një farë mase edhe në Europë. Institucioni i avokatit publik është një institucion që i dedikohet ekskluzivisht plotësimit të nevojave ligjore të përfituesve të ndihmës juridike

²⁵ Manuali mbi Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve të Ndihmës Juridike në Proceset e Drejtësisë Penale. Udhëzime Praktike dhe Praktika Premtuese. (UNODC, 2019, f.18.)

nëpërmjet shërbimeve të avokatëve të punësuar apo avokatëve të tjerë të vënë në dispozicion dhe të monitoruar prej tyre. Institucionet e avokatit publik mund të organizohen në nivel kombëtar, rajonal apo qyteti dhe mund të ofrojnë ndihmë juridike në një sërë juridiksionesh.²⁶

Sistemi i ndihmës juridike **finlandeze** është i njohur ndërkombëtarisht si një model miks i ndihmës juridike. Në Finlandë, ekziston një model unik i dyfishtë i sistemit të ndihmës juridike ku ajo ofrohet si nga avokatë publikë dhe nga avokatë privatë. Në procedime gjyqësore, ndihma juridike ofrohet nga avokatë publikë dhe avokatë të tjerë të licensuar për të ndihmuar klientët në gjyq me shërbime juridike. Në çështje të tjera, ndihma juridike ofrohet vetëm nga avokatët publikë. Për rrjedhojë, të gjitha çështjet jo gjyqësore si për shembull këshillim juridik apo përgatitje dokumentesh nën juridiksionin e zyrave të ofrimit të ndihmës juridike nga shteti, do të mbulohen nga avokatë publikë të ndihmës juridike.

Avokatët publikë të ndihmës juridike punojnë në Zyrat Shtetërore të Ndhmës Juridike. Zyrat janë normalisht të vendosura në bashkitë e njëjta me gjykatat e rrethit (*23 vendndodhje me rreth 160 zyra dege*). Avokatët që punojnë në zyrat shtetërore të Ndhmës Juridike janë punonjës civilë të cilët mund të punojnë me shërbime që nga këshillimi juridik e deri tek procedimet gjyqësore. Shumica e avokatëve publikë të ndihmës juridike mbajnë titullin *varatuomari*, që do të thotë se ata kanë përmbushur trajnimin juridik në Gjykatën e Rrethit dhe kanë kualifikimet e duhura juridike.

Ndërkohë që avokatët përfaqësojnë aktorët kryesorë duke shërbyer si profesionistë juridikë, në disa shtete ne mund të gjejmë edhe aktorë të tjerë që ofrojnë ndihmë juridike siç sugjerohet në Komentin Nr.24. Për shembull në Gjermani, një këshillues ("Beistand") mund të vihet në dispozicion të fëmijës së akuzuar nëse fëmija ende nuk ka mbushur moshën 18 vjeç dhe nëse rrethanat nuk garantojnë ofrimin e avokatit mbrojtës. Zyrtarisht, çdokush - përfshirë një avokat por edhe një anëtar familjeje, mësues, punonjës social apo shok/shoqe - mund të jetë një këshillues. Më e rëndësishmja është se duhet që këshilluesi të ketë pëlqimin/besimin e fëmijës.²⁷ Gjatë gjyqit ose dëgjësës së parë, këshilluesi është i ngarkuar me të drejtat e avokatit mbrojtës, sidoqoftë, pozicioni i tij është më tepër ai mbështetës, komfortues dhe përkujdesës se sa ai i mbrojtësit juridik. Në fakt, këshilluesi ka të njëjtat të drejta të mbrojtjes si një avokat, por ai nuk mund ta përfaqësojë fëmijën, e në këtë mënyrë ai/ajo ndërhyt vetëm në rastet kur mbrojtja nuk është e detyrueshme.

Në **Suedi** gjithashtu, një person i cili nuk ka diplomë juridiku, mund të ngarkohet terorisht për të ofruar ndihmë juridike nëse ai/ajo rezulton i përshtatshëm për këtë mision nga gjykata. Kjo

²⁶ Manuali mbi Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve të Ndhmës Juridike në Proceset e Drejtësisë Penale. Udhëzime Praktike dhe Praktika Premtuese. UNODC, 2019, f.18.

²⁷ (Gjermania) BeckOK/*Noak*, komenti mbi JGG, seksioni 69 recitali 4; *Eisenberg/Kölbel*, komenti mbi JGG, seksioni 69 recitali 6.

nënkupton se kushti për të patur edukim ligjor nuk është i detyrueshëm por personi duhet të jetë i familjarizuar me fushën juridike apo të jetë praktikues i ligjit në ndonjë formë.

4.2 Detyrimet për ofruesit e ndihmës juridike

Ndihma juridike duhet të jetë e një standarti cilësie të përshtatshme. Për ta arritur këtë, avokatët e ndihmës juridike duhet të jenë të aftë profesionalisht dhe të kenë trajnimet e nevojshme dhe duhet tu kërkohet pjesëmarrja në programe të edukimit në vazhdim dhe të trajnimeve specializuese. Për më tepër, puna e tyre duhet të jetë subjekt monitorimi dhe vlerësimi, si dhe ankimmimet e ardhura ndaj tyre duhet të hetohen dhe gjykohen menjëherë.

Parimet dhe Udhëzimet mbi Aksesin për Ndihmë Juridike në Sistemin e Drejtësisë Penale nga Kombet e Bashkuara kërkon që shtetet duhet të vendosin mekanizma të cilat sigurojnë që të gjithë ofruesit e ndihmës juridike zotërojnë *edukimin, trajnimin, aftësitë dhe përvojën* në përputhje me natyrën e punës së tyre, të drejtat dhe nevojat e grave, fëmijëve dhe grupeve me nevoja të veçanta.

Në **Deklaratën e Tbilisit të 2018**, ekspertët e ndihmës juridike theksojnë nevojën për të mbështetur zhvillimin e sistemeve të ndihmës juridike miqësore për fëmijët për të siguruar kështu ndihmë juridike të një cilësie të lartë ndaj fëmijëve. Deklarata kërkon gjithashtu të vendosen sisteme efektive për dhënien e ndihmës juridike dhe të sigurohemi që ofruesit e ndihmës juridike kanë kualifikimet, trajnimet, përvojën dhe supervizimin e nevojshëm për të ofruar shërbime cilësore të ndihmës juridike që e kanë themelin në një të kuptuar plotë të standarteve profesionale të ofruesve të ndihmës juridike, kodeve të sjelljes dhe detyrimeve etike duke përfshirë shërbime të specializuara të ndihmës juridike për popullata të marxhinalizuara dhe vulnerabël, përfshirë këtu fëmijët.

Komenti i Përgjithshëm Nr.24 mbi të Drejtat e Fëmijëve në Sistemin e Drejtësisë për Fëmijë thekson se personi që ofron asistencë duhet të ketë njohuri të mjaftueshme të aspekteve juridike të proceseve të drejtësisë për fëmijë dhe të marrë trajnimet e përshtatshme për këtë.

Kërkesa të përgjithshme për ofruesit e ndihmës juridike

Nga raportet e 14 vendeve tek të cilat është bazuar ky raport studimor, mund të dalim në përfundimin se këto shtete përpiqen të marrin në konsideratë standartet ndërkombëtare të përmendura më sipër dhe kanë përcaktuar kushtet që do të mundësonin kualifikimin e duhur të ofruesve të ndihmës juridike. Megjithatë, modelet e zgjedhura për të zbatuar këto standarde variojnë nga shteti në shtet.

Në kuadër të kushtit për të patur statusin e një avokati dhe të qenit anëtar i dhomës së avokatisë, disa shtete kanë vendosur kushte shtesë për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike.

Në **Lituani**, nëse një avokat kërkon të jetë pjesë e listës së avokatëve që ofrojnë vazhdimisht ndihmë juridike (*ku ndihma juridike është puna kryesore e një avokati nën kontratë me Shërbimet e Ndhmës Juridike Garantuar nga Shteti*), ai/ajo duhet të kalojë një provim special përzgjedhjeje. Pjesa e parë e provimit është e lidhur me njohuritë bazike të ligjit (*ligji kushtetues dhe ligji ndërkobëtar publik dhe privat, etj*) dhe me njohuritë specifike të fushave të ligjit në të cilat aplikuesi synon të ofrojë ndihmë juridike. Pjesa e dytë e provimit ka të bëjë me “vlerësimin e përparësive”. Në këtë fazë, komisioni vlerëson cilësitë personale dhe profesionale të kandidatit, motivimin e tij/saj për të ofruar ndihmë juridike dytësore, përvojën profesionale, aktivitetet mbi kërkimin shkencor dhe aftësi të tjera që mund të jenë të nevojshme për një profesionist që ofron ndihmë juridike.

Në Paris për shembull²⁸, në mënyrë që të përfshihen në listën e avokatëve që dëshirojnë të marrin pjesë në ofrimin e ndihmës juridike, avokatët kandidatë duhet të ndjekin fillimisht një sesion informues mbi ligjin, i cili organizon ndihmë juridike²⁹. Gjithashtu, avokatët duhet të ndjekin një kurs trajnues vjetor 6 orësh për secilën nga fushat e zgjedhura për ofrimin e ndihmës juridike (ligji për familje, punën, tregtare etj.). Në **Itali**, në kuadër të kushtit për të qënë avokat i regjistruar in Dhomës së Avokatisë Italiane, duhet gjithashtu përvoja profesionale dhe mungesa e masave disiplinore për 5 vitet e fundit.

Kërkesa specifike për ofruesit e ndihmës juridike që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët

Parime dhe Udhëzime të KB të vitit 2012

Parimi 11. Ndhimë juridike në interesin më të lartë të fëmijës

58. Shtetet duhet të marrin masat e duhura për të organizuar sisteme të ndihmës ligjore që janë miqësore dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve, duke marrë parasysh aftësitë zhvillimore të tyre dhe nevojën për të gjetur balancën e duhur mes interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës së fëmijës për tu dëgjuar në procedurat gjyqësore duke përfshirë:

(a) Sigurimi (aty ku është i mundur) i mekanizmave të dedikuar për mbështetjen e ndihmës juridike të specializur për fëmijë dhe mbështetjen e integritit të ndihmës juridike për fëmijë në mekanizma të përgjithshme dhe jo të specializuara;

Shumë akte ligjore në fuqi në Europë kërkojnë specializimin për të gjithë aktorët që punojnë me fëmijët në konflikt me ligjin duke përfshirë avokatët, gjykatësit, prokurorët, specialistët e Shërbimit të Provës dhe oficerët e policisë.

Në disa shtete si **Belgjika, Finlanda, Shqipëria, Italia dhe Franca**, në mënyrë që të ofrojë ndihmë juridike për fëmijët, një avokat duhet të jetë në “listën e avokatëve për të mitur”, pra të jetë i

²⁸ Raporti Francez është i fokusuar mbi ofruesit e ndihmës juridike në Paris, ku Dhoma e Avokatisë së Parisit ofron numrin më të madh të ofruesve të ndihmës juridike në Francë, 42% e avokatëve praktikues në vend për 2019: http://www.justice.gouv.fr/art_pix/1_1_commentaire2019_avocats.pdf p. 1

²⁹ (Francë) Ligji n° 91-647 i datës 10 korrik 1991 dhe dekreti zbatues n° 91-1266 i datës 19 dhjetor 1991

specializuar në ofrimin e ndihmës juridike për fëmijë. Në të tilla raste, zyrat e ndihmës juridike kanë listën e tyre të brendshme të ofruesve të ndihmës juridike të specializuar në këtë fushë.

Në disa prej këtyre shteteve, lista mund të gjendet lehtësisht. Dhoma **Finlandeze** e Avokatisë për shembull disponon një listë të avokatëve dhe të fushës së tyre të ekspertizës. Një aplikues mund ta kontaktojë Dhomën Finlandeze të Avokatisë³⁰ ose të përdorë shëbimin e tyre online, i cili i dedikohet gjetjes së avokatëve në mënyrë që të lokalizohet një avokat i specializuar për të drejtat e fëmijëve. Një listë e ofruesve të ndihmës juridike mund të gjendet lehtësisht në faqen zyrtare të Ministrisë **Hungareze**³¹.

Në vende të tjera edhe pse lista ekziston, nuk është po aq e lehtë për tu aksesuar. Bëhet fjalë për **Shqipërinë** dhe **Belgjikën**. Në Shqipëri, avokatët e intervistuar tregojnë se edhe pse lista e avokatëve të specializuar që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve të procedimeve (p.sh gjykata, polici), autoritetet rrallëherë i referohen asaj. Rezulton se avokatët nuk vihen në dispozicion të çështjes bazuar në specializimin e tyre, por në varësi të parapëlqimit që kanë nga oficerët policorë dhe gjykatësit. Prindërit e fëmijëve nuk kanë mundësi të shohin listën e avokatëve të specializuar.

Sidoqoftë, në një sërë shtetesh nuk ka një kategori specifike të "*avokatëve për të rinjtë*". Avokatët mundësojnë ndihmë juridike për fëmijë, por edhe për të rritur dhe nuk ka kufizime në lidhje me specializimin në përputhje me moshën e marrësit të ndihmës juridike. Ky rast gjendet në **Lituani, Gjermani, Austrri, Republikë Çeke, Irlandë** dhe **Poloni**. Në këto shtete, pavarësisht se ka një numër praktikuesish që kanë reputacion si të specializuar për përfaqësimin e fëmijëve, një listë zyrtare e praktikuesve specialistë në ofrimin e ndihmës juridike për fëmijë në procedime penale nuk ekziston.

Megjithatë, specializimi është shumë i rëndësishëm për shkak të trajnimit specifik të ndjekur prej tyre. Një pjesë e madhe e profesionistëve të intervistuar në **Shqipëri, Lituani** dhe **Belgjikë** përgjatë projektit, besojnë se puna me fëmijë në konflikt me ligjin kërkon aftësi specifike dhe njohuri të veçanta. Në të vërtetë, besohet se një njohuri e mirë e ligjit është thelbësore. Profesionistët e intervistuar theksuan nevojën për njohuri të mirë të procedurave që zbatohen për fëmijët, por edhe të njohurive mbi filozofinë e ligjit për të mitur, i cili është shumë i ndryshëm nga ligji penal për të rriturit duke qenë se është mbrojtës dhe jo ndëshkues. Ata duhet të jenë të mirëinformuar në shumë çështje që lidhen me adolëshencën dhe delinkuencën. Një tjetër aftësi që është theksuar shpesh në raporte është ajo e njohurive psikologjike dhe sociale, rëndësia e "*të dimë si të flasim me të miturit*", të jemi të aftë të dëgjohemi dhe kuptohemi nga fëmija (komunikimi me adoleshentët). Për të arritur këtë, profesionistët e intervistuar u shprehën se është e nevojshme të përshtatet fjalori, të kihen aftësi speciale të komunikimit ndërpersonal, që i lejon avokatët të dëgjojnë fëmijët dhe të flasin me ta. Pra, është e

³⁰ www.findanattorney.fi

³¹ <https://szakrendszer.im.gov.hu/nevjegyzeke/>; <https://igazsagugyiinformaciok.kormany.hu/jogi-segitsegnyujtas>.

rekomandueshme që profesionistët që punojnë me fëmijët të përdorin parimet thelbësore të punës sociale me këta të rinj: veçanërisht respekt, dëgjim dhe pranimin.

4.3 Trajnimi i ofruesve të ndihmës juridike

Parime dhe Udhëzime të KB të vitit 2012

Parimi 11. Ndihmë juridike në interesin më të lartë të fëmijës

58. Shtetet duhet të marrin masat e duhura për të organizuar sisteme të ndihmës ligjore që janë miqësore dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve, duke marrë parasysh aftësitë zhvillimore të tyre dhe nevojën për të gjetur balancën e duhur mes interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës së fëmijës për tu dëgjuar në procedurat gjyqësore duke përfshirë:

(d) Promovimi i programeve trajnuese standarte të ndihmës juridike. Ofruesit e ndihmës juridike që përfaqësojnë fëmijët duhet të trajnohen dhe të jenë të informuar mbi të drejtat e fëmijëve dhe çështje që lidhen me to, të marrin trajnime të vazhdueshme dhe të hollësishme dhe të jenë të aftë të komunikojnë me fëmijët në nivelin e tyre të të kuptuarit. Të gjithë ofruesit e ndihmës juridike që punojnë me dhe për fëmijët duhet të marrin trajnime ndërdisiplinore bazike mbi të drejtat dhe nevojat e fëmijëve të grupmoshave të ndryshme dhe mbi procedime që iu janë përshtatur atyre, trajnime në aspekte psikologjike dhe aspekte të tjera të zhvillimit të fëmijës me vëmendje të veçantë për vajzat dhe fëmijët që janë anëtarë të minoriteteve apo grupeve indigjene, dhe mbi masat ekzistuese për promovimin e mbrojtjes së fëmijëve që janë në konflikt me ligjin;

Parimi 13. Aftësitë dhe përgjegjësitë e ofruesve të ndihmës juridike

37. Shtetet duhet të ndërtojnë mekanizma që sigurojnë se të gjithë ofruesit e ndihmës juridike zotërojnë edukimin, trajnimin, aftësitë dhe përvojën në përputhje me natyrën e punës së tyre përfshirë nivelin e veprës me të cilën do punojnë, dhe të drejtat dhe nevojat e grave, fëmijëve dhe grupeve me nevoja të veçanta.

Rregullat e Pekinit sugjerojnë se *"trajnimet, kurset rifreskuese dhe metoda të tjera e të përshtatshme të instruktimit duhet të përdoren për të siguruar dhe mirëmbajtur kompetencën e nevojshme profesionale të të gjithë personelit që punon me çështjet e fëmijëve"* .

Udhëzuesi mbi Drejtësinë Miqësore për Fëmijë i KE thekson rëndësinë e trajnimit të përshtatshëm të avokatëve. Ai citon se avokatët që përfaqësojnë fëmijët duhet të marrin trajnim të vazhdueshëm dhe të hollësishëm dhe të jenë të aftë të komunikojnë me fëmijët në nivelin e tyre të të kuptuarit. Një sistem i avokatëve të specializuar për të miturit është i rekomandueshëm, duke respektuar të drejtën e lirë të fëmijës për një avokat.

Direktiva 2016/1919 mbi ndihmën juridike e BE veçon rëndësinë e trajnimit të përshtatshëm të stafit të përfshirë në vendimmarrjen në ndihmën juridike për fëmijët dhe aftësitë e tyre për të adresuar nevojat specifike të fëmijës.

Komenti i Përgjithshëm Nr.24 thekson gjithashtu se një kusht thelbësor për një zbatim të drejtë dhe efektiv të të drejtave të fëmijëve është cilësia e personave të përfshirë në administrimin e drejtësisë për fëmijë. Trajnimi i profesionistëve, përfshirë këtu përfaqësuesit e fëmijës, është kyç dhe duhet të zbatohet në një formë sistematike dhe të vazhdueshme. "Këta profesionistë duhet të jenë të aftë të punojnë në grupe ndërdisiplinore, dhe duhet të jenë të mirëinformuar mbi zhvillimin fizik, psikologjik, mendor dhe social të fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe të nevojave speciale të fëmijëve të marxhinalizuar" .

Manuali mbi Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve të Ndhmës Juridike në Procese të Drejtësisë Penale i UNODC thekson po ashtu se ofruesit e ndihmës juridike për fëmijë duhet të marrin trajnim të vazhdueshëm në fushat e përshtatshme për përfaqësimin e klientëve fëmijë.

Kushti për trajnimin e duhur të ofruesve të ndihmës juridike është vazhdimisht i përmendur në instrumente ndërkombëtare dhe europiane dhe shpesh shihet si një mjet për të siguruar cilësinë e ndihmës juridike. Pyetja se si ky kusht duhet të zbatohet në nivel kombëtar ka qenë temë diskutimi në shumë vende europiane. Siç edhe studimi gjeti, strategji dhe qasje të ndryshme janë përdorur nga vendet pjesëmarrëse. Për hir të qartësisë, analiza në vijim është e ndarë në dy pjesë: trajnimi fillestar (*trajnim i cili duhet të përmbushet me sukses përpara se subjekti të bëhet ofrues i ndihmës juridike*) dhe trajnim i vazhdueshëm (trajnim i mëtejshëm që kërkohet për të ruajtur njohuritë dhe aftësitë profesionale).

Trajnimi fillestar i ofruesve të ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin

Në shumë vende europiane, mundësia e veprimit si ofrues i ndihmës juridike varet nga trajnimi i marrë nga personi dhe kualifikimet e tij/saj (*siç u përmend më lart, zakonisht në vendet europiane është një avokat, i cili ka të drejtë të ofrojë ndihmë juridike detyësore*). Në vendet ku ekziston kategoria e "avokatëve për të rinj" , përfshirja në këtë kategori shpesh i nënshtrohet një trajnimi fillestar të specializuar, d.m.th. avokati që synon të ofrojë ndihmë juridike për fëmijët në konflikt me ligjin duhet të bëjë një trajnim të mëtejshëm që reflekton kërkesën për njohuri për të punuar me klientët e ndihmës juridike të cilët janë fëmijë.

Belgjika, Franca dhe Italia janë shembuj të vendeve që zgjedhën që trajnimi fillestar i avokatëve që ofrojnë ndihmën juridike për fëmijët të jetë i detyrueshëm.

Në lidhje me trajnimin fillestar në **Belgjikë**, Kodi i Etikës si i Dhomave të Avokatisë frëngjisht-folëse ashtu edhe i gjerman-folësve specifikojnë se, për tu regjistruar në "listën e avokatëve për të rinj", avokati duhet të jetë i specializuar në ligjin për fëmijët, ose të ketë përfunduar me sukses kurset CAPA (çertifikata e aftësisë për profesionin e avokatit të cilën avokatët kursantë duhet ta kalojnë) 3 vite para aplikimit të tij/saj, ose të ketë përfunduar edukimin vazhdueshëm në ligjin për

fëmijët (15 pikët në 3 vitet e mëparshme, duke përfshirë të paktën 8 pikë të trajnimit juridik, një pikë i korrespondon afërsisht një orë trajnimi).

Në **Francë**, Karta e të Drejtave të Fëmijëve për Grupet e Avokatëve të Fëmijëve parashikon që Dhoma e Avokatëve duhet të ketë posaçërisht një grup avokatësh të trajnuar. Ky trajnim i unifikuar multidisiplinar i mundëson Dhomës së Avokatisë të krijojë mbrojtje të personalizuar dhe të përshtatur për nevojat e fëmijës. Ky trajnim është i detyrueshëm dhe falas.

Në **Itali**, avokatët përzgjidhen nga gjykata për të përfaqësuar fëmijët në procedurat penale, të cilët janë pjesë e një liste specifike të përgatitur nga Dhoma e Avokatëve për secilën gjykatë. Kërkesat që duhen plotësuar për tu përfshirë në këtë listë janë: (i) të ushtruarit rregullisht të profesionit të avokatit para gjykatave për të mitur; ose (ii) duke iu ushtruar trajnimit të avancuar për avokatët në lidhje me ligjin për të mitur dhe çështjet që lidhen me të rinjtë. Këto kërkesa aplikohen vetëm për avokatët e përzgjedhur nga gjykata dhe nuk ka ndonjë kërkesë specifike për ofruesit e ndihmës juridike të kontraktuar në mënyra të tjera.

Në **Lituani, Republikën Çeke, Irlandë, Poloni dhe Suedi** nuk është i nevojshëm trajnimi i specializuar për avokatët të cilët ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët. Nuk bëhen dallime ndërmjet avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijë dhe të rritur. I disponueshëm për avokatët është trajnimi vullnetar, i cili është në diskrecionin e tyre nëse e gjykojnë të nevojshme për zhvillimin e tyre profesional.³²

Trajnim i vazhdueshëm i avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike fëmijëve në konflikt me ligjin

Në disa nga vendet pjesëmarrëse në hulumtim, avokatët që përfaqësojnë fëmijët në konflikt me ligjin kërkohet që t'i nënshtrohen trajnimeve të vazhdueshme, në këtë mënyrë, të përditësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Për shembull, në **Belgjikë**, trajnimi i vazhdueshëm është i detyrueshëm. Kjo vlen në përgjithësi për të gjithë avokatët, por veçanërisht për avokatët që dëshirojnë të përfaqësojnë fëmijët. Ata duhet të ndjekin një numër të caktuar orësh në një program trajnimi në lidhje me praktikën ligjore për të mitur. Një avokat i të miturve që nuk arrin të përmbushë edukimin e vazhduar mund të hiqet nga lista e avokatëve për të mitur. Kodi i Etikës së pjesës frëngjisht-folëse dhe gjermane-folëse kërkojnë që një avokat të plotësojë të paktën 18 pikët e trajnimit në ligjin e të miturve çdo tre vjet (një pikë korrespondon përafërsisht me një orë trajnimi).

Në Belgjikë, trajnimi i vazhdueshëm mund të marrë forma të ndryshme, të tilla si: pjesëmarrja në bisedime, dreka me debate, seminare, "ëorkshop-e" në shkolla, një vizitë e organizuar në një institucion publik për Mbrojtjen e Fëmijëve (qendrat e paraburgimit për fëmijët në konflikt me ligjin), etj. Këto seanca trajnimi mund të mbulojnë çështje të ndryshme si prezantimi i

³² https://www.cnb.avocat.fr/sites/default/files/documents/10_cnb-recharte_2017-07-07_ldh_avocats-d-enfants-meilleure-visibilite-logo-chartefinal-p.pdf

reformave në legjislacionin e ligjit për të mitur, kriminalitetin seksual, prindërimin, të drejtën penale në ligjin e të miturve, aspekte të caktuara psikologjike, etj. Seancat kryesisht janë organizuar nga Dhoma e Avokatisë. Përveç kësaj, shoqatat, universitetet dhe aktorë të tjerë mund të ofrojnë kurse të caktuara trajnimi si pjesë e arsimimit të vazhdueshëm të avokatëve.

Zakonisht, seancat trajnuese nuk përfshijnë pjesëmarrjen e fëmijëve. Sidoqoftë, duhet theksuar se trajnimi ad hoc mund të përfshijë edhe pjesëmarrjen e fëmijëve. Ky është rasti i trajnimit të organizuar si pjesë e projektit Youthlab nga DCI Belgjikë në 2021

Në **Itali**, sipas Ligjit për Profesionistët Ligjore, avokatët duhet të angazhohen në aktivitete që synojnë trajnim dhe përditësimin e vazhdueshëm. Qëllimi është të arrijnë 60 orë mësim si në teori, ashtu edhe në praktikë duke marrë pjesë në disa aktivitete siç janë sesionet e trajnimit për çështje ligjore gjatë një periudhe tre vjeçare. Avokatët mund të zgjedhin trajnimin e tyre nga një ofertë e larmishme. Nuk ka përmbytje të detyrueshme për këtë trajnim të vazhdueshëm dhe avokatët mund të zgjedhin programet e trajnimit që duan të ndjekin. Trajnimi mund të jetë falas ose jo. Programet mund të organizohen nga subjekte të ndryshme (p.sh., shoqatat e avokatëve), dhe ndryshojnë në kohëzgjatje dhe përmbytje.

Lidhur me trajnimin e vazhdueshëm në **Francë**, që nga viti 2005, çdo avokat që është regjistruar në Dhomën e Avokatisë duhet të kryejë 20 orë trajnimi të vazhdueshëm në vit (ose 40 orë në dy vjet rresht).

Aktivitetet në vijim konsiderohen të jenë pjesë e trajnimit vazhdueshëm³³: trajnimi ligjor ose profesional i siguruar nga shkollat juridike ose universitetet; trajnim i ofruar nga avokatët me miratimin e shkollës së tyre të drejtësisë, ose nga institucione të tjera arsimore; konferenca të një natyre juridike në lidhje me veprimtarinë profesionale të avokatëve; të mësuarit në distancë; botimi i punimeve me karakter juridik; ofrimi i arsimit juridik në lidhje me profesionin, në një universitet ose mjedis profesional. Këto forma trajnimi të vazhdueshme janë të disponueshme për të gjitha çështjet, përfshirë drejtësinë e fëmijëve. Sidoqoftë, avokatët që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët mund të zgjedhin trajnimin e veçantë vazhdueshëm që duan, duke përfshirë trajnimin jo domosdoshmërisht në lidhje me drejtësinë e fëmijëve; ky trajnim i vazhdueshëm nuk është i detyrueshëm në Francë.

Në vendet ku nuk ekziston ndonjë specializim i "avokatëve për të mitur", mund të ketë një kërkesë për trajnim vazhdueshëm nga ofrues të ndihmës juridike (të cilët ofrojnë ndihmë juridike për çdo klient, të rritur dhe fëmijë), megjithëse në raste të tilla fokusi mund të jetë në çdo fushë të ligjit. Në **Finlandë**, për shembull, nuk ka kërkesa të veçanta për ofruesit e ndihmës juridike që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët. Në përgjithësi, të gjithë avokatët i nënshtrohen një detyrimi

³³ E zhvilluar në 2015 në Hollandë, metodologjia Youthlab përfshin pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në trajnim të profesionistëve të drejtësisë së fëmijëve. Më shumë informacion mbi modelin Youthlab: https://www.younginprison.org/files/uploads/youthlab_flyeren%5B2%5D.pdf Për më shumë informacion kliko në Youthlab: Belgjikë: <https://dei-belgique.be/index.php/projets/en-cours/youthlab.html>

për t'iu nënshtruar 18 orëve të edukimit të vazhdueshëm çdo vit. Dhoma e Avokatisë së Finlandës organizon trajnim për anëtarët e saj. Sidoqoftë, u mbetet avokatëve që të zgjedhin temën e trajnimit në të cilin dëshirojnë të marrin pjesë. Ata nuk kanë detyrim të plotësojnë një seri kriteresh për të gjithë vendin. Programet e trajnimit ofrohen nga universitetet, Dhoma e Avokatisë, ose organizatat joqeveritare. Në Finlandë, trajnimi shpesh përfshin seanca ditore dhe seminare. Përmbajtja varjon nga të drejtat e fëmijëve në tema më specifike. Kohëzgjatja e seancave varet nga lloji i trajnimit; seancat e seminarit shpesh zgjasin një ose dy ditë, ndërsa kurset e ofruara nga universitetet mund të vazhdojnë me javë ose më shumë se një muaj. Kurset e ofruara nga universitetet shpesh janë teorike, ndërsa organizatat joqeveritare ofrojnë kurse më praktike dhe kanë një orientim multidisiplinar. Duhet të theksohet se fëmijët nuk marrin pjesë në këto sesione trajnimi, por shpesh mund të jenë përfshirë statistikat e bazuara në pyetësorët e përgjigjur nga fëmijët.

Një situatë shumë e ngjashme ekziston në **Lituani**.

Si konkluzion, trajnimi i vazhdueshëm i avokatëve të ndihmës juridike është i detyrueshëm në disa vende, por jo në të gjitha. Për më tepër, një kërkesë e tillë për trajnim të vazhdueshëm është shpesh e natyrës së përgjithshme dhe kishte vetëm disa rastet kur avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët në konflikt me ligjin u kërkohet të avancojnë në trajnimin e tyre në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe specifikat e punës me fëmijët. Shumica e këtyre trajnimeve të vazhdueshme janë teorike, edhe pse gjithnjë e më shumë po vihen në dispozicion kurse praktike me orientimi multidisiplinar. Shumë pak kurse duket se integrojnë pjesëmarrjen e fëmijëve.

Kërkesat në lidhje me trajnimin e vazhdueshëm mund të varen nga Dhoma e Avokatisë, në këtë rast ato variojnë në të gjithë vendin. Për më tepër, Dhoma e Avokatëve mund të kërkojë nga anëtarët e saj që të marrin një kurs specifik që nuk kërkohet nga Dhomat e tjera³⁴ të Avokatisë. Prandaj është e rrallë që një trajnim i vazhdueshëm i ofruar të ndihmës juridike të jetë i njëjtë në të gjithë vendin.

4.4 Funkzioni dhe roli i një avokati që ofron ndihmë juridike për fëmijët

Ekzistojnë disa funksione dhe një rol i veçantë që një avokat i ndihmës juridike duhet të ofrojë, duke përfshirë edhe ofrimin e përfaqësimit ligjor për personat e akuzuar në të gjitha fazat e procesit penal, duke punuar me të akuzuarin për tu përgatitur për një gjyq dhe këshillimin e

³⁴ Duhet gjithashtu të theksohet që në 2014, PACE miratoi një rezolutë mbi drejtësinë për të mitur miqësorë me fëmijët, me të cilën sjell vëmendjen tek nevoja për një trajtim specifik e individual për fëmijët në konflikt me ligjin dhe të bazuar në të drejtat. Megjithatë, rezoluta nuk trajton çështjen e ndihmës juridike.

marrësit të ndihmës juridike në lidhje me procesin. Kjo vlen kur klienti i ndihmës juridike është i rritur dhe kur ai/ajo është fëmijë.

Në rastin e një fëmije në konflikt me ligjin, avokati është zëdhënësi i fëmijës dhe jo kujdestar. Cili është funksioni i tij/ i saj? Deri në çfarë mase ai ose ajo duhet të ndërhyjë?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, ne mund t' i referohemi Udhëzuesit të **KE për Drejtësinë Miqësore me Fëmijët**. Sipas këtij Udhëzuesi, një avokat nuk duhet të parashtojë atë që ai/ajo konsideron se është në interesin më të mirë të fëmijës (*ashtu si një kujdestar ose një mbrojtës publik*) por duhet përcaktojë dhe mbrojë pikëpamjet dhe mendimet e fëmijës, si në rastin e një klienti të rritur. Avokati duhet të kërkojë miratimin e informuar të fëmijës për strategjinë më të mirë për tu përdorur. Nëse avokati nuk pajtohet me mendimin e fëmijës, ai/ajo duhet të përpiqet ta bindë fëmijën, siç do të ishte rasti me çdo klient tjetër.

"Fëmijët duhet të konsiderohen si klientë me të drejtat e tyre dhe avokatët përfaqësues të fëmijëve duhet të parashtojë mendimin e fëmijës. "

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) parashikon që roli i ofruesve të ndihmës juridike dhe funksioni i tyre është në përputhje me këto masa mbrojtëse. Në të vërtetë, KDF përcakton në veçanti të drejtën për tu informuar (neni 17), vendimet e shpejta (neni 10), të drejtën për tu "dëgjuar në procedurat gjyqësore dhe administrative që prekin fëmijët " (neni 12), qasje të shpejtë në ndihmën juridike dhe marrja e vendimeve të shpejta nga gjykata (neni 37 (d)). Gjithashtu, KDF thekson rëndësinë e interesit më të lartë të fëmijës. Nga KDF, ne gjithashtu mund të deduktojmë se një rol dhe funksioni tjetër i ofruesit të ndihmës juridike është të trajtojë dhe/ose të sigurojë që fëmija të trajtohet në mënyrë të drejtë, në përputhje me promovimin e kuptimit të dinjitetit dhe vlerës së fëmijës.

Kjo qasje se fëmijët duhet të konsiderohen si klientë të rritur me të drejtat e tyre, pasqyrohet në ligjin e vendeve të shqyrtuara gjatë kësaj analize.

Kodi **Italian** i Etikës dhe Ligji për Profesionistët Ligjore përmbledh mirë funksionet e përgjithshme të avokatit (zbatohet në rastin e klientëve të rritur dhe fëmijë):

- Së pari, avokati duhet të mbrojë të drejtat e lirisë, paprekshmërisë dhe efektivitetit të mbrojtjes, dhe të sigurojë vlefshmërinë e gjykimit dhe pajtueshmërinë me parimin e kundërshtimit gjatë një procedimi gjyqësor;
- Së dyti, gjatë ndihmës së tyre ligjore, avokatët duhet të sigurojnë që ligjet të jenë në përputhje me parimet e Kushtetutës, të Rregulloreve të Bashkimit Europian, si dhe të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në mënyrë që të mbrojë interesat e klientit.

Në **Gjermani**, në mënyrë të ngjashme, roli i një avokati që përfaqëson një fëmijë nuk ndryshon nga roli i një avokati, i cili përfaqëson një të rritur³⁵. Megjithatë, avokati që përfaqëson një fëmijë ka gjithashtu funksionin e forcimit të pozicionit subjektiv të fëmijës në rast, veçanërisht për të

³⁵ (Gjermani) BeckOK / Noak, koment mbi JGG, seksioni 68 neni 12

kompensuar inferioritetin e tij/saj gjuhësor,³⁶ intelektual dhe shoqëror. Për më tepër, avokati është i detyruar të ekuilibrojë mungesën e eksperiencës së fëmijës me procedurën gjyqësore dhe mungesën e njohurive juridike, si dhe duhet të insistojë në respektimin e të gjitha procedurave, rregullave që funksionojnë në favor të të pandehurit. Së fundmi, avokati duhet të sigurojë që të respektohen rregulloret specifike që zbatohen për mbrojtjen e fëmijëve. Është tashmë e njohur se avokatët që mbrojnë fëmijët duhet të jenë zëdhënës i tyre, ashtu siç është rasti kur veprojnë për të rriturit.

Në **Belgjikë**, avokatët e intervistuar theksuan rolin e tyre si zëdhënës të të miturve: *" roli juaj është të jesh zëdhënës i fëmijës. Pyeteni fëmijën se çfarë dëshiron të pyesë dhe thuaja gjyqtarit, si dhe ndihmoje fëmijën ta thotë"*³⁷. Ata listojnë disa misione të tyre: këshillimi, informimi (për atë që do të ndodhë, për të drejtat e tij/ saj), dëgjimi, ndihma, garantimi i respektimit të të drejtave, duke i kërkuar këto para gjykatësit për fëmijën. Për më tepër, një nga avokatet e intervistuar deklaroi se roli i saj është *" të lexojë ligjërisht situatën dhe jo vetëm në bazë të interesit të një fëmije, por më shumë një lexim ligjor"*. Avokati i fëmijës siguron që të respektohen të drejtat e fëmijës, veçanërisht të drejtat procedurale.

4.5 Manuale për rolin dhe misionin e avokatëve që përfaqësojnë fëmijët në procedimet penale

Ekzistenca e dokumenteve mbështetëse profesionale që qartësojnë rolin e avokatit në rrethana të ndryshme mund t'i ndihmojnë ata të kryejnë më së miri detyrat e tyre, si dhe të sigurojnë që të drejtat e fëmijëve respektohen. Prandaj, subjekte të ndryshme kanë hartuar udhëzues për ndihmën juridike miqësore për fëmijët që trajtojnë standardet ndërkombëtare të cilat duhet të përdoren brenda sistemit të drejtësisë për fëmijë.

Në vitin 2018, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) zhvilloi ***Udhëzuesin për Ndihmën Juridike Miqësore për Fëmijët***. Këto udhëzime janë zhvilluar për të qenë një mjet praktik për të mbështetur profesionistët me eksperiencë por edhe ata të rinj, në punën e tyre të përditshme në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Udhëzuesi i drejtohet avokatëve të financuar nga shteti dhe atyre privatë, paraligjorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët në procedurat civile, penale, administrative dhe drejtësisë restauruese.

Ekzistojnë po ashtu disa standarte të veçanta të përcaktuara nga Këshilli i Europës në ***Udhëzuesin për Drejtësinë Miqësore për Fëmijët***.

Në kuadrin e projektit evropian "Avokati im, të Drejtat e mia" u përgatit një guidë praktike për avokatët që përfaqësojnë fëmijët në konflikt me ligjin.³⁸

Gjatë kërkimit tonë, ne u përpoqëm të identifikonim, nëse ekzistojnë instrumente (materiale) shtesë në nivel kombëtar. Megjithatë, u gjetën shumë pak informacione.

³⁶ (Gjermani) BeckOK / Noak, koment mbi JGG, seksioni 68 neni 12

³⁷ Ekstrakt i një interviste me një avokat të të rinjve në Belgjikë

³⁸ Guida është e aksesueshme në 6 gjuhë në website: <https://lachild.eu/the-projects/mylawyer-myrights/manuals/>

Në **Republikën Çeke**, në nivelin kombëtar ekziston një dokument i quajtur Standardet e Punës për Performancën në Mbrojtjen Sociale dhe Ligjore të Fëmijëve që mund të konsiderohet si një udhëzues i veçantë për sigurimin e ndihmës juridike për fëmijët.

Në **Francë**, në kuadër të Kartës së të Drejtave të Fëmijëve për Grupet e Avokatëve të Fëmijëve, Këshilli Kombëtar i Avokatisë (organizata kombëtare që përfaqëson të gjithë avokatët e regjistruar në Dhomën e Avokatisë të Francës) merr përsipër tu vërë në dispozicion të gjitha dhomave informacionin, veprimet dhe modulet e trajnimit. Ajo miratoi një rezolutë për "*një vizibilitet më të mirë të avokatëve të fëmijëve*", të cilët përcaktojnë rolin e avokatit për fëmijët³⁹.

Në **Gjermani**, organizata private Deutsche Vereinigung für Jugendgerichte und Jugendgerichtshilfen e.V. ofron materiale trajnimi dhe trajnim për të gjitha llojet e profesionistëve të përfshirë në procedimi penal për fëmijët.⁴⁰ Po kështu ndodh edhe në **Belgjikë**, ku të dy shoqatat Jeunesse et Droit dhe DCI-Belgjikë ofrojnë trajnime dhe mjete të posaçme për të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët në rrezik dhe / ose në konflikt me ligjin.

³⁹ https://www.cnb.avocat.fr/sites/default/files/documents/10_cnb-recharte_2017_0707_ldh_avocats-d-enfants-meilleure-vizibilite-logo-chartefinal-p.pdf

⁴⁰ <https://www.dvjj.de/>

E DREJTA E FËMIJËVE NË KONFLIKT ME LIGJIN PËR TË MARRË NDIHMËN JURIDIKE

5.1 Rrethanat kur një fëmijë në konflikt me ligjin ka të drejtën e ndihmës juridike.

Direktiva (BE) 2016/800 mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët në procedurat penale

Neni 18. E drejta për ndihmën juridike

Shtetet Anëtare sigurojnë që ligji kombëtar në lidhje me ndihmën juridike garanton ushtrimin efektiv të së drejtës për tu ndihmuar nga një avokat në përputhje me nenin 6.

Neni 6. Ndihma nga një avokat

1. Fëmijët të cilët janë të dyshuar ose persona të akuzuar në procedurat penale kanë të drejtën e pasjes së një avokati në përputhje me Direktivën 2013/48 / BE. Sipas kësaj Direktive, veçanërisht këtij Neni, asgjë nuk duhet të ndikojë mbi këtë të drejtë.

2. Shtetet Anëtare sigurojnë që fëmijët të ndihmohen nga një avokat në përputhje me këtë nen në mënyrë që t' i lejojë ata të ushtrojnë të drejtat e mbrojtjes në mënyrë efektive.

3. Shtetet Anëtare sigurojnë që fëmijët të ndihmohen nga një avokat pa vonesa të panevojshme sapo ata të vihen në djeni që janë persona të dyshuar ose të akuzuar. Në çdo rast, fëmijët do të ndihmohen nga një avokat në secilën prej pikave të mëposhtme cilado qoftë me e hershme në kohë:

- (a) para se të merren në pyetje nga policia ose nga një autoritet tjetër i zbatimit të ligjit ose gjyqësor;
- (b) gjatë kryerjes së hetimit nga autoritetet e hetimit ose të tjera autoritete kompetente për veprimet hetimore apo mbledhjen e provave në përputhje me pikën (c) të paragrafit 4;
- (c) pa vonesa të panevojshme pas heqjes së lirisë;
- (d) kur ata janë thirrur të paraqiten para një gjykate që ka juridiksion në çështjet penale, në kohën e duhur para se të paraqiten para gjykatës.

4. Ndihma nga një avokat përfshir.

(a) Shtetet Anëtare sigurojnë që fëmijët të takohen privatisht dhe të komunikojnë me avokatin që i përfaqëson ata, përfshirë edhe para marrjes në pyetje nga policia ose nga një autoritet tjetër ekzekutues ose autoriteti gjyqësor;

(b) Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që fëmijët të ndihmohen nga një avokat kur merren në pyetje, dhe avokati të jetë në gjendje të marrë pjesë në mënyrë efektive. Një pjesëmarrje e tillë do të jetë në përputhje me procedurat ligjore kombëtare, me kusht që këto procedura të mos paragjykojnë ushtrimin efektiv ose thelbin e së drejtës në fjalë. Kur avokati merr pjesë gjatë marrjes në pyetje, vetë fakti që ka ndodhur kjo pjesëmarrje do të shënohet duke përdorur regjistrimin procedural sipas ligjit kombëtar;

(c) Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që fëmijët, të paktën, të ndihmohen nga një avokat gjatë veprimeve hetimore ose mbledhjes së provave, kur këto akte parashikohen në bazë të ligjit të vendit dhe nëse personit të dyshuar ose të akuzuar i kërkohet ose lejohet të marrë pjesë në aktet që lidhen me:

-Të dhënat e identitetit

-Konfrontimet;

-Rindërtimi i skenës së krimit.

5. Shtetet Anëtare respektojnë konfidencialitetin e komunikimit ndërmjet fëmijëve dhe avokatit të tyre në ushtrimin e së drejtës për tu ndihmuar nga një avokat i parashikuar në këtë Direktivë. Komunikime të tilla do të përfshijnë takime, korrespondenca, biseda telefonike dhe forma të tjera të komunikimi të lejuara nga ligji kombëtar.

6. Me kusht që të jetë në përputhje me të drejtën për një gjykim të drejtë, Shtetet Anëtare mund të heqin dorë nga paragrafi 3 kur ndihma e një avokati nuk është proporcionale me rrethanat e çështjes, duke marrë parasysh seriozitetin e veprës penale të pretenduar, kompleksitetin e çështjes dhe masat që mund të merren në lidhje me një vepër të tillë, duke theksuar se interesat më të larta të fëmijëve do të jenë gjithmonë një konsideratë kryesore.

Në çdo rast, Shtetet Anëtare sigurojnë që fëmijët të ndihmohen nga një avokat:

(a) kur ato sillen para një gjykate ose gjykatësi kompetent për të vendosur mbi paraburgimin në çdo fazë procedimi brenda fushës së veprimit të kësaj Direktive; dhe

(b) gjatë ndalimit.

Shtetet Anëtare sigurojnë gjithashtu që heqja e lirisë të mos shqiptohet si një dënim penal, përveçse nëse fëmija është ndihmuar nga një avokat në një mënyrë të tillë që të lejojë fëmijën të ushtrojë të drejtat e mbrojtjes në mënyrë efektive dhe, në çdo rast, gjatë seancave gjyqësore para gjykatës.

7. Kur fëmija duhet të ndihmohet nga një avokat në përputhje me këtë nen, por nuk ka asnjë avokat aktualisht, autoritetet kompetente do të shtyjnë marrjen në pyetje të fëmijës, hetime të tjera ose aktet për mbledhjen e provave të parashikuara në pikën (c) të paragrafit 4, për një periudhë kohe të arsyeshme për të lejuar ardhjen e avokatit ose nëse fëmija nuk ka emëruar një avokat, për të siguruar një avokat për fëmijën.

8. Në rrethana të jashtëzakonshme, dhe vetëm në fazën paragjyqësore, Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë përkohësisht nga zbatimi i të drejtave të parashikuara në paragrafin 3 në masën e justifikuar në bazë të rrethanave të veçanta të çështjes dhe në bazë të njëjës nga arsyet e detyruese të mëposhtme:

(a) kur ka një nevojë urgjente për të shmangur pasoja serioze anësore për jetën, lirinë ose integritetin fizik të një personi;

(b) kur veprimi i menjëhershëm nga autoritetet hetuese është i domosdoshëm për të parandaluar rrezikimin substancial të procedimit penal në lidhje me një vepër të rëndë penale.

Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente, kur zbatojnë këtë paragraf, të marrin në konsideratë interesat më të larta të fëmijës.

Vendimi për të vijuar marrjen në pyetje në mungesë të avokatit sipas këtij paragrafi, mund të merret vetëm me një bazë rast pas rasti, ose nga një autoritet gjyqësor, ose nga një autoritet tjetër kompetent me kusht që vendimi të mund të nënshtrohet rishikimit gjyqësor.

Parimet dhe udhëzimet e KB 2012

Parimi 3. Ndhimja juridike për personat e dyshuar ose të akuzuar për një vepër penale

22. Fëmijët duhet të kenë akses në ndihmë juridike në të njëjtat kushte *si* ose në kushte më të buta sesa të rriturit.

Udhëzimi 1. Sigurimi i ndihmës juridike

Kurdoherë që shtetet zbatojnë një test të "burimeve" për të përcaktuar të drejtën për ndihmë juridike, ata duhet të sigurojnë që: Fëmijët përjashtohen gjithmonë nga ky test;

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 40

(b) Çdo fëmijë i pretenduar si ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal i garantohet sa vijon;
(ii) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat kundër tij/saj, dhe, nëse është e përshtatshme, përmes prindërve të tij ose kujdestarëve ligjorë, si dhe të ketë ndihmë juridike ose ndihmë tjetër të përshtatshme në përgatitjen dhe prezantimin e mbrojtjes së tij/saj.

Së pari duhet të theksohet se, në të gjitha vendet e marra në analizë, fëmijët marrin ndihmën juridike në çështjet penale në kushte jo më pak të favorshme sesa të rriturit. E drejta për ndihmë juridike nuk kushtëzohet nga kombësia, por është në dispozicion për të gjithë brenda juridiksionit të shteteve.⁴¹

Në shumicën e rasteve, kur fëmija nuk e kupton gjuhën vendase, ligjet parashikojnë gjithashtu të drejtën për një përkthyes që ta ndihmojë në komunikim gjatë procedurave (shih seksionin 7.4 më poshtë).

Në disa nga vendet, kur një fëmijë është i dyshuar ose i akuzuar, pjesëmarrja e një avokati konsiderohet e detyrueshme (rastet e mbrojtjes së detyrueshme). Shpesh, situata financiare e fëmijës nuk vlerësohet dhe vetëm në disa raste ligjet kombëtare parashikojnë ripagimin e tarifave të ndihmës juridike nëse fëmija është dënuar.

Të dyshuarit që janë arrestuar kanë të drejtë të konsultohen me një avokat para marrjes në pyetje të policisë dhe të kenë të drejtën për të pasur një avokat të pranishëm gjatë marrjes në pyetje në polici (shih gjykimin e Salduz kundër Turqisë (2008) të Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut).

⁴¹ Nuk ka përjashtime në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike në rast të veprave terroriste, përkundrazi prania e një avokati mbrojtës është e detyrueshme kur një fëmijë akuzohet për terrorizëm.

Në **Lituani**, sipas Kodit të Procedurës Penale, kërkohet pjesëmarrja e një avokati në ekzaminimin e rasteve kur i dyshuari ose i akuzuari është një fëmijë (*në të gjitha rastet e tilla bëhet e detyrueshme mbrojtja*⁴²). Bazuar në Kodin e Procedurës Penale, ndihma e njëjtë i ofrohet gjithashtu fëmijëve viktimë të një krimi, por kur konsiderohet i nevojshëm nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Prokurori (*me një vendim të motivuar*) ose Gjyqtari (*urdhër gjykatë*⁴³). Fëmijët në konflikt me ligjin dhe ata që janë viktimat e një veprë penale kanë të drejtën e ndihmës juridike detyruese pa marrë parasysh pasuritë dhe të ardhurat e tyre.

Nga momenti që shfaqet e drejta për një avokat dhe ndihmë juridike, fëmijët (siç ndodh për të rriturit) kanë të drejtë për avokat nga momenti i arrestimit ose marrjes në pyetje të parë. Oficeri i policisë gjyqësore, prokurori dhe gjykata do t'ia shpjegojnë këtë të drejtë të dyshuarit dhe të akuzuarit si dhe do t'i mundësojnë atij/ asaj të ushtrojë këtë të drejtë. Të dyshuarit të ndaluar do t'i jepet mundësia për tu takuar me një avokat para marrjes në pyetje për herë të parë pa persona të tjerë të pranishëm.

Në **Belgjikë**, siç u përmend më lart, ndihma juridike është plotësisht falas për fëmijët⁴⁴. Për më tepër, fëmijë mund të mos heqin dorë nga e drejta e tyre për tu ndihmuar nga një avokat⁴⁵. Fëmijët kanë të drejtë të ndihmohen nga një avokat nga fillimi i seancës dëgjimore të policisë. Më konkretisht, kjo e drejtë përfshin konsultimin konfidencial midis fëmijës dhe avokatit para intervistës, si dhe pjesëmarrjen e avokatit gjatë intervistës⁴⁶. E njëjta procedurë zbatohet edhe kur bëhet intervista kryhet nga një prokuror ose një gjyqtar.

Në **Shqipëri**, ligji përcakton shumë qartë që fëmijët në konflikt me ligjin duhet të ndihmohen gjithmonë nga një avokat. Kjo vlen që nga momenti i parë i të qenit në kontakt me policinë para fillimit të marrjes në pyetje nga policia, duke e bërë të detyrueshme praninë e një avokati gjatë gjithë procedurave, përfshirë fazën e ekzekutimit të dënimit.

Ligji në **Hungari** parashikon që ndihma juridike për fëmijët në konflikt me ligjin është e detyrueshme që nga momenti i parë i procedurave ligjore. Për më tepër, bazuar në Aktin për Ndihmën Juridike, fëmijët në konflikt me ligjin mund të marrin ndihmën juridike pavarësisht nga niveli i të ardhurave të tyre.

Në **Austri**, ndihma juridike u sigurohet të rriturve dhe fëmijëve në të njëjtat rrethana dhe nuk është e kushtëzuar nga kombësia e personit. Për fëmijët nga 14 deri në 18 vjeç të akuzuar për një veprë penale, ndihma juridike është e detyrueshme gjatë gjithë procedurave ligjore në gjykatat rajonale dhe nëse është e nevojshme gjithashtu gjatë procedimeve në gjykatat e rrethit.

Në **Francë**, në rastin e një fëmije të dyshuar ose të akuzuar për një veprë, ose të dënuar për të, nuk merren parasysh burimet financiare nëse prindërit e fëmijës nuk janë të gatshëm ta

⁴² (Lituania) neni 51(1) i Kodit të Procedurës Penale (Pjesëmarrja e detyrueshme e avokatit)

⁴³ (Lituania) neni 51(1) i Kodit të Procedurës Penale

⁴⁴ (Belgjikë) Ndihma juridike është ndihma e dhënë për një palë ndërgjyqësore për të mbuluar shpenzimet gjyqësore 3 Gusht 2016. — Arrêté royal modifiant l'arrêté royal du 18 décembre 2003 déterminant les conditions de la gratuité totale ou partielle d'assistance juridique de deuxième ligne et de l'assistance judiciaire).

⁴⁵ (Belgjikë) neni 47 bis i Kodit të hetimit Penal

⁴⁶ (Belgjikë) neni 47 bis i Kodit të hetimit Penal

ndihmojnë atë financiarisht. Në raste të tilla, shërbimi juridik ofrohet falas. Prania e një avokati është e detyrueshme gjatë gjithë procedurës penale kur një fëmijë ndiqet penalisht⁴⁷. Për më tepër, prania e një avokati është gjithashtu e detyrueshme kur një fëmijë ndalohej nga policia, edhe pse ai/ ajo ende nuk po ndiqet penalisht⁴⁸.

Në **Spanjë**, si në vendet e tjera, fëmijët e dyshuar ose viktime të një veprë penale kanë të drejtën e ndihmës juridike falas gjatë gjithë procedurave ligjore. Bazuar në Kodin e Procedurës Penale, avokati mbrojtës duhet të jetë i pranishëm në secilën fazë të procesit ligjor. Para fillimit të procedimit kundër një fëmije, prokurori kërkon që fëmija dhe përfaqësuesit e tij ligjorë të gjejnë një avokat brenda tre ditëve⁴⁹. Nëse ata nuk e bëjnë këtë, avokati emërohet ex officio nga lista e Dhomës së Avokatëve.

Duhet të theksohet se në disa shtete të BE-së, ka kërkesa për situatën financiare të fëmijës ose prindërve (teste të burimeve). Në raste të tjera, ripagimi i tarifave të ndihmës juridike mund të kërkohej në rastin e dënimit.

Në **Republikën Çeke**, një fëmijë ka të drejtën e ndihmës juridike që nga momenti kur masat sipas ligjit mbi Drejtësinë për të Mitur janë zbatuar ndaj tij ose janë kryer veprimet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Nëse një fëmijë nuk ka mundësi të sigurojë një avokat privat, ndihma juridike sigurohet nga shteti, por nëse fëmija dënohet, atëherë tarifa e ndihmës juridike duhet të paguhet. Sidoqoftë, nëse fëmija kërkon ndihmë juridike falas, i takon gjyqtarit të vendosë nëse ky shërbim do të jepet.

Sipas Aktit të Ndihmës Ligjore, në **Finlandë** ndihma juridike u sigurohet fëmijëve në konflikt me ligjin dhe që nuk mund të përballojnë shpenzimet e procesit ligjor. Meqenëse fëmijët kanë burime të kufizuara financiare, pagesa e ndihmës juridike zakonisht paguhet nga prindërit e tyre. Nëse niveli i të ardhurave të prindërve është nën 600 EUR, atëherë ndihma juridike është falas; nëse niveli i të ardhurave të tyre është mbi 1300 EUR, atëherë ndihma juridike nuk është falas. Nëse niveli i të ardhurave është midis 600 dhe 1300 EUR zbatohet zbritja e pjeshme e tarifës. Bazuar në Aktin Finlandez të Procedurës Penale, prania e një mbrojtësi ligjor është e detyrueshme kur një fëmijë është i akuzuar për veprë penale. Nëse fëmija nuk ka mundësi të sigurojë një avokat, atëherë i caktohet një këshilltar ligjor publik.

Në **Gjermani**, sipas Ligjit për Gjykatat e Rinisë, në rastin e mbrojtjes së detyrueshme këshilltari mbrojtës caktohet para seancës së marrjes në pyetje⁵⁰. Përrjashtime nga ky rregull ekzistojnë nëse detyra do të konsiderohej jo në interesin më të lartë të fëmijës duke marrë parasysh rrethanat të çështjes. Gjithashtu, në raste të veçanta, marrja në pyetje mund të bëhet pa caktimin paraprak të një mbrojtësi. Nëse nuk është rasti për një mbrojtje të detyrueshme, fëmijës mund t' i caktohet një këshilltar nga kryetari në çdo fazë të procedurës.

⁴⁷ (France) neni 4-1 të rendit n° 45-174 i 2 Shkurt, 1945

⁴⁸ (France) Ligji n° 2016-1547.

⁴⁹ (Spanja) neni 22.2 i Ligjit Organik 5/2000, 12 Janar, rregullon përgjegjësinë penale të fëmijëve

⁵⁰ (Gjermania) Seksioni 68 a i Gjykatës së të Rinjve

Nëse fëmija është dënuar, atij / asaj i ngarkohet një tarifë e ndihmës juridike. Nëse fëmija nuk mund të paguajë pagesën e ndihmës juridike, ajo mbulohet nga fondet e shtetit. Nëse fëmija ka akses në një mekanizëm privat për të ngritur akuzën, ai/ajo ka të drejtë për ⁵¹ ai /ajo ka të drejtë për një mbrojtës të caktuar nga gjykata ose ndihmë juridike në përputhje me parimet e legjislacionit të Kodit civil.

5.2 Aksesit në informacion në lidhje me ndihmën juridike

Sipas ligjit ndërkombëtar dhe ligjit të BE-së, personat e dyshuar ose të akuzuar, dhe veçanërisht fëmijët, kanë të drejtën për t'u informuar në lidhje me të drejtat e tyre, veçanërisht në lidhje me mundësinë e ndihmës juridike. Informacioni i duhur mbi të drejtat procedurale është thelbësor për efektivitetin e këtyre të drejtave.

Direktivat e BE 2012/13 / BE dhe 2016/800 / BE citojnë të drejtën e personave të dyshuar ose të akuzuar për tu informuar si duhet për të drejtat e tyre (neni 3). Direktiva 2016/800 specifikon që fëmijët e dyshuar ose të akuzuar duhet të informohen për të drejtën e tyre mbi ndihmën juridike. (Neni 6).

Udhëzuesi i KB 2012 për Ndihmën Juridike dhe Udhëzuesi i KE për Drejtësinë Miqësore me Fëmijët parashikojnë të drejtën e njerëzve për tu informuar mbi të drejtën e tyre për ndihmën juridike.

Informimi i gjerë i fëmijëve dhe popullatës për ndihmën juridike

Në përputhje me **Udhëzimet e KB 2012 për Ndihmën Juridike**, informacioni në lidhje me ndihmën juridike duhet t' i "vitet në dispozicion e komunitetit dhe publikut të gjerë në zyrat e qeverisjes vendore, arsimore, në institucionet fetare dhe përmes mediave, duke përfshirë internetin, ose mjete të tjera të përshtatshme;" (Udhëzimi 2).

Udhëzimet e KE për **Drejtësinë Miqësore për Fëmijët** shprehen: "Materiale miqësore për fëmijë që përmbajnë çështje të rëndësishme të informacionit ligjor duhet të vihen në dispozicion dhe të shpërndahen gjerësisht, dhe shërbime të veçanta informacioni për fëmijë duhet të krijohen siç janë faqet e internetit të specializuara dhe linjat e ndihmës" (IV, A, 1.).

Në vendet e studiuara, nuk kishte asnjë fushatë informimi për ndihmën juridike për fëmijët e identifikuar. Megjithatë, duhet të përmenden disa praktika interesante me qëllim sigurimin e aksesit në informacion për një numër të madh fëmijësh.

Në **Finlandë**, të gjithë nxënësit finlandezë të shkollave të mesme marrin pjesë në leksione mbi sistemin ligjor finlandez si pjesë e kurrikulës së tyre të studimeve shoqërore. Në **Shqipëri**, Drejtoria e Ndihmës Ligjore Falas (*organi i ngarkuar administrativ me koordinimin e shërbimeve të ndihmës juridike të ofruara në nivel lokal*) ka misionin e kryerjes së fushatave ndërgjegjësuere

⁵¹ (Gjermania) BeckOK/Weiner, komentit në StPO seksioni 395 neni 1

mbi sistemin dhe procedurat e ndihmës juridike. Megjithatë, për momentin, vonesat në krijimin e institucionit dhe mos rekrutimin e të gjithë stafit kanë rezultuar në këtë detyrë ende të papërbushur. Në **Hungari**, informacioni është i aksesueshëm përmes fletushkave dhe posterave që vendosen në institucione të caktuara nga organizatat e financuara nga shteti, duke informuar fëmijët për mënyrat e mundshme që të marrin ndihmën juridike kur është e nevojshme. Në **Lituani**, për fëmijët janë në dispozicion fletushka të printuara për ndihmë juridike dhe online gjithashtu.

Përveç sa më sipër, në shumë vende informacioni mbi aksesin në ndihmën juridike është në faqet e internetit. Në **Suedi**, Shërbimet sociale kanë një faqe në internet që përfshin disa informacione të kufizuara në lidhje me ndihmën juridike⁵². Në **Austri**, informacioni për ndihmën juridike jepet gjithashtu në faqet e internetit të organizatave dhe institucioneve për fëmijë. Në **Spanjë**, faqet e internetit të qeverisë së secilit Komunitet Autonom ofrojnë informacion në lidhje me këtë qëllim. Në **Belgjikë**, informacioni është në dispozicion në faqet e internetit të ndryshme, të tilla si faqet e internetit të Dhomës së Avokatëve.

Përkundër aksesit në informacionin në internet, ai nuk sigurohet gjithmonë në një mënyrë miqësore për fëmijë, ose lehtësisht të arritshme dhe të kuptueshme për publikun e gjerë.

Institucionet dhe organizatat që ofrojnë informacion mbi ndihmën juridike

Kur fëmijët duhet të informohen për ndihmën juridike dhe si ta aksesojnë atë, ata mund ta marrin këtë informacion duke kontaktuar organizata dhe institucione të ndryshme.

Institucionet dhe organizatat që ofrojnë ndihmë juridike parësore kanë një rol shumë të rëndësishëm në informimin e fëmijëve për të drejtën e tyre për të marrë ndihmë juridike detyësore. Kjo praktikë është e zakonshme për shumë vende të vëzhguara.

Në **Francë** Për shembull, zyrat e ndihmës juridike (les bureaux d' aide juridictionnelle) përdoren për të informuar ndërgjyqësit në përgjithësi në lidhje me ndihmën juridike dhe gjithashtu, që nga krijimi i saj, "shërbimet unike të pritjes për ndërgjyqësit"⁵³ ka një mision të informojë përdoruesin individualisht për procedurat e tij/saj, përveç sigurimit të informacionit të përgjithshëm mbi procedurat. Brenda këtij kuadri, kjo zyrë pranon persona që dëshirojnë të paraqesin një kërkesë për ndihmë juridike. Disa iniciativa lokale në lidhje me fëmijët veprojnë gjithashtu në vend, për shembull, Dhoma e Avokatisë së Parisit ka një degë për çështjet e fëmijëve e cila u përgjigjet të gjitha pyetjeve në lidhje me ta⁵⁴.

Në **Belgjikë**, informimi i publikut, përfshirë fëmijët, për ndihmën juridike varet pjesërisht nga Komisionet e Ndihmës Ligjore (organizatat kryesore të ndihmës juridike parësore) dhe organizata të tjera të miratuara për ndihmë juridike në linjë në komunitetin frëngjishtfolës. Ata

⁵² www.kallpasoc.se

⁵³ (France) Service unique d'accueil du justiciable, e krijuar nga ligji nr 2016-1547 në 18 Nentor 2016 në modernizimin e drejtësisë të shekullit 21

⁵⁴ l'Antenne des mineurs du barreau de Paris

duhet të sigurojnë përhapjen e "informacionit mbi ekzistencën dhe kushtet e mundësisë së ndihmës juridike." Në **Spanjë**, Dhoma e Avokatisë së çdo qyteti është e ngarkuar me ofrimin e ndihmës juridike falas dhe ofron informacion në lidhje me këtë.

Në të gjithë Evropën, OJF të ndryshme dhe shoqata lokale ofrojnë informacion mbi ndihmën juridike për fëmijët. Për shembull në **Gjermani**, Shoqata Federale për Mbrojtjen e Fëmijëve (Der Kinderschutzbund), e cila është e përbërë nga shoqata të ndryshme lokale dhe rajonale, ofron këshilla juridike falas nga avokatë me përvojë.

Avokatët gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e fëmijëve për ndihmën juridike⁵⁵. Për shembull, në **Belgjikë**, avokatët, kanë detyrimin të informojnë të gjithë fëmijët që mund t'i kontaktojnë ata për ndihmën juridike. Bazuar në Kodin e Etikës për Avokatët (OVB) ashtu edhe Kodin Deontologjik të Avokatit (OBFG), çdo avokat i cili supozon ose e di që klienti që po konsultohet me të, i plotëson kushtet për marrjen e ndihmës juridike dytësore "*ka një detyrë etike të informojë klientin për këtë*"⁵⁶.

Së fundmi, shërbimet sociale gjithashtu mund të luajnë një rol në informimin e fëmijës për të drejtën e tij/saj për ndihmë juridike. Për shembull, në **Suedi**, shërbimet sociale zakonisht informojnë fëmijën dhe prindërit e tij për të drejtat e fëmijës gjatë procesit, përfshirë ndihmën juridike.

Detyrimi për të informuar një fëmijë që është i dyshuar, i akuzuar ose i dënuar

Kur një fëmijë hyn në kontakt me sistemin e drejtësisë sepse dyshohet, akuzohet ose dënohet për një vepër, të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë kanë një mision dhe detyrim të informojnë fëmijën në lidhje me të drejtat e tij /saj, veçanërisht të drejtat procedurale.

Udhëzimet e KB për Ndihmën Juridike 2012 parashikojnë se shtetet duhet të sigurojnë që "oficerët e policisë, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe zyrtarët në çdo institucion ku personat janë burgosur ose ndaluar " *informojnë personat e papërfaqësuar për të drejtat e tyre në lidhje me ndihmën juridike* (Udhëzimi 2). Udhëzimet theksojnë që informacioni për ndihmën juridike duhet të sigurohet në komisariatet e policisë, qendrat e paraburgimit, gjykatat dhe burgjet.

Fëmijët në kontakt me sistemin e drejtësisë duhet të informohen menjëherë për të drejtat e tyre. ***Direktiva Evropiane 2016/800*** parashikon që sa më shpejt që fëmijët të vihen në djeni se janë të dyshuar duhet të informohen menjëherë për të drejtat e tyre (përfshirë aksesin tek avokati dhe ndihmën juridike).

⁵⁵ (Belgjike) Kodi Juridik neni 508/3 dhe ne Komunitetin Francez: neni 20 i 2016 Dekreti për ndihmën juridike të linjës së parë

⁵⁶ (Belgjike) Përmbledhje e ndihmës juridike të linjës së dytë referuar Kodit Deontologjik të OVB neni 89 dhe Kodi Deontologjik i OBFG i ndjekur nga neni. 5.10.

Kjo kërkesë për mos vonuar informimin në lidhje me mundësinë e ndihmës juridike është gjithashtu e theksuar në ***Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore për Fëmijët*** të cilat përcaktojnë se fëmijët duhet të jenë të informuar për të drejtat e tyre "që nga përfshirja e tyre e parë me sistemin e drejtësisë ose autoritetet kompetente" (Pjesa IV, A, 1). ***Udhëzimet e KB 2012 për Ndhimën Ligjore*** theksojnë që informacioni duhet të jetë dhënë "para çdo marrje në pyetje dhe në kohën e heqjes së lirisë" (Parimi 8, nr. 29).

Është thelbësore që informacioni mbi të drejtën për ndihmën juridike të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo ndihmon për të siguruar që fëmija të mos privohet nga avokati në çdo seancë dëgjimore me oficerin e policisë ose gjyqtarin për shkak të mungesës së vetëdijes për të drejtën e tij ose të saj për të pasur një avokat. Në të vërtetë, një fëmijë që nuk është informuar si duhet në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike, mund të heqë dorë nga e drejta për t'u ndihmuar nga një avokat për arsye financiare.

Kur një fëmijë privohet nga liria, informacioni mbi ndihmën juridike varet edhe më shumë nga autoritetet sepse ata mund të jenë të vetmit persona në kontakt direkt me fëmijën. Në këtë rast, ata janë të detyruar të informojnë fëmijën mbi të drejtën për një avokat dhe mundësinë e ndihmës juridike sapo fëmija privohet nga liria. Ky standard shpesh përcakton detyrimin për t' i dhënë fëmijës listën e të drejtave apo "kartën e të drejtave" .

Në të gjitha vendet që morën pjesë në këtë kërkim, ligji parashikon të drejtën e një personi që është arrestuar, është i dyshuar apo i akuzuar për një vepër penale që të informohet për të drejtat e tij/saj menjëherë dhe përpara se të dëgjohet. Ligjet kombëtare kërkojnë që autoritetet e përfshira në këtë procedurë (oficerët e policisë, prokurorët, gjyqtarët etj) të informojnë fëmijën për të drejtat e tij/saj, duke përfshirë të drejtën për tu mbrojtur nga një avokat menjëherë sapo fëmijës i privohet liria.

Në **Lituani**, për shembull, Kodi i Procedurës Penale⁵⁷ detyron një hetues, një prokuror apo Gjykatën të informojë një të dyshuar rreth të drejtës së tij për të patur një avokat që nga momenti i arrestit, apo marrja e parë në pyetje dhe të sigurojë mundësinë e ushtrimit të kësaj të drejte. Karta e të drejtave, e cila duhet t' i jepet çdo të dyshuari, përmban deklaratën formale se 'në rastin kur i dyshuari nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën juridike, atij/asaj do t' i ofrohet falas kjo ndihmë në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj që rregullon ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.⁵⁸ Një referencë ndaj mundësisë

⁵⁷ (Lituania) Kodi i Procedurës Penale (Neni 50(1)).

⁵⁸ (Lithuania) Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr. I-288 i 29 Dhjetorit 2014. Lietuvos Respublikos generalinio prokuroro įsakymas I-288 "Dėl baudžiamojo proceso dokumentų formų patvirtinimo" . Gjetet nw website: <https://www.e-tar.lt/portal/lt/legalAct/7d88c1908f6911e4a98a9f2247652cf4/asr>

për marrjen e ndihmës juridike falas është përfshirë po ashtu tek Regjistrimi i njoftimit për të drejtën e aksesit për një avokat.⁵⁹

Në **Shqipëri**, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore duhet të marrin masa strikte në përputhje me parashikimet e proceduriale penale për të informuar fëmijën në mënyrë direkte, ose përmes prindërve apo një përfaqësuesi ligjor, mbi të drejtën për ndihmën juridike falas⁶⁰ e po ashtu për çdo ndihmë tjetër të nevojshme.

Në **Belgjikë**, kur një fëmijë privohet nga liria në një komisarjat policie dhe do të dëgjohej si i dyshuar, atij ose asaj i jepet deklarata e të drejtave që përfshin mundësinë për të kërkuar një avokat në kontekstin e ndihmës juridike. Kjo kartë të drejtash nuk i referohet në mënyrë të veçantë të miturve dhe nuk është e shkruar në një gjuhë miqësore për fëmijët.

Në mënyrë të ngjashme, në **Irlandë**, një person i akuzuar ka të drejtën të informohet nga gjykata në të cilën ai ose ajo do të paraqitet lidhur me të drejtën e mundshme për të patur ndihmë juridike.

Në Francë, pa iu referuar ndihmës juridike, Kodi i Procedurës Penale,⁶¹ parashikon që personi i privuar nga liria do të informohet menjëherë nga oficeri i policisë gjyqësore, ose nën supervizionin e tij, në një gjuhë që ai/ajo e kupton, lidhur me të drejtat e tij/saj, duke përfshirë të drejtën për këshillim ligjor.

Prezantimi i informacionin në një mënyrë miqësore për fëmijët

Në mënyrë që të sigurohemi që informacioni rreth aksesit në ndihmën juridike është paraqitur në mënyrë të saktë, është e rëndësishme jo vetëm të transmetohet ky informacion, por gjithashtu të sigurohemi që ai është dhënë në një mënyrë të kuptueshme për fëmijët. Kjo nënkupton se informacioni duhet të jepet në një mënyrë miqësore për fëmijët. (psh. gjuhë e qartë, më pak terma formal) dhe një gjuhë që fëmija e kupton (e përkthyer nëse nevojitet).

Sipas **Direktivës së BE (2012/13/BE dhe e konfirmuar nga BE/2016/800)**, informacioni mbi të drejtat duhet të jepet në një gjuhë të thjeshtë dhe të aksesueshme duke marrë parasysh nevojat e veçanta të personave vulnerabël.

⁵⁹ (Lituania) Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr. I-288 i 29 Dhjetorit 2014. Lietuvos Respublikos generalinio prokuroro įsakymas I-288 "Dėl baudžiamojo proceso dokumentų formų patvirtinimo". Gjetet nw: <https://www.e-tar.lt/portal/lt/legalAct/7d88c1908f6911e4a98a9f2247652cf4/asr>

⁶⁰ (Shqipëria) Neni 10 – Urdhri. 3 i datës 25.11.2013, "Për hetimin e veprave penale me fëmijë të akuzuar, dyshuar ose dëshmitarë"

⁶¹ (France) Neni 63-1 i Kodit të Procedurës Penale.

Direktiva e KB mbi Ndhimën Ligjore e 2012 dhe Udhëzuesi i Këshillit të Europës mbi Drejtësinë miqësore për Fëmijët theksojnë se “për fëmijët, informacioni duhet të jepet “në një mënyrë të përshtatur me moshën dhe pjekurinë, në një gjuhë të cilën ata mund ta kuptojnë, e cila është e ndjeshme ndaj kulturës dhe gjinisë” (Udhëzuesi i KE, Pjesa IV, A, 1, 2, Udhëzuesi i KB 2, §42, (d))

Nga kërkimi ynë rezultoi se në disa vende pjesëmarrëse ka një rregull që kërkon paraqitjen e të drejtës për ndihmë juridike në një mënyrë miqësore për fëmijët. Sidoqoftë, nuk ka një kartë të drejtash e shkruar në një mënyrë miqësore për fëmijët.

Ligji Gjerman⁶² parashikon, si rregull specifik për fëmijët në konflikt me ligjin, se udhëzimet e miratuara duhet të korrespondojnë me nivelin e zhvillimit dhe nivelin arsimor të fëmijës. Në **Irlandë**, *Akti i Fëmijëve* parashikon se një fëmije i duhet dhënë informacioni që i takon në lidhje me konsultimin me një asistues dhe po ashtu se si kjo e drejtë do të përfitohet, në një mënyrë dhe një gjuhë të përshtatshme me moshën dhe nivelin e të kuptuarit të fëmijës.

Në **Shqipëri**, në fillim të intervistës me oficerin e policisë gjyqësore, fëmijës i ofrohet deklarata e të drejtave. Sidoqoftë, vetëm një lloj deklarate ekziston si për të rriturit, ashtu edhe për të miturit, gjë që do të thotë se nuk është e shkruar në një gjuhë të përshtatshme për fëmijët. Prandaj, nuk është e sigurtë nëse fëmija gjithmonë i kupton siç duhet të drejtat e tij/saj. E njëjta gjë mund të thuhet për **Lituaninë**.

Përkthimi dhe interpretimi, nga ana tjetër, nuk duket të jetë një problem. Si për të rriturit, ashtu edhe për fëmijët që nuk e kuptojnë gjuhën e procedurës, të gjitha ligjet kombëtare të vendeve të studjuara parashikojnë se personat në konflikt me ligjin duhet të informohen për të drejtat e tyre në një gjuhë që ata e kuptojnë.

Në **Spanjë**, çdo person i privuar nga liria ose i dënuar duhet të informohet në një gjuhë që ai/ajo e kupton, mbi të drejtat që ai/ajo gëzon.⁶³ Në veçanti, në rastin e shtetasve të huaj që nuk flasin spanjisht, ose në rastin e personave me dëgjim të dëmtuar apo shurdhëri, po ashtu për personat me vështirësi të gjuhës, ata gëzojnë të drejtën për tu asistuar nga një përkthyes falas. Në **Lituani**, të gjitha dokumentat që sipas Kodit të Procedurës Penale, duhet t’ i jepen të dyshuarit, duhet të përkthehen⁶⁴.

Në **Gjermani**, nuk ka detyrim specifik për të ofruar informacionin në “gjuhën e nënës” së fëmijës, por personi i akuzuar dhe/ose arrestuar duhet të udhëzohet për të drejtat e tij/saj në një gjuhë që ai e kupton. Në **Francë**, Kodi i Procedurës Penale, parashikon se nëse një person

⁶² (Gjermani) Seksioni 70b JGG.

⁶³ (Spain) Neni 520.2 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁴ (Lituania) Neni 8(5) i Kodit të Procedurës Penale.

nuk e kupton frengjishten, ai/ajo duhet të njoftohet për të drejtat e tij/saj nga një përkthyes, nëse është e nevojshme, pasi një format i është dhënë atij/asaj për informacion imediat⁶⁵.

5.3 Zgjedhja dhe ndryshimi i avokatit

Zgjedhja e lirë e avokatit është një parim shumë i rëndësishëm; është një pjesë e të drejtave të mbrojtjes, dhe prandaj duhet që në masën e mundshme të garantohet në kuadrin e ndihmës ligjore. Në rastin e fëmijëve, ky parim gjithashtu ndihmon në krijimin e një marrëdhënieje të bazuar mbi besimin me avokatin. Për këtë arsye, zgjedhja e avokatit dhe mundësia e ndryshimit të avokatit janë dy pyetje që meritojnë një vëmendje të veçantë.

Duhet vënë në dukje gjithashtu se në përputhje me Kazuset Ligjore të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të jetë subjekt i përjashtimeve.

Pavarësisht rëndësisë së marrëdhënies së besimit midis avokatit dhe klientit, e drejta për tu mbrojtur nga një këshillues "me zgjedhjen e personit" është patjetër subjekt i disa kufizimeve që lidhen me ndihmën ligjore falas. Për shembull, kur cakton një avokat Gjykata duhet të marrë në konsideratë dëshirat e të akuzuarit, por këto mund të anashkalohen kur ka baza të rëndësishme e të mjaftueshme për të mbështetur se kjo është diçka e nevojshme në interesat e drejtësisë. (*Croissant v. Germany (1992)*; *Lagerblom v. Sæden (2003)*). Po ashtu, neni 6 § 3 (c) nuk mund të interpretohet si sigures i të drejtës për të zëvendësuar ndihmën ligjore nga shteti (*Lagerblom v. Sæden (2003)*).

Parimi i zgjedhjes së lirisë së avokatit për fëmijët në konflikt me ligjin që përfitojnë nga ndihma ligjore

Zgjedhja e avokatit përmendet në nenin 14§3 të Paktit **Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike**, i cili i referohet të drejtës së çdokujt të akuzuar për një krim të ketë asistencën e një avokati, të cilin e zgjedh vetë.

Udhëzuesi i KB i vitit 2012 mbi Ndihmën Ligjore parashikon se njerëzit duhet të përfaqësohen nga "një avokat i zgjedhur, kurdo që është e përshtatshme, ose nga një avokat kompetent i caktuar nga gjykata apo çdo autoritet tjetër i ndihmës ligjore me asnjë kosto kur personi nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar dhe/ose kur interesat e drejtësisë e kërkojnë kështu" (Udhëzimi 5).

Udhëzuesi i Këshillit të Europës mbi Drejtësinë Miqësore për Fëmijët specifikon se "një sistem avokatësh të specializuar rekomandohet teksa respektojmë të drejtën e fëmijës për zgjedhur lirisht një avokat." (parag. 104).

⁶⁵ (France) Neni 63-1 i Kodit të Procedurës Penale.

Në vendet pjesëmarrëse në këtë kërkim, ne kemi vëzhguar standarde të ndryshme që lidhen me zgjedhjen e avokatit në kuadrin e ndihmës juridike për fëmijët në konflikt me ligjin.

Në disa vende, zgjedhja e lirë e avokatit garantohet nga ligji edhe nën kuadrin e ndihmës juridike. Në ato vende, është e mundur të zgjedhësh lirisht një avokat, i cili do të jetë i caktuar për të ndërhyrë në kuadrin e ndihmës juridike (prandaj, duhet të jetë një avokat që bie dakort të asistojë si ofruer i shërbimit ligjor). Të paktën ky është rasti në vendet: **Finlandë, Francë, Gjermani, Itali, Lituani, Suedi, Shqipëri dhe Belgjikë.**

Në **Itali**, për shembull, fëmijët në konflikt me ligjin mund të zgjedhin një avokat nga lista e avokatëve që kanë rënë dakort të ofrojnë ndihmë juridike.

Në **Lituani**, legjislacioni parashikon se *Shërbimi i Ndhmës Juridike i Garantuar nga Shteti* është shërbimi përgjegjës për caktimin e avokatëve të garantuar nga shteti. Megjithatë, klienti i ndihmës juridike ka mundësinë të zgjedhë një avokat. Siç na treguan intervistat me profesionistë, në shumicën e rasteve avokatët zgjidhen në mënyrë rastësore, në varësi të disponibilitetit dhe aksesit të tyre. Gjithsesi, ka po ashtu situata kur personi zgjedh një avokat të veçantë, pasi hetuesi në fazën e hetimeve i ofron mundësinë e zgjedhjes një avokat nga lista. Në këto rrethana, avokati specifik i preferuar përmendet në aplikimin e kërkesës për këtë shërbim.

Në vende të tjera, zgjedhja e lirë e një avokati brenda kuadrit të ndihmës juridike nuk garantohet nga ligji, por lejohet në praktikë.

Në **Irlandë**, për shembull, nuk ka një të drejtë absolute për një person të akuzuar që të zgjedhë një avokat të caktuar. Nëse një personi i jepet ndihma juridike, gjyqtari cakton një mbrojtës për rastin nga lista e ndihmës juridike. Nëse personi i akuzuar shpreh një dëshirë për tu përfaqësuar nga një mbrojtës i veçantë nga kjo listë, gjyqtari cakton pikërisht atë avokat në varësi edhe të disponibilitetit. Edhe pse nuk ka një të drejtë absolute për të zgjedhur një avokat të caktuar, Gjykatat shumë rrallë refuzojnë të zgjedhin atë mbrojtës që kërkon i akuzuari. Megjithatë, avokati i dëshiruar duhet të jetë në këtë listë dhe duhet të jetë i disponueshëm.

Roli i prindërve ose kujdestarëve kur zgjedhim një avokat

Edhe nëse një fëmijë në konflikt me ligjin mund të zgjedhë avokatin e tij, prindërit ose kujdestarët ligjorë mund të jenë një ndihmë e konsiderueshme në këtë drejtim. Në të gjitha procedurat penale, prindërit mund të luajnë një rol të rëndësishëm duke ndihmuar fëmijët e ture, duke përfshirë edhe në të kuptuarin e të drejtave dhe procesit në vetvete. Sidoqoftë, edhe nëse prindërit zgjedhin një avokat për fëmijën, avokati duhet të jetë i vetëdijshëm që ai përfaqëson fëmijën dhe jo prindërit.

Udhëzuesi i UNICEF për ndihmën juridike për fëmijët pohon se “profesionistët duhet të jenë të vetëdijshëm për dinamikat e pushtetit në marrëdhëniet midis të rriturve dhe fëmijëve, dhe të jenë vigjilentë ndaj mundësisë që një fëmijë mund të manipulohet apo intimidohet. Është e rëndësishme që interesat e tjerëve si prindërit, apo vëllezër e motra, që mund të kenë më shumë zë dhe artikulum, të mos konfliktohen apo të mos marrin prioritet mbi interesat e fëmijës klient. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në situatat kur prindërit paguajnë tarifë për profesionistët ligjore dhe mund të supozojnë se interesat e tyre mbizotërojnë ndaj atyre të fëmijës klient. ” (Udhëzimi 8).

Udhëzuesi po ashtu pretendon se *“ është gjithashtu e rëndësishme që tarifat ligjore të avokatit të fëmijës të mos i ngarkohen prindërve të tij, as direkt e as indirekt. Nëse një avokat paguhet nga prindërit, në raste të veçanta me konflikte interesi, nuk ka garanci se ai/ajo do të jetë i aftë të mbrojë në mënyrë të pavarur pikëpamjet e fëmijës.”* Në këtë kuptim, aksesit tek një avokat pa kosto në kuadrin e Ndihmës Juridike duhet të përgjithësohet për fëmijët, dhe teksa roli i prindit është i rëndësishëm, ai nuk duhet të ndikojë të drejtën e fëmijës për tu përfaqësuar.

Tendenca të ndryshme në këtë aspekt mund të vëzhgohen përmes Europës. Në disa vende, roli i prindit në zgjedhjen e avokatit është më i fortë, ndërsa në të tjera është më i dobët.

Në **Finlandë**, për shembull, zakonisht vendimi lidhur me zgjedhjen e lirë të një avokati bëhet së bashku nga prindërit dhe fëmija. Dëshirat e fëmijës merren në konsideratë bazuar në pjekurinë e fëmijës dhe moshën (*psh. më shumë rëndësi i jepet dëshirës së fëmijës që është 17 vjeç sesa një fëmijë që është 12 vjeç.*) Nëse fëmija nuk ka prindër, kujdestari ligjor i fëmijës është në të njëjtin pozicion siç do të ishin prindërit psh. Vendimi merret nga kujdestari ligjor së bashku me fëmijën.

Në **Shqipëri**, prindërit, kujdestarët ligjorë dhe përfaqësuesit procedural kanë të drejtën për të zgjedhur apo përcaktuar avokatin mbrojtës⁶⁶ për fëmijët në konflikt me ligjin. Ky rregull ligjor kërkon që detyra e avokatit mbrojtës për të përfaqësuar opinionin e fëmijës (si një klient) duhet të përcaktohet qartësisht.

Në disa nga vendet e studjuara, prindërit apo përfaqësuesit ligjor nuk kanë rol ligjor në zgjedhjen e avokatit. Sidoqoftë, në praktikë zgjedhja ende bëhet në disa raste nga prindërit.

Në Belgjikë, të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin iu caktohet një avokat në kontekstin e ndihmës juridike dhe kanë mundësinë e zgjedhjes së tij/saj. Prindërit nuk kanë rol ligjor në këtë zgjedhje. Kodi i Etikës së Dhomave të Avokatisë në shtetet anglishtfolëse dhe frengjishtfolëse kanë përcaktuar se avokati zgjidhet lirisht nga fëmija, vendimi i të cilit nuk është subjekt i autorizimit nga përfaqësuesi i tij/saj ligjor⁶⁷. Në praktikë, disa prindër zgjedhin një avokat për fëmijën e tyre në konflikt me ligjin (por jo në shumicën e rasteve). Për më tepër, prindërve iu është kërkuar

⁶⁶ (Shqipëria) Neni 48 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁶⁷ (Belgjika) Neni 2.21 i Kodit të Etikës së Dhomave të Avokatisë në vendet anglishtfolëse dhe frengjishtfolëse.

të paguajnë një avokat. Avokatët për fëmijët në konflikt me ligjin janë kryesisht të paguar përmes një skeme të ndihmës juridike.

Mundësia e ndryshimit të avokatit

Zgjedhja e lirë e avokatit është po ashtu e lidhur me mundësinë e ndryshimit të avokatit. Siç u përmend më sipër, KEDNJ bën të qartë se kjo nuk është një e drejtë absolute.

Udhëzuesi i UNICEF për ndihmën ligjore për fëmijët artikulon se *"nëse marrëdhëniet me fëmijën bëhet disfunktionale dhe ai/ajo kërkon të ndryshojë avokat, atëherë resepktohet e drejta e fëmijës për të zgjedhur një avokat teksa i shpjegojmë çdo vështirësi që mund të lindë"* (Udhëzimi 4)

Në të gjitha vendet që morën pjesë në kërkim, është gjithmonë e mundur të refuzohet një avokat që punon brenda kuadrit të ndihmës juridike dhe të punësohet një avokat jashtë kësaj skeme. Një detyrë akoma më sfiduese është zëvendësimi i një avokati për ndihmën juridike me një tjetër avokat.

Në shumicën e vendeve të marra në analizë, ka dy situata kryesore në të cilat është e mundur të ndryshohet një avokat me kërkesën e fëmijës:

- Nëse ka një "thyerje besimi" ose "mosmarrëveshje" midis fëmijës dhe avokatit të tij/saj.
- Në rastin e largimit të avokatit.

Për shembull, në **Belgjikë**, një i ri që merr ndihmë juridike mund të kërkojë ndryshimin e një avokati në rast të thyerjes së besimit ose arsye të tjera serjoze që e vënë në diskutim avokatin e tij/saj. Kërkesa për të ndryshuar një avokat mund të adresohet tek drejtuesi i Zyrës së Ndhmës Juridike që ka caktuar avokatin e parë. Avokati vetëm pushohet nga çështja dhe një avokat i ri mund të caktohet vetëm pasi Drejtuesi i Zyrës për Ndhmë Juridike ka dhënë një përgjigje pozitive. Sidoqoftë, kërkimi i zhvilluar si pjesë e projektit "Avokati im, Të drejtat e mia" ka theksuar faktin se *ndërsa procesi i ndryshimit të avokatëve nuk është në vetvete i komplikuar, ende është e vështirë për të miturit ta iniciojnë këtë proces*. Në fakt, fëmijët zakonisht nuk dinë kë të thërrasin apo cilën procedurë të ndjekin.

Interpretimi i asaj se çfarë është "thyerja e besimit", "mosmarrëveshja" apo mospërmbushja e detyrimit që vjen nga ligji nga ana avokatit" varjon. Hapësira e vlerësimit është mjaft e gjerë në këtë drejtim. Në Hungari, mundësia e ndryshimit të një avokati duket shumë e kufizuar, sepse edhe cilësia e dobët e ndihmës juridike nuk është gjithmonë një arsye që justifikon këtë ndryshim. Të tjera vende, nga ana tjetër, ndjekin një qasje më tolerante.

Autoritetet e ngarkuara për të vlerësuar kërkesat për ndryshim të avokatit që ofron ndihmë ligjore mund të jenë:

- Dhomat e Avokatisë (psh., **Austria, Spanja, Franca**)
- Gjykatat (psh., **Finlanda, Irlanda, Polonia, Suedia**)
- Autoritetet e ndihmës juridike (psh. **Lituania, Spanja**).

Këto autoritete kanë nivele të ndryshme kontrolli dhe autoriteti për ndryshimin. Në disa vende, fëmija vetëm duhet të njoftojë se ai/ajo do të ndryshojë avokatin (**Republika Çeke**). Në disa vende, një kërkesë që duhet të plotësojë një formë standard duhet dorëzuar (në shumicën e vendeve), në të tjera një fëmijë duhet të provojë se ai/ajo u keqpërfaqësua. (**Austria**).

Kështu, mund të konkludojmë se pengesa të ndryshme për ndryshimin e avokatit janë identifikuar. Së pari, pasi fëmija ka dorëzuar kërkesën, është në varësi të autoritetit të ngarkuar me këtë detyrë të aprovojë ose të refuzojë ndryshimin e avokatit. Kriteret që lejojnë ndryshimin e avokatit janë të vagëta dhe mund të kenë interpretime të ndryshme, që krijon një hapësirë të madhe për vlerësim nga autoriteti përgjegjës. Së fundi, një fëmijë mund të mos jetë tërësisht i vetëdijshëm për mundësinë apo të drejtën për të ndryshuar avokatin dhe procedurën për një ndryshim të tillë.

5.4 Përkthimi në ndërveprimin fëmijë-avokat

Një çështje më shumë që nevojitet të merret në konsideratë është shërbimi i përkthyesit që do të asistojë një fëmijë kur ai nuk flet gjuhën lokale.

Direktiva mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit (2010/64/BE) parashikon se kurdo që është e nevojshme për qëllimin e ruajtjes së drejtësisë së procesit, përkthimi duhet të jetë i aksesueshëm për komunikimin midis një personi të akuzuar apo dyshuar dhe avokatit të tij në lidhje të drejtpërdrejtë, në çdo marrje në pyetje ose seancës dëgjimore gjatë procedimit ose gjatë apelimit apo gjatë zbatimit të çdo procedure tjetër. (Neni 2(2)). Neni 4 shton se ky përkthim duhet të jetë falas.

Ky rregull i direktivës është zbatuar në ligjet kombëtare të shteteve anëtare të Bashkimit European.

Në **Lituania**, në përputhje me nenin 8(4) të Kodit të Procedurës Penale, gjatë procedimit penal, mbrojtësi duhet të komunikojë me një të akuzuar, dyshuar, të dënuar apo të pafajshëm që nuk e flet gjuhën lituaneze në një gjuhë që ai e kupton, dhe nëse kjo nuk është e mundur, interpretimi i komunikimit të tyre duhet ofruar. Në mënyrë që të sigurohet konfidencialiteti i interpretimit, Kodi i Procedurës Penale ndalon pyetjen e përkthyesit si dëshmitar rreth rrethanave që ai/ajo ka mësuar teksa përkthente midis një të dyshuari dhe avokatit të tij/saj.

Megjithatë, siç kanë treguar intervistat me avokatë dhe hetues, në praktikë mundësia e të kërkuarit të një interpretimit nuk përdoret shpesh në komunikimin me një klient.⁶⁸

Në **Francë**, në marrëdhënie me të drejtën për të patur një përkthyes, Kodi i Procedurës Penale parashikon se nëse personi i dyshuar apo i akuzuar nuk kupton frengjisht, ai/ajo ka të drejtën të asistohet nga një përkthyes gjatë seancave ose për përkthimin e dokumentave të rëndësishëm për mbrojtjen ligjore deri në fund të procedimeve, përveç se në rastet kur ai/ajo shprehet dhe me vetëdije heq dorë nga kjo e drejtë. Nëse ky shërbim ofrohet në kuadrin e ndihmës juridike, ai është falas. Në **Gjermani**, përfshirja e një përkthyesi falas parashikohet për bashkëbisedime të lidhura me procesin, si intervista me mbrojtjen ose nëse i akuzuari nuk kupton gjuhën që përdoret në gjykatë.⁶⁹

Në mënyrë të ngjashme, shërbimi i përkthimit falas, përgjatë procedimeve ligjore është i aksesueshëm në Hungari, **Austri, Republikën Çeke, Finlandë** dhe vende të tjera.

⁶⁸ Instituti i Monitorimit të të Drejtave të Njeriut. "Inside Police Custody 2. Suspects' Procedural Rights in Lithuania" . Raport kërkimor, 2018. Gjetet në : http://hrmi.lt/wp-content/uploads/2019/03/National_report_Lithuania_2018.pdf

⁶⁹ (Gjermani) Seksioni 187 paragrafi i 1 Aktit të Gjykatës Kushtetuese.

MBROJTJA E INTERESAVE TË FËMIJËS NË KONFLIKT ME LIGJIN

Direktiva 2013/48/BE mbi të drejtën e aksesit për avokat

Neni 13. Personat vulnerabël

Shtetet anëtare duhet të sigurohen se nevojat e veçanta të të dyshuarve apo të akuzuarve vulnerabël merren në konsideratë në aplikimin e kësaj Direktive.

Direktiva (BE) 2016/800 mbi masat procedural për fëmijët në procedimet penale në seksionin 8 parashikon se shtetet anëtare duhet të sigurohen se interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë gjithmonë konsiderata primare, në përputhje me nenin 24(2) të Kartës Themelore të të Drejtave të Bashkimit Europian (karta). Neni 6. (Asistenca nga një avokat) i referohet gjithashtu interesave më të mirë të fëmijës. Direktiva parashikon të drejtën e fëmijës për të informuar personin që ka përgjegjësinë prindërore. (Neni 5), të drejtën për vlerësim individual (Neni 7) dhe për ekzaminime mjekësore (Neni 8). Kjo gjithashtu parashikon mekanizma të tjerë të hartuar për të mbrojtur intereset e fëmijës në konflikt me ligjin.

Parime dhe Udhëzimet e KB 2012

Udhëzimi 10. Masa të veçanta për fëmijët

Shtetet duhet të sigurojnë masa të veçanta për fëmijët për të promovuar aksesin efektiv të fëmijëve në drejtësi dhe për të parandaluar stigmatizimin dhe efektet e tjera të pafavorshme si rezultat i përfshirjes së tyre në sistemin e drejtësisë penale, duke përfshirë:

- a) Sigurimi i të drejtës së fëmijës për të pasur një këshilltar të caktuar për të përfaqësuar fëmijën në emrin e tij/ saj në procedurat kur ekziston ose mund të ketë konflikt interesi midis fëmijës dhe prindërve të tij/saj ose palëve të tjera të përfshira;
- b) T 'i mundësojnë fëmijëve që janë ndaluar, arrestuar, dyshuar ose akuzuar për një veprë penale të kontaktojnë menjëherë prindërit ose kujdestarët e tyre dhe të ndalojnë çdo intervistë të një fëmije në mungesë të avokatit të tij ose të një ofruesi tjetër të ndihmës juridike dhe prindit ose kujdestari kur është i disponueshëm, në interesin më të lartë të fëmijës;
- c) (c) Sigurimi i të drejtës së fëmijës për të përcaktuar çështjen në prani të prindërve ose kujdestarit ligjor të fëmijës, përveç nëse nuk konsiderohet se është në interesin më të mirë të fëmijës
- d) Të sigurojnë që fëmijët mund të konsultohen lirisht dhe në konfidencialitet të plotë me prindërit dhe /ose kujdestarët ligjor dhe përfaqësuesit ligjorë;
- e) Të ofrojnë informacion mbi të drejtat ligjore në një mënyrë të përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e fëmijës, në një gjuhë që fëmija mund ta kuptojë dhe në një mënyrë që është e ndjeshme ndaj gjinisë dhe kulturës. Sigurimi i informacionit për prindërit, kujdestarët ose kujdestarët duhet të jetë shtesë dhe jo një alternativë e komunikimit të informacionit tek fëmija;

- f) Promovimi, kur është i përshtatshëm, i shmangies nga sistemi zyrtar i drejtësisë penale dhe sigurimi që fëmijët të kenë të drejtën e ndihmës juridike në çdo fazë të procesit ku zbatohet shmangia;
- g) Inkurajimi, kur është e përshtatshme, i përdorimit të masave alternative dhe sanksioneve për heqjen e lirisë dhe të sigurohen që fëmijët të kenë të drejtën e ndihmës juridike në mënyrë që heqja e lirisë të jetë një masë e fundit dhe për një periudhë sa më të shkurtër kohe;
- h) Vendosja e masave që sigurojnë se procedurat gjyqësore dhe administrative zhvillohen në një atmosferë dhe një mënyrë që lejojnë fëmijët të dëgjohen drejtpërdrejt ose përmes një përfaqësuesi ose një organi të duhur në një mënyrë në përputhje me rregullat procedurale të ligjit kombëtar. Marrja parasysh e moshës dhe pjekurisë së fëmijës mund të kërkojë gjithashtu procedura dhe praktika të modifikuara gjyqësore dhe administrative.

Privatësia dhe të dhënat personale të një fëmije, i cili është ose ka qenë i përfshirë në procedura gjyqësore ose jo-gjyqësore dhe ndërhyrje të tjera duhet të mbrohen në të gjitha fazat, dhe një mbrojtje e tillë duhet të garantohet me ligj. Kjo zakonisht nënkupton që asnjë informacion ose të dhënë personale nuk mund të vihet në dispozicion ose të botohet, veçanërisht në media, që mund të zbulojë ose indirekt mundësojë zbulimin e identitetit të fëmijës, duke përfshirë imazhet e fëmijës, përshkrime të hollësishme të fëmijës ose familjes së fëmijës, emrat ose adresat e anëtarëve të familjes së fëmijës dhe regjistrimet audio dhe video

6.1 Mbrojtja e interesave të fëmijës në rastet e konfliktit të interesit

Konflikti i interesit lind kurdo që përfaqësimi i një klienti mundet të kufizohet ose për shkak të detyrave të avokatit ndaj një tjetër klienti ose nga një palë e tretë ose nga interesat e avokatit në fjalë. Analiza e konfliktit është e vështirë kur klienti është i rritur dhe bëhet edhe më e komplikuar kur klienti është një fëmijë. Megjithatë, kur trajtojnë një çështje kaq sfiduese, profesionistët ligjorë duhet të ndjekin parimin bazë të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës.

Sa i përket prindërve dhe kujdestarëve, ndonëse ata supozohen të veprojnë në interesat e fëmijës dhe të përfaqësojnë siç duhet interesin e fëmijës, në raste të caktuara një konflikt mund të lindë. Një shembull i një rasti të tillë mund të jetë një situatë ku fëmija akuzohet për një vepër penale dhe prindi/kujdestari është viktimë ose ka lidhje të ngushtë me viktimën.

Në shumicën e vendeve europiane, ligji parashikon se një konflikt interesi midis fëmijës dhe avokatit të tij/saj, si dhe midis fëmijës dhe prindërve/kujdestarëve duhet shmangur dhe po ashtu janë parashikuar masa për të trajtuar konflikte të tilla.

Ligji në **Belgjikë** duket se fokusohet në parandalimin e ndonjë konflikti potencial midis fëmijës dhe kujdestarëve ligjore. Në mënyrë që të shmangët një konflikt i tillë, ligji ndalon që i njëjti avokat të përfaqësojë të dy palët në një proces ligjor.⁷⁰ Sa i përket konfliktit të interesit midis fëmijës dhe mbrojtësit të tij/të saj, ligji detyron avokatin të eksplorojë dhe të shmangë ndonjë arsye potenciale që do të çonte në një konflikt të tillë. Avokati duhet të dorëhiqet nga rasti nëse një konflikt lind.⁷¹

Në **Lituani**, çështja e konfliktit të interesit midis fëmijës dhe prindërve adresohet nga Kodi i Procedurës Penale.⁷² Kodi parashikon se përfaqësuesi ligjor mund të marrë pjesë në procedime dhe të mbrojë interesat e fëmijës përveç rastit kur kjo është në kundërshtim me interesat e fëmijës. Sa i përket konfliktit të interesit midis fëmijës dhe avokatit, Kodi Lituanes i Etikës për Avokatët⁷³ kërkon që një avokat duhet të refuzojë një klient kur përmbushja e detyrës rezulton në një konflikt interesi.

Në legjislacionin **Shqiptar**, avokatët janë të detyruar të sigurojnë mbrojtje transparente dhe përfaqësim në interesin më të lartë të fëmijës duke parandaluar çdo konflikt interesi.⁷⁴ Për më tepër, në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur⁷⁵, gjyqtari gjatë gjykimit dhe prokurori gjatë fazës së hetimeve, mund të ndalojnë përfaqësuesin ligjor të një fëmije në konflikt me ligjin, nga ndjekja e veprimeve të mëtejshme procedurale nëse kjo është në interesin më të lartë të fëmijës.

Në **Finlandë**, konflikti i interesit është një maksimum ligjore, e njohur nga sistemi ligjor finlandez dhe e vendosur mbi bazën rast pas rasti. Të drejtat dhe interesi i fëmijës mbizotërojnë mbi ato që janë në konflikt me to. Kur ka një konflikt interesi midis fëmijës dhe prindit, fëmijës i caktohet një përfaqësues që merr detyrën për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës gjatë procedimeve ligjore.

Në **Francë**, një konflikt interesi midis fëmijës dhe prindërve adresohet nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Ky specifikon që fëmija mund të shoqërohet nga përfaqësuesit ligjor në të gjithë seancat. Kur kjo nuk është e mundur ose e dëshirueshme, një tjetër i rritur mund të caktohet. Kur i rrituri i caktuar nuk është i pranueshëm për autoritetin kompetent, prokurori, gjyqtari për të mitur, duhet të caktojë një tjetër person i cili gjithashtu mund të jetë përfaqësues i një autoriteti ose institucioni në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Më tej, Kodi specifikon se kur nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, ai/ajo mund të mos shoqërohet nga prindërit.

⁷⁰ (Belgjika) Avocat.be (Urdhri i dhomave të avokatisë për anglisht dhe frengjisht folësit), Kodi Deontologjik, Neni. 2.22.

⁷¹ (Belgjika) Neni 5.41 dhe neni. 5.46 i Kodit Deontologjik.

⁷² (Lituania) Neni 53 i Kodit të Procedurës Penale.

⁷³ Gjetet në: <http://www.advokatura.lt/en/about-the-bar/code-of-ethics-ksah.html>

⁷⁴ (Shqipëria) Neni 8 (ç) – Ligji nr. 55/2018 Mbi Profesionin e Avokatëve në Republikën e Shqipërisë.

⁷⁵ (Shqipëria) Neni 49 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Në **Hungari**, nëse prindi është përfshirë si një palë tjetër në një çështje, roli i prindit (psh. të qenit përfaqësues ligjor i fëmijës) zëvendësohet nga një kujdestar i caktuar.

Në **Poloni**, nëse ka patur një konflikt midis një fëmije dhe prindit, asistenca ligjore në procedimet e drejtësisë për të mitur është e detyrueshme. Në rastin e një konflikti të interesit midis fëmijës dhe avokatit të tij, fëmija mund të kërkojë që avokati mund të zëvendësohet.

Në **Spanjë**, ligji po ashtu shfaqet të jetë qartësisht mbështetës të interesit më të lartë të fëmijës kur një konflikt interesi lind midis fëmijës dhe prindërve. Në çdo procedim gjyqësor ku ka një konflikt midis interesave të fëmijës dhe çdo interesi tjetër të legjitimuar të një pale të tretë, në të gjitha rastet do të mbizotërojnë interesat e fëmijës.

Në mënyrë të ngjashme, sipas Kodit të Procedurës Penale, në rastin e një konflikti interesi me prindërit, ose të atyre që de facto kanë kujdestarinë e fëmijës, një avokat mbrojtës duhet të caktohet.

Gjermania shfaqet të ketë një qasje paksa më të ndryshme ndaj kësaj çështjeje. Kur ka një konflikt interesi midis një fëmije dhe prindit, këndvështrimi mbizotërues është se të drejtat e fëmijës e ato të prindërve duhet të jenë në balancë, duke marrë parasysh gjithashtu moshën dhe fazën zhvillimore të fëmijës.

Megjithatë, gjyqtari mund të përjashtojë prindin/kujdestarin e akuzuar nga seanca nëse është e nevojshme. Gjithashtu, të drejtat procedurale të prindërve mund të hiqen nga Gjykata nëse ata akuzohen për sjellje të papërshtatshme. Në një rast të tillë, Gjykata cakton një kujdestar për të asistuar fëmijën në procedim. Po ashtu kur ka një konflikt midis fëmijës dhe mbrojtësit ose kur marrëdhënia dëmtohet, avokati duhet të dorëhiqet nga çështja. Nëse ai/ajo nuk dorëhiqet, një tjetër avokat caktohet nga Gjykata.

6.2 Ofrimi i asistencës psikologjike dhe përfshirja e institucioneve të mbrojtjes së fëmijës në procedimin penal

Parimet dhe Udhëzimet e KB 2012

Parimi 11. Ndhima ligjore në interesin më të lartë të fëmijës

58. Shtetet duhet të marrin masat e duhura për të krijuar sisteme të ndihmës juridike miqësore dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve, duke marrë parasysh kapacitetet evoluese të fëmijëve dhe nevojën për të vendosur një ekuilibër të duhur midis interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës së fëmijës për t'u dëgjuar në procedurat gjyqësore përfshirë:

(e) Vendosja e mekanizmave dhe procedurave për të siguruar bashkëpunim të ngushtë dhe sisteme të përshtatshme referimi midis ofruesve të ndihmës juridike dhe profesionistëve të

ndryshëm për të patur një të kuptuar gjithëpërfshirës të fëmijës, si dhe një vlerësim të situatës dhe nevojave të tij ligjore, psikologjike, sociale, emocionale, fizike dhe njohëse.

Kur një fëmijë përfshihet në një procedurë penale (si i dyshuar, i akuzuar, ose viktimë) në shumicën e shteteve europiane, shtetet aktivizojnë një sistem për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Në shumicën e vendeve që marrin pjesë në këtë kërkim, ndihma psikologjike është ofruar si mbështetje për fëmijën. Për më tepër, institucionet e mbrojtjes së fëmijës ftohen për të marrë pjesë në procedime si një organ që supervizon mbrojtjen e përshtatshme për të drejtat dhe interesat e fëmijëve.

Në **Belgjikë**, institucioni i përfshirë në procedimet penale kur një fëmijë është i dyshuar ose viktimë i një akti penal si Shërbimi i Mbrojtjes së Fëmijës. Gjatë fazës paraprake, Shërbimi i Mbrojtjes së Fëmijës heton situatën sociale të fëmijës, ndërsa gjatë fazës së gjyqimit ai i ofron gjyqtarit një vlerësim psiko-social për ta asistuar atë kur merren në konsideratë urdhrat referues. Në përfundim, pas dhënies së vendimit të Gjykatës, Drejtori i Shërbimit Social udhëzon fëmijën dhe/ose prindërit duke i shpjeguar masën e dhënë ndaj tij/saj. Drejtuesi përcakton kushtet dhe termat e masës së dhënë dhe duhet të ofrojë me shkrim arsyetimin për vendimet, të cilat mund të rishikohen në çdo kohë në interesin më të lartë të fëmijës. Kur drejtori është i bindur se nuk ka rreziqe të mëtejshme për fëmijën dhe masa e dhënë nga Gjykata nuk është më e nevojshme, atëherë ai propozon përfundimin e kësaj mase.

Sa i përket përfshirjes së ekspertëve të shëndetit mendor, gjyqtari mund të kërkojë përfshirjen e një eksperti, zakonisht një psikolog. Duhet vënë në dukje se në rastin e "*urdhrave referues*" , *ekspertiza psikologjike duhet kërkuar nga gjyqtari i të miturve*⁷⁶. Psikologët, punonjësit social dhe mjekët mundet gjithashtu të thërriten për të zbatuar masat e dhëna nga gjyqtari i të miturve. Gjyqtari psh. *Urdhëron që fëmija të marrë trajtim në kushte shtëpie ose e vendos atë në një institucion për rehabilitimin nga droga.*

Në **Lituani**, kur një fëmijë përfshihet në procedime penale, Agjencia e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës mund të kërkohet për të marrë pjesë në seancën e marrjes në pyetje. Roli i tyre është të sigurohen se të drejtat e fëmijës nuk dhunohen. Shpenzimet për këta specialistë janë mbuluar nga fondet shtetërore. Për më të tepër, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjyq ose me iniciativën e gjykatës, një psikolog mund të ftohet të marrë pjesë në procesin e marrjes në pyetje. Roli i psikologut është të lehtësojë sesionin e marrjes në pyetje me fëmijën.

⁷⁶ Në Belgjikë, kur një fëmijë në konflikt me ligjin ka qenë mbi 16 vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në varësi të kushteve që lidhen me serjozitetin apo numrin e veprave, gjyqtari i të miturve mund të vendosë të heqë dorë nga çështja dhe ta transferojë një gjykatë, e cila do ta trajtojë sipas ligjit penal për të rritur. Kjo praktikë, e cila është në kundërshtim me Koventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës, quhet urdhër referues.

Në **Shqipëri**, prezenca e psikologut për fëmijën është parashikuar si e detyrueshme në çdo fazë të procedimit penal. Roli i tij/saj është të garantojë mbështetjen psikologjike për fëmijën e të vlerësojë thëniet e fëmijës, po ashtu të sigurojë se fëmija është pyetur në mënyrën e duhur.

Një institucion që luan një rol të rëndësishëm gjatë procedimit ligjor të një fëmije në konflikt me ligjin është Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon se NJMF zëvendëson në një masë të caktuar rolin e përfaqësuesit ligjor të fëmijës gjatë procedimit penal. Në këtë persepektivë, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ligji ofron një detyrim pozitiv për organin e prokurorisë që të bashkëpunojë dhe të njoftojë Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës në të gjitha rastet e mëposhtme⁷⁷: *a) përfaqësuesi ligjor nuk mund të gjendet; b) rezulton dukshëm se përfaqësuesi ligjor i të miturit ka abuzuar me të miturin ose në rastin e një krimi në familje; c) ka dyshime lidhur me paanshmërinë e përfaqësuesit ligjor të të miturit për sa i përket natyrës së marrëdhënieve të tij me pjesëtarin e familjes, i cili është dëmtuar; ç) ekziston një nga llojet e konfliktit të interesit.* Po ashtu, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës është e mandatuar të pregatisë një listë me përfaqësues procedural, që luajnë rolin e një kujdestari të besuar për procedurën penale.

Ashtu sikurse në vendet partnere të projektit, një situatë e ngjashme mund të vëzhgohet edhe shtete të tjera Europiane.

Në **Francë**, Mbrojtja Gjyqësore e të Miturve është instituti përgjegjës për të gjitha çështjet që lidhen me drejtësinë për të mitur, duke përfshirë bashkëpunimin ndër-institucional. Ky institucion asiston gjyqtarin e të miturve dhe zbaton vendimet e gjykatës, siguron përkujdesje për fëmijët që i besohen strukturave publike, po ashtu harton standartet e punës brenda sistemit të drejtësisë për të mitur. Sa i përket përfshirjes së ekspertit psikolog në procesin ligjor, ai ose ajo mund të angazhohet ose kur një opinion eksperti kërkohet nga gjykata ose para marrjes së një vendimi lidhur me një masë edukuese ndaj fëmijës.

Në **Poloni**, institucionet e specializuara janë gjithashtu të përfshira në procese ligjore të lidhura me fëmijën. Gjykata familjare mund të thërrasë një institucion social për të marrë pjesë në procedim. Gjithashtu, ekspertët e shëndetit mendor përfshihen gjithashtu gjatë procesit ligjor. Nëse është e nevojshme të marrin një profil gjithëpërfshirës të personalitetit të fëmijës, Gjykata mund të thërrasë një ekspert (psh. një psikolog) për të kryer një vlerësim psikologjik të fëmijës. Mbështetja psikologjike ofrohet gjithashtu gjatë procesit të intervistimit. Tarifa e ekspertit mbulohet nga fondet shtetërore.

Në **Spanjë**, ka disa institucione të specializuara në procedimet penale për fëmijë si: Njësia Policore e Fëmijës, Zyra e Prokurorit të Fëmijëve, Gjykatat për Fëmijë, Ndhima Juridike për Fëmijë, Shërbimet e Punës Sociale për Fëmijës dhe Shërbimi i Provës i Fëmijës. Roli i Zyrës së

⁷⁷ Neni 74 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Prokurorit të Fëmijëve është shumë i rëndësishëm, pasi është i fokusuar në promovimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Ekspertët psikologë duken se janë të përfshirë në të gjitha procedurat ligjore. Kodi i Procedurës Penale specifikon se fëmija ka të drejtë për mbështetje emocionale dhe psikologjike në çdo fazë të procedimit ligjor. Fëmija mund të kërkojë gjithashtu prezencën e prindërve apo ndonjë personi tjetër. Gjithashtu, një Ekip Teknik (*Equipo Técnico*), i cili është i përbërë nga psikologë, punonjës social dhe specialist të edukimit është i përfshirë gjatë gjithë procedimit. Ky ekip asiston Zyrën e Prokurorit dhe Gjykatën për Fëmijë në përgatitjen e vlerësimeve psikologjike. Po ashtu, ekipi përfshihet në fazën pas-dënimit për të siguruar se një masë po zbatohet ose rekomandon se ajo duhet ndryshuar.

Në **Gjermani**, kur një fëmijë përfshihet në një proces penal, institucioni përgjegjës për trajtimin e rastit është Gjykata Asistuese për të Rinjtë (*Jugendgerichtshilfe*). Përfaqësuesit e këtij institucioni zbatojnë procesin e monitorimit, aspektet që lidhen me kujdesin social për fëmijët përgjatë procesit ligjor.

Në **Hungari**, një vlerësim psiko-ligjor realizohet nga një psikolog dhe nëse është e nevojshme të tjerë ekspertë përfshihen në proces. Shpenzimet e përfaqësuesit për të drejtat e fëmijës, kujdestarit apo profesionistëve të tjerë janë gjithmonë të mbuluara nga shteti. Në varësi të ekspertizës që nevojitet në një proces penal ku një fëmijë përfshihet, kur fëmija është midis 12 dhe 14 vjeç, një ekspert caktohet për të analizuar gjendjen e tij/saj mendore nëse ka dyshime për shëndetin mendor të fëmijës. Për këtë qëllim, një opinion i përbashkët i një eksperti psikiatër ligjor dhe eksperti psikolog duhet marrë.

Në **Itali**, sa i përket përfshirjes së ekspertëve të shëndetit mendor në procedime, fëmijët duhet të marrin asistencë psikologjike në çdo fazë të procedimit. Gjyqtari mund t' i kërkojë autoritetit gjyqësor dhe/ose entiteve lokale për asistencën e shërbimeve të veçanta për fëmijët.

Në **Finlandë**, kur një fëmijë përfshihet në procese penale, autoriteti i mirëqënies sociale lokale është i informuar dhe dërgon përfaqësuesin e tij gjatë procesit të intervistimit, përveç rasteve kur në mënyrë të qartë kjo nuk është e nevojshme. Ky shërbim mbulohet financiarisht nga Bashkia.

6.3 Të tjera entitete që ofrojnë mbështetje (juridike) për fëmijët e përfshirë në procedime penale

Përveç sa u tha më lart, mbështetja për fëmijët mund të ofrohet gjithashtu edhe nga entitete të tjera ligjore (shoqata apo organizata). Megjithatë, në këto raste, bëhet fjalë kryesisht për ndihmën juridike parësore dhe lloje të tjera mbështetjeje, por jo për përfaqësimin para Gjykatës.

Këto organizata ofrojnë një mbështetje më të gjerë si mbështetja psikologjike dhe asistencë në riintegrimin e mëvonshëm në shoqëri.

Në **Francë**, në kударin e "ndihmës për aksesin në drejtësi, ka disa iniciativa lokale që lidhen me fëmijët. Për shembull, *l' Antenne des Mineurs mbulon të gjitha çështjet që lidhen me të miturit, pavarësisht nëse ata janë vitkima ose të akuzuar, ose kur ka një konflikt prindëror dhe fëmija dëshiron të dëgjohet nga gjyqtari.*

Në **Gjermani**, shërbimi i asistencës për gjykatën e të rinjve (*Jugendgerichtshilfe*) është një nga shërbimet e përcaktuara në statut për Zyrën e Mirëqënies Sociale dhe të Rinjtë dhe ofrohet nga specialistë të edukimit. Përmes këtij shërbimi, fëmijët marrin këshillim, para, gjatë dhe pas procedimit penal. Ky këshillim nuk varet nga kombësia e fëmijës.⁷⁸ Ekziston po ashtu një OJF *ĔeiBer Ring* që ofron mbështetje për viktimat e krimit jashtë procedimit të Gjykatës.

Në **Austri**, organizata *Die MÖÖe* ofron mbështetje për fëmijët dhe të rinjtë. Qëllimi është të mbështesë viktimat e një krimi gjatë procedimit penal. Ky shërbim përfshin mbështetjen juridike dhe atë psiko-sociale.

Në **Spanjë**, organizata *Save the Children* ka disa programe për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të fëmijëve. Më gjerësisht, misioni i tyre fokusohet në mbrojtjen e fëmijëve ndaj dhunës duke siguruar aksesin në sistemin e drejtësisë, duke garantuar të drejtat e fëmijëve në politikat publike, dhe duke thyer ciklin e varfërisë dhe përjashtimit përmes edukimit. Në mënyrë të ngjashme, Fondacioni *Raíces* fokusohet gjithashtu në mbrojtjen e fëmijëve (si spanjollë dhe të huaj) në risk për përjashtim social, me qëllim garantimin e aksesit të tyre në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave në rastin e konfliktit të interesit që shpesh ekziston midis këtyre fëmijëve dhe kujdestarëve të tyre ligjor.

Në **Poloni**, ka një Avokat Popullit për Fëmijët që mund të marrë pjesë në procedimet e drejtësisë për të mitur. Avokati i Popullit gjithashtu menaxhon linjën telefonike "*Trust Phone*" për fëmijët që janë viktimat e krimit dhe kanë nevojë për ndihmë psikologjike. Qendra e Ndihmës për Fëmijë "*Irena Kornatoëska Help Center for Children*" ofron mbështetje direkte juridike dhe psiko-sociale për fëmijët viktimat e abuzimit. "*We give children strength*" (*"Ne i japim fëmijëve forcë"*) është një organizatë që ofron mbështetje psikologjike për fëmijët që kanë përjetuar dhunë dhe abuzim skesual dhe janë pjesëmarrës si viktimat apo dëshmitarë në procese ligjore.

Në **Lituani**, organizata jo-qeveritare si Karitasi, ofrojnë mbështetje dhe ndihmë juridike për viktimat e krimit. Entitetet joqeveritare të ndihmës ligjore parësore si Klinikat e Ligjit (ndihma ligjore parësore ofrohet nga studentët e ligjit) mund të ofrojnë mbështetje ligjore në formën e

⁷⁸ BeckOK/Gertler/Schwarz, komenti mbi the JGG, seksioni 38 neni 4.

konsultimeve ose përgatitjen e dokumentave ligjore. Në Lituanë, organizata Kryqi i Kuq ofron gjithashtu mbështetje e ndihmë ligjore për fëmijët, sidomos fëmijët e refugjatëve ose migrantëve.

Shqipëria është mjaft mirë e mbështetur në termat e organizatave apo shoqatave që ofrojnë ndihmë juridike për fëmijët. *Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)* është një nga shumë shembujt e organizatave. Misioni i saj është të përmbushë nevojat ligjore dhe sociale të njerëzve në nevojë: edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit në shoqërinë Shqiptare mbi shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut; promovimi i përmirësimeve në legjislativën shqiptare; progresi i komunitetit dhe forcimi i demokracisë në Shqipëri. Shumë organizata të tjera si Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI), Për Ju Nëna dhe Fëmijë, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit për Traumën dhe Torturën (ACRT), Qendra për Iniciativa Ligjore Qytetare duhen përmendur gjithashtu.

VLERËSIMI I NDIHMËS LIGJORE

Instrumentat ndërkombëtar dhe ato të BE përcaktojnë se ndihma ligjore nuk duhet të jetë një asistencë formale por duhet të jetë efektive. Një studim i kryer nga ZKBDK⁷⁹ sygjeroi se që të rritet cilësia e ndihmës ligjore ka nevojë të rritet vëmëndja në sistemet kombëtare: *numri i vëndëve të cilët po aplikojnë masa të avancuara për cilësinë e ndihmës ligjore, po e përmirësojnë atë*. Përvec sistemit tradicional të ankesave, ka një rritje vëmëndje në aplikimin e qasjeve proaktive për garantimin e cilësisë sic janë vendosja e standardeve dhe auditimet nga organet kompetente⁸⁰. Ky studim synoi të zbulojë se në cilën masë, në cilat forma dhe me cilët instrumenta shtete të ndryshme garantojnë cilësinë e ndihmës ligjore.

Parimet dhe Rekomandimet e KB, 2012

Parimi 11. Ndhimë ligjore në interesin më të lartë të fëmijës

58. Shtetet duhet të marrin masat e duhura për të zhvilluar një sistem ndihme ligjore miqësor ndaj fëmijës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tij, duke marrë në konsideratë kapacitetet zhvillimore të fëmijës dhe nevojën për të vendosur një balancë midis interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtën e tij për t' u dëgjuar në një proces ligjor që përfshin:

c) aplikimin e një ndihmë ligjore, standardeve dhe kodeve profesionale të sjelljes që janë miqësore ndaj fëmijës. Profesjonistët ligjorë të cilët punojnë me dhe për fëmijët duhet, kur është e nevojshme, të jenë subjekt i vlerësimit për të garantuar përshtatshmërinë e tyre për të punuar me fëmijët;

e) Krijimin e procedurave dhe mekanizmave për të garantuar një bashkëpunim të ngushtë dhe mekanizmave të duhur referues midis profesjonistëve ligjor dhe ekspertëve të fushave të tjera, për të arritur një të kuptuar gjithpërfshirës të fëmijës, si dhe një vlerësim të nevojave ligjore, psikologjike, sociale, emocionale, fizike dhe kognitive të tij.

Në vëndet Europiane të cilat u përfshinë në studim, për shkak të panvarësisë së profesjonit të avokatit, Dhomat e Avokatisë janë organi kryesor që mbikqyr aktivitetin e avokatëve. Roli i Këshilleve të Ndhimës Ligjore (kur ekzistojnë) duket se është minimal.

Në shumë raste, mekanizmi kryesor për vlerësimin e cilësisë është ai i ankesave që merren nga përfituesit e ndihmës ligjore. Gjithashtu, trajnimi i vazhdueshëm i avokatëve mund të shihet si një masë për të siguruar cilësinë e ndihmës ligjore.

79 Global Study on Legal Aid, UNODC, 2016.:

<https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democratic-governance/access_to_justiceandruleoflaw/global-study-on-legal-aid.html> [žiurëta 2019 m. birželio 10 d.].

80 Nikartas S., Limantė A. Tools and Criteria for Measuring Legal Aid Quality: Guidelines for EU Member States. Vilnius, 2018: <http://teise.org/ep-content/uploads/2019/03/Qualaid-Guidelines-for-EU-Member-States.pdf>

Në **Lituani** mbikqyrja e avokatëve kryen nga Dhoma Lituanëze e Avokatisë dhe Shërbimi Shtetëror i Ndhmës Ligjore, (ShShNL) i cili shqyrton ankesat e marra në lidhje me sjelljen e avokatëve. Dhoma e Avokatisë ka detyrë të mbikqyr avokatët dhe të verifikojë nëse cilësia e shërbimit të ndihmës ligjore detyësore që ata ofrojnë është në përputhje me standardet e aprovuara nga Dhoma.

Pas marrjes së një anekese, në përputhje me marrëveshjen e kryer mbi ndihmën ligjore me avokatët, ShShNL mund të ndërmarrë hapat në vijim: (i) të kërkojë shpjegime mbi rastin dhe të ndryshojë avokatin; (ii) nëse gjykon se anekesa lidhet me cilësinë e shërbimit të ofruar, e dërgon ankesën për shqyrtim në Dhomën e Avokatisë; (iii) të ndërpresë kontratën me avokatin.

Ligji mbi Dhomën e Avokatisë si dhe procedurat e brëndshme ligjore të saj përcaktojnë veprimet që mund të ndërmarrë ajo për të verifikuar cilësinë e punës avokatëve të cilët ofrojnë shërbim ligjor detyësor. Dhoma, është përgjegjëse për të dhënë masa disiplinore nëpërmjet Gjykatës së Nderit të Dhomës. Edhe pse ligji mbi Dhomën e Avokatisë përcakton se rregullat e vlerësimit të cilësisë duhet të aprovohen nga Dhoma, rregullat nuk janë aprovuar akoma.

Në **Shqipëri**, Drejtoria e Ndhmës Ligjore Falas (DNLF) është institucioni përgjegjës për administrimin dhe mbikqyrjen e sistemit të ndihmës ligjore. Puna e saj përqendrohet në (i) zbatimin e sistemit për vlerësimin e cilësisë së ndihmës ligjore; dhe (ii) mbikqyrjen periodike (vjetore) të stadardeve të ndihmës parësore dhe detyësore ligjore të ofruar nga organizatat jofitim prurëse apo avokatët. Qasja e përgjithshme e procesit të vlerësimit të cilësisë, bazohet në analizën nëse procedurat e ndihmës ligjore parësore dhe detyësore funksionojnë sic duhet dhe respektojnë parimet e përgjithshme të aksesit në drejtësi, administrimit dhe planifikimit efektiv, profesionalizmit, cilësisë, eficences dhe efektivitetit.

Në rastin e anekesës ndaj një avokati mbrojtës, kompetencën për vlerësimin e rastit e ka Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DhKA). Organi procedues (prokuroria, gjykata) kanë kompetencën të informojnë komitetin vlerësues të DhKA, kur ka arsye për të marrë masa disiplinore ndaj një avokati kur ai/ajo refuzon të kryej mbrojtjen apo kur shkel parimet e besnikërisë dhe ndershmërisë⁸¹. Gjithashtu, kur një avokat caktohet *ex officio*, DhKA ka të drejtën të marrë masa disiplinore në rastet kur ai/ajo braktis apo refuzon rastin.

Pra është vetëm për këto dy arsye që lidhen me integritetin profesional dhe sjelljen etike, dhe për këtë kategori të avokatëve, që organi disiplinor mund të marrë masa disiplinore. Nisur nga fakti se fëmijët janë një kategori e vecantë e përfituesve të ndihmës ligjore sipas ligjit për ndihmë ligjore dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, ata kanë të drejtën të bëjnë anekesë e cila mund të cojnë në marrjen e masave, kundrejt avokatisë mbrojtës. Gjithsesi, për këtë gjë fëmijët kanë nevojë për ndihmën e prindërve ose kujdestarit ligjor, pasi ata nuk e kanë përgjegjësinë ligjore për të vepruar. Gjithashtu, edhe mbikqyrësit e DNLF të cilët monitorojnë rregullisht avokatët, mund të fillojnë një procedure disiplinore, *ex officio*, ose pasi kanë marrë anekesë ndaj një avokati/e.

81 (Albania) Article 56.1 of the Code of Criminal Procedure.

Në **Belgjikë**, cilësia e ndimës ligjore monitorohet dhe vlerësohet nga Dhoma e Avokatisë.

Rekomandimet mbi ndihmën ligjore parësore dhe dytësore përcaktojnë se kontrolli i cilësisë së shërbimeve kryhet në dy nivele:

- *Ex ante*, lidhet vecanërisht me justifikimin e orientimeve të deklaruara apo angazhimin për të ndjekur një kurs, i cili kushtëzon përfshirjen në listën e avokatëve që ofrojnë ndihmë ligjore⁸²
- *Ex post*, lidhet me cilësinë dhe efektivitetin e shërbimit që mund të shtyjë Dhomën e Avokatisë të vendosë avokatin në listën e kushtëzuar, të pezullojë përfshirjen e personit në list ose ose ta heqë atë nga lista.⁸³.

Për të bërë një ankesë për avokatin, një fëmijët duhet të prezantojë një fletë ankese tek Kryetari i Dhomës së Avokatisë. Ai mund të ndërmarrë një proces hetimi, ose të caktojë dikë tjetër që të dëgjojë edhe fëmijën edhe avokatin. Më pas ai vendos nëse do të cojë avokatin përpara këshillit disiplinor apo të mbyllë çështjen.

Në rastet kur klienti nuk është i kënaqur nga bashkëpunimi me avokatin e tij apo anasjelltas, çështja mund të shqyrtohen edhe nga një sektor i Ombudsman, i cili angazhohet të ndihmojë palët të zgjidhin problemin. Për t' iu drejtuar këtij institucioni personi duhet të plotësohet një pyetësor (online).

Në Itali, në rastin e një ankese nga fëmija apo prindërit e tij ndaj avokatit mbrojtës, është e nevojshme që në fillim të specifikohet natyra e shkeljes. Nëse ajo është (i) civile – në këtë rast klienti mund të kërkojë dëmshpërblim në gjykatën civile, (ii) penale (kur avokati shkel besnikërinë ndaj klientit) – në këtë rast klienti e adreson çështjen në gjykatë penale, ose (iii) disiplinore (kur shkelet procedura e Kodit Deontologjik) – në këtë rast çështja adresohet tek Dhoma e Avokatisë. Fëmija mund t' a bëjë ankesën së bashku me prindërit apo kujdestarët ligjor të tij.

Në Spanjë, një fëmijë mund të bëjë një aknësë ndaj avokatit mbrojtës vetëm nëpërmjet prindërve. Ai e bën ankesën pranë Dhomës së Avokatisë e cila fillon një proces hetimi ndaj avokatit. Nëse shkelja e pretenduar provohet, atëherë avokati zëvendësohet me një tjetër.

Vlen të përmendet se Dhomat e Avokatisë (*Colegios de Abogados*), bën cdo dy vjet një sondazh tek personat të cilët kanë marrë ndihmë ligjore falas për të vlerësuar cilësinë e shërbimit. Cdo Dhomë Avokatie është përgjegjëse për sondazhin e kryer në rajonin të cilën mbulon dhe ka procedurat dhe kriteret e saj të vlerësimit. Gjithsesi, elementë si strategjia e duhur e mbrotjes, vlerësimi i klientit për shërbimin, ofrimi i informacionit të duhur dhe vëmëndja e kushtuar ndaj klientit, janë pjesë e vlerësimit.

Në Finland, në rastet e një sjellje të papërshtatshme, avokatët janë subjekt i masave disiplinore nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Më shumë se gjysma e avokatëve të cilët ofrojnë shërbim

82 (Belgium) Article 508/7 of the Judicial Code.

83 (Belgium) Compendium on second line legal aid, page 70.

ligjor falas janë anëtarë të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Nëse një fëmijë ka ankesa për avokatin, ai mund të dergojë një letër ankese pranë Këshillit Diciplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Në Suedi, nuk ka procedura që vlerësojnë cilësinë e përgjithshme të punës së avokatëve. Në përgjithësi vlerësimi bëhet kur: (i) vlerësohet përshtatshmëria e caktimit të avokatit, (ii) ka një kërkesë për ndryshimin e avokatit, dhe (iii) kur ka një ankese ndaj avokatit.

Bazuar në sa më sipër, mund të arrihet në përfundimin se në pjesën më të madhe të vëndeve Europiane, kontrolli i cilësisë së ndihmës ligjore behet *ex-post* dhe bazohet tek ankesat e klientit. Metoda të tjera, si sondazhi, përdoren në raste të rralla.

KONKLUZIONE: CFARË ËSHTË NDIHMA LIGJORE MIQËSORE PËR FËMIJËT?

Përmbledhja e mësipërme bën një prezantim të praktikave ligjore në vënde të ndryshme Europiane në lidhje me ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin. Të gjithë shtetet e përfshirë në studim udhëhiqen nga parimet e sundimit të ligjit, mbrojtjes së grupeve vulnerabël dhe interesit më të lartë të fëmijës. Edhe pse të gjithë shtetet aderojnë tek instrumentat ndërkombëtar të cilët përcaktojnë të drejtën për ndihmë ligjore, u vërejtën jo pak diferenca midis tyre.

Një parim i përbashkët tek vëndet Europeane është vëmëndja që i kushtohet ndihmës ligjore për fëmijët. Në legjislationin e tyre, shtetet garantojnë ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin. Në pjesë më të madhe të rasteve ajo është e detyrueshme, ofrohet pa kushte dhe që në momentet e para të procedurës ligjore. Shtetet, shpesh kujdesen që avokatët të cilët ofrojnë ndihmë ligjore dytësore për fëmijët të jenë të kualifikuar. Gjithashty, u vu re se ka edhe shërbime të tjera të specializuara për fëmijët. Ky fakt con tek prezumimi se vëndet Europiane udhëhiqen nga parimi se ndihma ligjore për fëmijët duhet të ketë një *qasje miqësore* për ta. Gjithsesi, shtetet duhet të përcaktojnë më mirë konceptin e ndihmës ligjore miqësore për fëmijët, dhe t' a vendosin atë si qëllim parësor.

Përkufizimi i ZKBDK: "Ndhma ligjore miqësore për fëmijët" është ofrimi i ndihmës ligjore të përshtatshme me moshën, multidiciplinare dhe efektive ndaj fëmijës, e cila i përgjigjet nevojave ligjore dhe sociale me të cilat përballet fëmija. Ajo ofrohet nga avokatë apo juristë të cilët janë të trajnuar mbi ligjin për fëmijët, zhvillimin e fëmijës dhe adoleshentëve dhe janë të aftë të komunikojnë në mënyre efektive me fëmijët dhe prindërit e tyre.

Ndhma ligjore e aksesueshme

Studimi gjeti se ndihma ligjore nuk është gjithmonë falas për fëmijët në konflikt me ligjin. Kjo është një pengesë serioze për aksesimin e ndihmës ligjore. Shtetet duhet të sigurojnë ndihmë ligjore falas për fëmijët dhe jo t' a ofrojnë atë mbi bazën e kriterëve të vecanta. Rregulli i përfaqësimit të detyrueshëm është një praktikë e mirë e dila duhet të zbatohet nga të gjitha shtetet.

Gjithashtu, ndihma ligjore duhet t' u sigurohet fëmijëve që në momentet e para të procedurave ligjore. Avokatët dhe juristët e intervistuar pohuan se sa e rëndësishme është që avokati të jetë prezent që në hapat e para të procedurës, pra që në intervistën e parë në komisariatit e policisë. Për më tepër, kur fëmijët janë të privuar nga liria, duhet të kenë mundësi të mbajnë kontakte me avokatin e tyre.

Duhet të theksohet se cuditërisht, të gjitha shtetet të cilat u përfshinë në studim e garantojnë ndihmën ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin, këta të fundit shpesh nuk janë të informuar për këtë të drejtë dhe nuk e dinë qëllimin e saj. Bazuar në intervistat e kryera, mund të pohohet se profesionistët e ligjit besojnë se fëmijët nuk janë të informuar sic duhet mbi të drejtat e tyre procedurale, përfshirë këtu dhe të drejtë për të masur ndihmë ligjore.

Në lidhje me këtë çështje, është e rëndësishme që të krijohen instrumenta të cilët i lejonë fëmijët të informohen mbi ndihmën ligjore. Karta e të drejtave e cila u jepet fëmijëve në konflikt me ligjin në përgjithësi përmban informacion mbi ndihmën ligjore. Gjithsesi, masa të një natyre ligjore, shpesh nuk kuptohen qartë nga fëmijët. Kjo e bën të vështirë për ta që të kuptojnë sic duhet të drejtat e tyre. Shpërndarja e fletushkave dhe aplikimi i instrumentave të tjerë interaktiv pranë komisariteve të policisë mund të jetë efektive në këtë drejtim.

Ndihma ligjore e ofruar nga avokatë të specializuar në fushën e drejtësisë për të mitur

Nga intervistat e kryera në Lituanë, Belgjikë dhe Shqipëri u mësua se të gjithë profesionistët e ligjit janë dakort se shpesh nuk është e mjaftueshme për një avokatë të ketë thjesht njohuri të përgjithshme për ligjin. Ata kanë nevojë të kenë njohuri të thelluar mbi legjislacionin për fëmijët dhe mbi karakteristikat zhvillimore dhe psikologjike të fëmijës. Gjithashtu, është e rëndësishme të jenë të aftë të komunikojnë në mënyrë të përshtatshme me fëmijën, në mënyrë që të kuptojnë sic duhet situatën e tij dhe të përfaqësojnë atë sa më mirë në proces. Është thelbësore për një avokat që punon me një fëmijë të ndërtojë një marrëdhënie besimi me të, të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të tregojë ndjeshmëri ndaj tij.

Në disa shtete, avokatët e ndihmës ligjore falas janë të specializuar mbi këto çështje, madje ka dhe një kategori të "avokatëve për fëmijë". Gjithsesi, në shumë vende "avokatët për fëmijë" janë të trajnuar dhe me eksperience, por në vende të tjera kjo kategori nuk ekziston dhe avokatët caktohen mbi bazën e gadishmërisë së tyre. Në disa raste avokatët caktohen mbi bazën e preferencave të oficerit të policisë apo gjyqtarit. Zakonisht, këta avokatë nuk janë të trajnuar mbi ndihmën ligjore miqësore për fëmijët.

Kjo situatë thekson nevojën për të zhvilluar programe trajnimi mbi drejtësinë për të miturit dhe qasjen miqësore ndaj tyre. Sic është theksuar dhe në Parimet dhe Rregulloret e KB 2012, avokatët të cilët përfaqësojnë fëmijët në proces duhet të trajnohen dhe të kenë njohuri të mira rreth të drejtave të fëmijëve, si dhe të jenë të aftë të komunikojnë me fëmijët në përputhje me nivelin e tyre të kuptimit. Të gjithë ofruesit e ndihmës ligjore që punojnë me fëmijët duhet të marrin trajnime ndër-diciplimore mbi të drejtat dhe nevojat e fëmijëve të moshave të ndryshme dhe procedurat që janë të përshtatshme për ta. Këto trajnime duhet të fokusohen dhe te tiparet psikologjike dhe aspektet zhvillimore të fëmijës si dhe të kenë një vëmendje të vecantë tek vajzat dhe tek pjestarët e grupeve minoritare apo indigjene.

Ndihmë ligjore e përshtatshme me moshën

Ndihma ligjore për fëmijët duhet të marrë parasysh moshën dhe stadin e tyre të zhvillimit. Studimi gjeti se përvec manualeve të hartuara në nivel ndërkombëtar (të cilat jo gjithmonë njihen dhe përdoren nga avokatët), ka pak informacion në nivel kombëtar se si ndihma ligjore për fëmijët duhet të ndryshojë nga ajo për të rriturit. Për rrjedhojë, është me vënd të theksohet se hartimi i sandardeve apo manualeve të cilat përcaktojnë se si duhet të trajtohet një fëmijë në konflikt me ligjin në mënyrë miqësore, do të ishte shumë e vlefshme për të gjithë profesjonistët e përfshirë në drejtësinë për të miturit.

Ofrimi i ndihmës ligjore nganjëher pengohet edhe nga çështje teknike sic janë vështirësi për të marrë në telefon avokatin ose zhvillimi i takimit me fëmijën në një ambient të përshtatshëm. Avokatët e intervistuar në Belgjikë u shprehën se kanë pasur vështirësi të kontaktojnë me klientët e tyre të mitur dhe madje në disa raste ata i kanë takuar ata për herë të parë në gjykatë. Avokatët e intervistuar në Shqipëri, theksuan faktin se ambientet e intervistimit të fëmijëve në komisariatet e policisë, në prokurori dhe në gjykatë nuk janë miqësore për fëmijët. Duhet pohuar se ka një trend në Europë për të ndërtuar ambiente miqësore intervistimi për fëmijët në gjykata. Gjithsesi, rrallë ka ambiente të tilla në komisariatet e policisë.

Një tjetër fakt që vlen të përmendet është se ndjeka e rastit në të gjitha fazat e procesit ligjor, që kontribuon në mënyrë domethënëse për ndërtimin e marrëdhënies së besimit midis avokatit dhe fëmijës, nuk ndodh gjithmonë. Shpesh avokatët ndërrohen përgjatë procesit (avokatët të cilët asistojnë fëmijët në komisariatet e policisë gjatë intervistës, shpesh nuk janë të njëjtët që e përfaqësojnë të miturin në gjykatë). Duhet të theksohet se do të ishte më mirë për fëmijën, nëse do të asistohet nga i njëjti avokat përgjatë gjithë procesit. Kjo do t' ju jepte të dyve mundësinë të krijojnë një marrëdhënie pozitive bashkëpunimi si dhe do t' i jepte mundësinë avokatit të mernte më shumë informacion për rastin në mënyrë që të pregatisë një strategji efektive mbrojtje.

Qasja multidiciplinore

Është me rëndësi të përmendet në këtë raport, nevoja për aplikimin e një asistence gjithpërfshirëse që përban ndihmën ligjore dhe të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse. Në këtë kuadër, psikologët dhe agjensitë e mbrojtjes së fëmijëve duhet të angazhohen për të asistuar fëmijët në konflikt me ligjin. Sic u theksua edhe nga avokatët e intervistuar në Lituani, vetëm bashkëpunimi midis institucioneve relevante mund të minimizojë efektin negativ të procedurave penale mbi fëmijët e dyshuar apo të akuzuar dhe të krijojë kushtet për parandalimin e veprave penale nga fëmijët.

Ndihma ligjore për fëmijët me nevojë të vecanta

Në rastet e fëmijëve me nevoja të vecanta duhet të bëhen përpjekje shtesë për ofrimin e ndihmës ligjore të duhur ndaj tyre. Vecanërisht, kur një fëmijë nuk e kupton gjuhën e procedurave ligjore, ai/ajo duhet të asistohet nga një përkthyes. Gjithashtu, fëmijët me aftësi ndryshe mund të kenë nevoja të vecanta përgjatë procesit ligjor të cilat duhet të mbahen në vëmendje nga të gjithë profesjonistët e përfshirë në proces.

Vlerësimi i cilësisë së ndihmës ligjore

Përmirësimi i cilësisë së ndihmës ligjore po merr gjithmonë e më shumë vëmendje nga institucionet ndërkombëtare. Në këtë kuadër, zbatimi i masave efektive për të siguruar cilësinë e ndihmës ligjore, konsiderohet si një përpjekje pozitive që mund të rrisë cilësinë e shërbimit ligjor. Për rrjedhojë, strategjitë kombëtare duhet të përfshijnë masa dhe instrumenta të cilat vlerësojnë cilësinë e ndihmës ligjore.

Në vendet e përfshira në studim, mekanizmi kryesor i kontrollit është ai i ankesave të bëra nga përfituesit e ndihmës ligjore. Instrumenta të tjerë sic është anketimi, përdoren shumë rrallë. Gjithsesi, sic u vërejt dhe nga intervistat e zhvilluara, numri i ankesave të bëra nga fëmijët është i ulët, për shkak se ata kanë nevojë për asistencën e të rriturve për të hartuar dhe paraqitur një letër ankese. Për rrjedhojë, aplikimi i instrumentave të ndryshëm të vlerësimit të ndihmës ligjore ka një rëndësi domethënëse.

Në kuadër të këtij projekti do të hartohet një manual për ndihmën ligjore të fëmijëve në konflikt me ligjin. Më shumë informacion në lidhje ndihmën ligjore miqësore për të miturit mund të gjehet tek: <https://lachild.eu/the-projects/la-child/guidelines-on-legal-aid-for-children/>

LA CHILD

Enhancing legal aid for children in conflict with the law



The project is funded by the Justice Programme of the European Union (2014-2020)

Koordinatori i projektit



LAW INSTITUTE
LITHUANIAN CENTRE FOR
SOCIAL SCIENCES

Partnerët e projektit



QENDRA E SHËRBIMEVE
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES

